CyanMagentaYellowBlack

KOHA
për Grate



Qendra Kosovare për Studime Gjinore
Kosovar Gender Studies Center

AUTOR I POSTERËVE: TABI AZIRI

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

NENI 28 I LIGJIT PËR ZGJEDHJET KONSIDEROHET DISKRIMINUES PËR GRATË

Listat zgjedhore për pabarazi gjinore

Përcaktimi me ligj i kuotës prej së paku 30 për qind të përfshirjes së grave në listat zgjedhore të partive politike është vlerësuar jo i drejtë, ndërsa në praktikë ka rezultuar se ua pamundëson grave që të jenë prezente në listat zgjedhore në mënyrë të barabartë me burrat. Pas shpërfilljes së kërkesave të shoqërisë civile dhe Avokatit të Popullit nga ana e subjekteve parlamentare, tani shpresat janë tek Gjykata Kushtetuese, e cila ka në proces të trajtimit të kushtetutshmërisë Nenin 28 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme

Fitim Gashi

Pas miratimit të ligjit të ri për zgjedhjet e përgjithshme janë ngritur shqetësime mbi thellimin e pabarazisë gjinore në listat zgjedhore të partive politike. Në mungesë të veprimeve nga ana e subjekteve parlamentare për t'i adresuar vërejtjet e institucioneve të pavarura dhe shoqërisë civile, kushtetutshmëria e draftit të miratuar nga ligjvënësit tani është duke u trajtuar nga Gjykata Kushtetuese.

Më 17 janar të këtij viti, Naim Qelaj, Avokat i Popullit, e dërgoi kërkesën për vlerësim të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Dispozita që kontestohet është neni 28 i Ligjit, që përcakton se "në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku tridhjetë (30%) për qind janë meshkuj dhe së paku tridhjetë (30%) për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë".

Sipas kërkesës së Avokatit të Popullit, Kushtetuesja duhet të vlerësojë nëse kjo dispozitë është në përputhje me Kushtetutën, nenin për Barazi para Ligjit, si dhe nenin për Të drejtat zgjedhore. Në këtë institucion i kanë listuar konkretisht çështjet e identifikuara për shqyrtim: "Nëse ligji i kontestuar është në përputhshmëri me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës; Nëse ligji i kontestuar është në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës; dhe Nëse ligji i kontestuar është në përputhshmëri me nenin 45, paragrafi 1 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës".

Ligji aktual thekson se "në listën e kandidatëve të secilit subjekt politik së paku 30 për qind janë meshkuj dhe së paku 30 për qind janë femra; me nga një kandidat të secilës gjini përfshirë së paku njëherë në secilin grup prej tre kandidatëve, e që numërohet nga kandidati i parë në listë".

Avokati i Popullit vlerëson se megjithëse kuota e përcaktuar në ligjin e kontestuar nuk paraqet kufizim të drejtës, paraqitja e saj si limit minimal i pjesëmarrjes në rastin konkret nuk është proporcionale dhe nuk e pasqyron barazinë gjinore, dhe si e tillë nuk është në përputhje as me parimin e mosdiskriminimit.

"Një vendosje e tillë është në kundërshtim me qëllimin legjitim të ndjekur për arritjen e barazisë gjinore, siç kërkohet me Kushtetutë. Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore", ka thënë Petrit Çollaku, zyrtar për komunikim në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Përveç kësaj, një përcaktim i tillë, sipas tij, e cenon esencën e të drejtës së garantuar, që në rastin konkret është e drejta për t'u zgjedhur, e drejta e pjesëmarrjes dhe e drejta e barazisë para ligjit.

"Avokati i Popullit konstaton se një përcaktim i tillë ligjor prej së paku 30 për qind (neni 28), nuk e promovon barazinë para ligjit, ndërsa në praktikë ka rezultuar se ua ka pamundësuar femrave që të jenë prezente në listat zgjedhore me pjesëmarrje të barabartë me meshkujt. Listat zgjedhore duhet të jenë të formuluara në atë mënyrë që përqindja e grave dhe burrave duhet të jetë e barabartë".

Shpërfillja e rekomandimeve

Ligji u dërgua në Gjykatën Kushtetuese pasi deputetët shpërfillën thirrjen e tij për ta amendamentuar këtë dokument. Pas diskutimeve edhe me Presidenten Vjosa Osmani, Avokati i Popullit, Naim Qelaj, u pati dhënë kohë deputetëve që deri më 15 janar t'i bënin ndryshimet e nevojshme, që do të reflektonin në përmbushjen e parimit të barazisë gjinore. Por, munguan veprimet si nga deputetët e partisë në pushtet, ashtu edhe prej atyre të opozitës.

Në lidhje me angazhimet e ndërmarra pas kërkesës së Qelajt, as Zyra e Presidentes e as partitë kryesore parlamentare në Kuvend nuk kanë dhënë përgjigje. Sqarime lidhur me shqetësimet e ngritura nuk kanë ofruar as nga Agjencia për Barazi Gjinore, e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

E tash shpresat janë tek verdikti që pritet ta japë Gjykata Kushtetuese.

Shqetësime për draftin kanë ngritur edhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që merren me legjislacionin zgjedhor. Eugen Cakolli, hulumtues në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), thotë se një prej problemeve kryesore lidhur me legjislacionin zgjedhor ka të bëjë me mosdefinimin e hierarkisë së ligjeve që trajtojnë çështjet e ndërlidhura me zgjedhjet, në këtë rast barazinë gjinore.

"Praktikisht, në fuqi i kemi kemi dy ligje që parashohin norma të ndryshme sa i përket përfshirjes së grave, ndonëse logjikisht Ligji për Zgjedhjet do të duhej të shihej si lex-specialis, meqenëse i rregullon drejtpërdrejt aspektet e organizimit dhe administrimit zgjedhor".

Sipas Cakollit, Iniciativa e Avokatit të Popullit për ta dërguar ligjin e ri për zgjedhjet e përgjithshme për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese lidhur me listat zgjedhore, është vijimësi e angazhimit të Avokatit të Popullit për këtë çështje - duke ditur që të paktën në dy raste tjera ka pasur iniciativa pranë gjykatave të rregullta.

"Neni që përcakton kuotën gjinore për listat zgjedhore parasheh si kuotë sërish vetëm 30%-shin, si kufi minimal i përfshirjes gjinore në lista, duke rënë indirekt në kundërshtim me Ligjin për Barazinë Gjinore, i cili si barazi gjinore e parasheh vetëm përfshirjen kuptimplote prej 50-50 për qind në çdo nivel të vendimmarrjes".

Dafina Prekazi, Menaxhere e Programeve në Qendrën Kosovare për Studime Gjinore, thotë se ligji i ri për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, duke mos i marrë parasysh vërejtjet e shoqërisë civile dhe Avokatit të Popullit mbi nenin 28, dhe duke mos qenë në përputhje me Ligjin për Barazinë Gjinore, ka potencialin që ta thellojë pabarazinë gjinore në kontekstin e përfaqësimit të barabartë të grave në institucione publike, por edhe në strukturën e partive politike.

"Nëse Kosova synon të jetë një shoqëri e barabartë dhe e drejtë, është thelbësore që ligjet zgjedhore t'i reflektojnë vlerat dhe synimet e barazisë gjinore. Mungesa e dispozitave për të siguruar përfaqësim të barabartë gjinor në listat zgjedhore e bën politikën dhe vendimmarrjen të dominuar nga burrat dhe i shkel të drejtat e grave. Më tej, kjo pabarazi jo vetëm që ndikon në mungesën e një përfaqësimi të barabartë të grave në politikë dhe në vendimmarrje, por edhe gjithashtu i thellon strukturat patriarkale që kufizojnë mundësitë dhe zërin e grave në shoqëri".

Shqetësime se mund të mbetet në fuqi versioni aktual

Ka shqetësime se në fuqi mund të mbetet versioni aktual i draftit, marrë parasysh trendin e vendimmarrjes nga ana e Gjykatës Kushtetuese, si dhe referuar faktit që muajt e ardhshëm mund ta gjejnë Kosovën me zgjedhje të parakohshme, të cilat nuk përjashtohen as nga zyrtarë të partisë në pushtet.

Dafina Prekazi thotë se presin që Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme të trajtohet me prioritet nga Gjykata Kushtetuese.

"Nga përvoja e rasteve te kaluara në Gjykatën Kushtetuese mund te themi se çështjet e ngjashme gjithmonë janë trajtuar me prioritet. Meqenëse pjesa e dytë e këtij viti edhe ashtu parashihet t'i sjellë përgatitjet për zgjedhjet e ardhshme të rregullta në Kosovë, është shumë e rëndësishme që Gjykata Kushtetuese ta konsiderojë këtë kërkesë me përparësi. Trajtimi i shpejtë do të sigurojë që procesi i ardhshëm zgjedhor të zhvillohet në përputhje me ligjet në fuqi dhe me respektimin e të drejtave kushtetuese të grave".

Ndërkaq Eugen Cakolli (KDI) vlerëson se Gjykata Kushtetuese përgjatë viteve të fundit ka pasur një trend relativisht të ngadalshëm të trajtimit të rasteve, madje edhe kur të njëjtat kanë prekur çështje të të drejtave fundamentale të njeriut.

"Meqenëse Avokati i Popullit nuk ka kërkuar shqyrtim urgjent - me një mundësi të tillë që nuk parashihet me ligj - atëherë ligji do t'i nënshtrohet procedurave standarde të shqyrtimit. Potencialisht, kjo mund të nënkuptojë që edhe në rast të zgjedhjeve të parakohshme, përveç nëse Gjykata nuk nxjerr ndonjë masë të përkohshme, që ka gjasa minimale për të ndodhur, atëherë në fuqi dhe zbatim do të jenë dispozitat e ligjit siç është miratuar nga Kuvendi".

Instituti Demokratik i Kosovës ka dalë edhe me një propozim, përmes të cilit konsideron se do të sigurohej garë e drejtë dhe e barabartë zgjedhore.

"KDI-ja beson që zgjidhja më adekuate do të ishte që të parashihet model 'zebër' i përfaqësimit, që nënkupton jo vetëm përfaqësim të barabartë gjinor në lista të kandidatëve, si numër i përgjithshëm, por edhe mundësi të barabarta - meqenëse çdo i dyti kandidat do të duhej të ishte i gjinisë së kundërt".

Ligji për Zgjedhjet ishte miratuar me procedurë të përshpejtuar nga Kuvendi, në qershor të 2023-ës, ndërsa pas një muaji hyri në fuqi. Si rrallëherë, deputetët e partisë në pushtet dhe ata të opozitës u pajtuan duke votuar pro tij. Mirëpo, disa organizata të shoqërisë civile përmes një letre publike shprehën edhe shqetësime të tjera, përveç aspektit që ndërlidhet me përfaqësimin gjinor. Disa nga ndryshimet më problematike të këtij projektligji kanë të bëjnë me integritetin e kandidatëve, pavarësinë e KQZ-së dhe votat e kandidatëve.

Shkelja e konventave ndërkombëtare

Si Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme, ashtu edhe ai për ato lokale, nuk e respektojnë Ligjin për Barazi Gjinore dhe ende thirren në kuotën prej 30 për qind. Reforma zgjedhore ishte proklamuar ndër vite se do të kryhej edhe për shkak të kërkesës së Misionit Vëzhgues të Bashkimi Europian. Në raportin e publikuar pas zgjedhjeve parlamentare të 14 shkurtit 2021, ky mision ritheksoi shkeljen e konventave ndërkombëtare kur vjen puna tek përfaqësimi i grave në lista zgjedhore.

"Organizatat e të drejtave të grave ishin të mendimit që kuota 50 për qind të ishte e zbatueshme për listat e kandidatëve dhe alokimin e ulëseve në Kuvend. Në kundërshtim me standardet ndërkombëtare, as subjektet politike dhe as administrata e zgjedhjeve nuk miratoi ndonjë masë konfirmuese vullnetare për ta rritur numrin e grave kandidate dhe numrin e grave si anëtare të komisioneve zgjedhore", thotë raporti. Nga 1.052 kandidatë të certifikuar në zgjedhjet e fundit, 364 ishin gra, duke përfaqësuar 34.6 për qind të të gjithë kandidatëve.



Disa bashkëbisedues të Misionit Vëzhgues patën deklaruar se gratë përballen me pengesa sociale dhe familjare për t'u propozuar për pozitë të zgjedhur, ose për të bërë fushatë të suksesshme, si pasojë e modeleve të ngulitura patriarkale.

Para zgjedhjeve të vitit 2019, Avokati i Popullit pati deklaruar se Ligji për Barazinë Gjinore e kishte zëvendësuar Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ai gjithashtu kishte paraqitur një ankesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër KQZ-së, për diskriminim gjinor në listat e kandidatëve, duke insistuar në masa të përkohshme që kërkojnë nga KQZ-ja të zbatojë një kuotë prej 50 për qind në listat e kandidatëve.

Sistemi i kuotës ishte instaluar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në vitin 2000, kur Kosova mbajti zgjedhjet e para pas çlirimit. Legjislacioni të cilin më pas e miratoi Kosova ofron një bazë të mirë për inkurajimin dhe mbështetjen e pjesëmarrjes së gruas në pozita vendimmarrëse. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik i vendit, promovon parimet e barazisë gjinore që janë të pranuara edhe ndërkombëtarisht. Një parim i tillë është i sanksionuar me Ligjin Kundër Diskriminimit. Kurse Ligji për Barazi Gjinore përcakton një sërë masash ligjore për arritjen e barazisë së plotë mes burrave dhe grave në shoqëri. Por, në zgjedhjet e fundit, partitë nuk treguan gatishmëri për përfaqësimin e plotë të barazisë gjinore duke mos e respektuar Ligjin i cili kërkon që listat e kandidatëve të ndahen 50:50.

Në QKSGJ vlerësojnë se si hap i parë duhet të bëhet harmonizimi i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme me Ligjin për Barazinë Gjinore. Në këtë kontekst, sipas Prekazit, duhet të përdoren kuotat gjinore në listat zgjedhore të partive politike prej 50 për qind, siç parashihet në Ligjin për Barazinë Gjinore, për të siguruar përfaqësim të barabartë të burrave dhe grave në institucionet politike.

"Ne tashmë kemi një shembull pozitiv në Parlamentin e Kosovës, ku kuota e cila është në fuqi ka sjell progres. Megjithatë, për të siguruar barazi të plotë, duhet të reflektohet edhe në partitë politike, në Qeveri, në Kuvend, dhe në të gjitha institucionet publike. Për të garantuar që Ligji për Barazinë Gjinore nuk po cenohet, duhet të monitorohet dhe të sanksionohet me rregull. Kjo përfshin një sistem të qëndrueshëm të monitorimit të përmbushjes së kuotave gjinore, si dhe zbatimin e sanksioneve për partitë politike dhe institucionet që nuk i respektojnë këto kuota".

Edhe Agjencia për Barazi Gjinore, në një raport të publikuar në vitin 2023, ka konstatuar mungesë përparimi në "harmonizimin dhe plotësimin e ligjit për zgjedhje, ligjit për financimin e partive politike dhe rregullores se Punës së Kuvendit me LBGJ-në".

Trashëgimia e kuotës

Pavarësisht kësaj, në zgjedhjet e vitit 2021 për herë të parë u thye tavani i qelqtë dhe gratë politikane ia dolën të bëhen pjesë e Kuvendit të Kosovës edhe pa kuotën prej 30 për qind.

Nevoja e fuqizimit të grave dhe rritjes së pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje është paraparë në Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW), të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në vitin 1979. Konventa është ratifikuar nga 190 shtete anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Qëllimi i saj është të hiqen të gjitha format e diskriminimit kundër grave dhe të arrihen liri të plota njerëzore dhe të drejta për gratë në kushte të barabarta me burrat. Konventa gjithashtu kërkon të eliminohet diskriminimi kundër grave në jetën publike dhe politike.

Përtej kuotës së përcaktuar me ligj për gratë, ndër vite ka ndryshuar trendi sa i përket pjesëmarrjes së grave në zgjedhjet lokale dhe ato të përgjithshme. Sipas hulumtimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), burrat përbëjnë numrin më të madh votuesve në secilin nga proceset zgjedhore, të organizuara në vitet 2009, 2010, 2014, 2017, 2019, 2021. Gjithashtu, edhe pjesëmarrja në votime është më e lartë tek burrat. Përjashtim bëjnë zgjedhjet lokale të vitit 2013, kur është regjistruar pjesëmarrja më e lartë e grave në historinë e zgjedhjeve në Kosovë, që ishte më e lartë edhe në raport me burrat për 37 mijë e 559 votuese.

CyanMagentaYellowBlack

Përgjegjësia institucionale dhe aktivizmi kundër dhunës me bazë gjinore

Albulena Haxhiu

Angazhimi për avancimin e të drejtave të grave në jetën publike dhe politike duhet të jetë prioritet institucional dhe përpjekje e përbashkët shoqërore. Fatkeqësisht, viteve të kaluara problemet me të cilat ballafaqoheshin vajzat dhe gratë nuk kanë marrë vëmendje dhe nuk kanë qenë prioritet institucional. Megjithatë, duke qenë të vetëdijshëm për problemet me të cilat përballen vajzat dhe gratë, sfidat që ato kanë, si dhe tendencën dominuese për ta normalizuar dhunën ndaj tyre, si Qeveri që nga fillimi i mandatit kemi ndërmarrë shumë veprime që ndërlidhen me pavarësinë ekonomike të vajzave dhe grave, sikurse edhe të atilla që kanë për qëllim adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Kësisoj, krahas angazhimit në çështjet e përgjithshme të drejtësisë, angazhimi rreth kauzave të drejta feministe vazhdon të mbetet lart në listën e prioriteteve të Qeverisë. Përpjekjen e grave për të drejta të barabarta e kam parë dhe e shoh brenda përpjekjeve të gjithëmbarshme shoqërore për barazi e drejtësi. Thirrja jonë si gra, sot, duhet të jetë thirrje për drejtësi për të gjithë të shtypurit dhe ata që padrejtësisht shihen si qytetarë të dorës së dytë. Ne jemi të vetëdijshëm që kur flasim për problemet me të cilat ballafaqohen vajzat dhe gratë, pavarësisht punës, kemi edhe shumë sfida përpara, por ka një hierarki të prioriteteve dhe janë disa aspekte që kërkojnë ndërhyrje më urgjente. Dhe kjo urgjencë sot është lufta ndaj femicidit dhe dhunës ndaj grave. Me të drejtë viteve të fundit aktivistet feministe në Kosovë në ballë të protestave kanë mbajtur parullën: "Femicidi është urgjencë kombëtare".

Adresimi i femicidit dhe dhunës ndaj grave kërkon një reagim të gjithëmbarshëm, sepse pa dyshim nuk mjaftojnë vetëm veprimet në nivel institucional, ndonëse ato janë të domosdoshme. Sa shpejt arrijmë ta minojmë femicidin në shoqërinë tonë, kjo varet nga të gjithë akterët dhe grupet shoqërore se sa angazhohen në dekonstrukimin e disa normave gjinore që shpijnë pashmangshëm tek dhuna e tek vrasjet e grave

Roli aktiv i institucioneve dhe aktivizmi i shoqërisë civile kundër dhunës me bazë gjinore janë dy binarë thelbësorë të shoqërisë së sotme në të cilët duhet lëvizur, veçmas në kohët e tilla të tranzicioneve dhe ndryshimeve shoqërore që po ndodhin anembanë botës.

Nga njëra anë, institucionet përherë duhet të ndiejnë detyrim për të ndërmarrë veprime konkrete për parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës. Kjo përgjegjësi kërkon jo vetëm hartimin e legjislacionit të duhur, por edhe zbatimin e tij në praktikë për t'i mbrojtur të drejtat dhe sigurinë e të gjithëve. Në anën tjetër, po si një partner i fortë në këtë kauzë, shoqëria civile duhet të vazhdojë të nxisë reagimet publike të cilat i kontribuojnë edhe ndërgjegjësimit qytetar në besimin e plotë të barazisë, por edhe kujdesit më të madh institucional në veprimet dhe masat serioze që ndërmerr.

Janë të njohura rastet kur një pjesë e shoqërisë njëzëri e paragjykon masivisht një viktimë të dhunës gjinore, ose të femicidit. Të shumtë janë ata që, pasi dëgjojnë se ndaj një gruaje është ushtruar dhunë ose edhe është vrarë, parashtrojnë pyetjen "PSE?", dhe vijojnë të përgjigjen: "sepse…". Nëse i përmbledhim justifikimet që iu bëjnë dhunuesve apo vrasësve, të gjitha e kanë një përfundim: "Gruaja është fajtore", "Ajo ka provokuar me veshje", "Ajo ka dalë vetë në mbrëmje", "Ajo duhet të ketë bërë diçka", etj. Situata bëhet edhe më e rëndë kur kjo mendësi dhe këto paragjykime, fatkeqësisht, shpërfaqen edhe brenda vetë institucioneve të drejtësisë, përmes aktgjykimeve apo vendimeve të tyre, thellësisht skandaloze.

Për ta ngritur tutje vetëdijen institucionale, përveç tjerash, së fundi i kemi ashpërsuar dënimet që ndërlidhen me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore. Zbatimi strikt i legjislacionit është e vetmja mënyrë si ne mund të mbrojmë jetën e vajzave dhe grave në vendin tonë.

Pavarësisht që i kemi ashpërsuar dënimet në Kodin Penal për personat që shpallen fajtorë për dhunë në familje dhe dhunën me bazë gjinore, nëse nuk ka vetëdijesim dhe përgjegjësi institucionale duhet të pajtohemi me thënien e teoricienes Judith Butler, që vrasja e grave nuk konsiderohet krim. Shpesh kemi parë që vetë institucionet nuk i shpëtojnë dot mendësisë patriarkale. Askush nuk guxon t'i justifikojë vrasjet e grave bazuar mbi normat patriarkale. Assesi nuk duhet të lejojmë që kjo të ndodhë. Prandaj ngul kaq shumë këmbë tek reforma në drejtësi, sepse përveç tjerash do të garantojë sistem të drejtësisë të pavarur dhe profesional.

Do të prodhojmë një standard të tillë,që kurrë më, asnjë qeverisje tjetër nuk do të mund të shkelë mbi këtë standard të përparuar, sepse shoqëria nuk do ta lejojë kthimin prapa, nëpërkëmbjen e dinjitetit të grave. Pra, janë dy dimensione që duhet luftuar: femicidi dhe dhuna ndaj grave. I pari nëpërmjet institucioneve me ashpërsim të ligjeve dhe dënimeve maksimale, si dhe me masa mbështetëse për viktimat, ndërsa i dyti përmes aktivizmit ku në njërën anë emancipohet shoqëria dhe në anën tjetër ushtrohet presion ndaj institucioneve.

Përveç ashpërsimit të dënimeve, si dëshmi e përkushtimit tonë, tashmë do t'i procedojmë ndryshimet që ndërlidhen me përfshirjen e femicidit si nen të veçantë në Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Sot ne kemi një Qeveri që është e ndjeshme ndaj secilës padrejtësi, sidomos në raport me grupet që janë më të ekspozuara ndaj shtypjes e shfrytëzimit, dhunës e përdhunimit. Ne as nuk e kemi sjellë dhunën, as nuk e mirëmbajmë atë, përkundrazi i kemi shpallur luftë dhe angazhohemi çdo ditë për një shoqëri pa dhunë dhe me barazi e drejtësi.

Rruga drejt barazisë gjinore shpesh është e mundimshme, por është e vetmja rrugë që ia vlen të ecet. Historia na ka mësuar që asnjë agresor, çfarëdo qoftë, nuk mund ta ketë sundimin e përjetshëm mbi viktimën. Kështu do të ndodhë edhe me çështjet gjinore.

Autorja është Ministre e Drejtësisë.

Investoni në gratë për ta fuqizuar shoqërinë

Tomáš Szunyog

Më 8 mars gratë janë në qendër të vëmendjes. Është një mundësi për të reflektuar mbi pozicionin e tyre në shoqëri, të drejtat e tyre, sfidat me të cilat përballen dhe rrugëtimin e vazhdueshëm drejt arritjes së barazisë gjinore në të gjitha sferat e jetës.

Gjatë mandatit tim trevjeçar e gjysmë në Kosovë, pata rastin të jem dëshmitar se shumë gra shkëlqejnë në qendër të vëmendjes dhe arrijnë gjëra të mëdha, pavarësisht se kanë përjetuar vështirësi. Një nga shembujt më frymëzues të fuqizimit dhe lidershipit të grave është Fahrije Hoti, themeluesja vizionare e Kooperativës Bujqësore "Krusha". Duke shfrytëzuar mbështetjen e BE-së, e cila përfshinte ndërtimin e një objekti magazinimi dhe prodhimi krahas instalimit të paneleve diellore, ajo rriti shitjet e brendshme me 40% dhe shifrat e eksportit me 30%. Ajo tani mbikëqyr një ekip prej 57 punonjësish, nga të cilët 50 janë gra nga fshati i saj. Forca dhe qëndrueshmëria e jashtëzakonshme e Fahrijes shkëlqeu përmes filmit të mirënjohur dramatik "Hive", i cili fitoi tri çmime në Festivalin e Filmit Sundance. Kam pasur nderin ta shikoj këtë film të mrekullueshëm së bashku me ambasadorët e shteteve anëtare të BE-së dhe gratë e Kooperativës Bujqësore "Krusha", gjatë vizitës sonë të përbashkët në Krushën e Madhe, në qershor 2022. Duke e vlerësuar kontributin e jashtëzakonshëm në komunitetin e saj dhe rolin si një dritë frymëzimi për gratë tjera, Fahrija u nderua me çmimin prestigjioz "Europianja e Vitit", në vitin 2022.

Besarta Pajaziti është një shembull tjetër i shkëlqyer. E takova Besartën, përfituese e fondeve të BE-së, e cila drejtonte një rrobaqepësi në Çarshinë e Vjetër historike të Gjakovës, gjatë nisjes së fushatës "16 Ditët e Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore", në vitin 2020. Duke përdorur grantin që ajo mori nga BE-ja, Besarta zgjeroi me sukses biznesin e vet, të themeluar fillimisht nga babai i saj, me rritjen e cilësisë dhe sasisë së prodhimit të veshjeve, njëkohësisht duke krijuar mundësi punësimi.

Tema e këtij viti për Ditën Ndërkombëtare të Gruas është "Frymëzoni përfshirjen". E gjithë kjo është kaq frymëzuese. Arritjet e tilla mbushin me krenari të pamasë si popullin e Kosovës, ashtu edhe BE-në.

Përfshirja e grave në procesin e vendimmarrjes

Gjatë kohës sime në Kosovë kam parë gra udhëheqëse në të gjitha sferat e jetës. Kosova jep një shembull të shquar - me një grua Presidente dhe me gra që shërbejnë si zëvendëskryeministre, ministre, zëvendësministre, deputete dhe diplomate. Megjithatë, zgjedhjet komunale zbuluan një mungesë zhgënjyese të pjesëmarrjes së grave, me shumë pak kandidate gra dhe vetëm dy gra të zgjedhura kryetare komunash, të dyja serbe të Kosovës.

Për më tepër, gratë po marrin gjithnjë e më shumë pozita me përgjegjësi në fusha të ndryshme, si gazetaria, inxhinieria, akademia dhe kujdesi shëndetësor. Ato po i shfrytëzojnë në mënyrë aktive mundësitë e sipërmarrjes, me shumë gra që udhëheqin kompanitë dhe krijojnë rrugë punësimi për gratë tjera.

Ekspozimi i grave në role të tilla është thelbësore për zhvillimin e vajzave të reja dhe djemve të rinj. Është frymëzuese për të rinjtë në Kosovë që t'i shohin gratë në pozita udhëheqëse në të gjithë sektorët dhe të kuptojnë se ato gjithashtu mund të ndjekin vizionin e tyre e t'i realizojnë ëndrrat e veta. Është gjithashtu frymëzuese për të gjithë shoqërinë, pasi po ndryshon mentalitete dhe stereotipe si mes grave ashtu edhe burrave.

Megjithatë, Kosova ende përballet me sfida të konsiderueshme. Ndërsa po bën progres të qëndrueshëm në përfaqësimin e përgjithshëm të grave në vendimmarrje dhe në jetën publike, përfaqësimi i thjeshtë është i pamjaftueshëm për arritjen e barazisë gjinore. Gratë në role drejtuese përballen me një kontroll të shtuar dhe kërkesa më të mëdha, duke ju dashur vazhdimisht ta demonstrojnë vlerën e tyre. Pavarësisht nga pozitave në pushtet, ato shpesh hasin në diskriminim. Gratë, veçanërisht politikanet dhe figurat publike, shpesh bëhen shënjestra të fushatave dezinformuese që synojnë të minojnë besueshmërinë e tyre. Gjuha seksiste, mizogjene dhe ajo e urrejtjes, e drejtuar ndaj grave, jo vetëm që rrezikon mirëqenien e tyre, por gjithashtu, në raste të rënda, e rrezikon edhe sigurinë e tyre.

Për ta kundërshtuar këtë, ne duhet ta rrisim ndërgjegjësimin për diskriminimin, të ndërmarrim veprime për ta nxitur barazinë gjinore dhe t'i festojmë arritjet e grave. Duke i fuqizuar zërat e grave ne e pasurojmë diskursin politik me perspektiva të ndryshme dhe nxisim politika gjithëpërfshirëse që adresojnë nevojat unike të të gjithë qytetarëve.

BE-ja si promovuese e barazisë gjinore dhe lidershipit të grave

Në vitin 2020 nënshkrova planin e zbatimit të Planit të Veprimit Gjinor III, në bashkëpunim të ngushtë me përfaqësuesit e shteteve anëtare të BE-së, organizatat e shoqërisë civile, aktivistet për të drejtat e grave, të rinjtë dhe partnerët kryesorë ndërkombëtarë. Ky plan përfshin një vizion strategjik: angazhim të vazhdueshëm për ta luftuar dhunën me bazë gjinore, arsimim më të mirë, forcim të të drejtave ekonomike dhe sociale, si dhe avancim të udhëheqjes dhe pjesëmarrjes së grave.

Që atëherë, BE-ja në Kosovë punon ngushtë me Qeverinë e Kosovës, shoqërinë energjike civile dhe partnerët tanë ndërkombëtarë, për të avancuar barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave përmes ngritjes së vetëdijes për pabarazitë ekzistuese, duke sugjeruar ndryshime legjislative drejt përmirësimit të legjislacionit të Kosovës në përputhje me legjislacionin e BE-së, si dhe zbatimin e projekteve të synuara.

Për shembull, programi rajonal i BE-së: "Fuqizimi i OSHC-ve në Luftimin e Diskriminimit dhe Përmirësimi i të Drejtave të Grave në Punë", synon të sjellë mundësi të barabarta për gratë që duan të futen në tregun e punës, duke u fokusuar në mangësitë legjislative, politike dhe zbatuese që shkaktojnë diskriminimin e grave në punë.

Përveç kësaj, BE-ja i ka realizuar disa projekte për të fuqizuar pjesëmarrjen e grave në politikë, për të integruar barazinë gjinore në procedurën legjislative dhe për të rritur përqindjen e vendeve që mbajnë gratë në kuvendet dhe qeverisjet komunale. Ne po e bëjmë këtë sepse besojmë me vendosmëri se politika nuk duhet të konsiderohet vetëm sferë e burrave.

Sot, unë zotohem se do të vazhdoj t'i promovoj të drejtat e grave dhe vajzave në të gjitha aspektet e jetës përmes punës së BE-së në Kosovë. Kjo mund të arrihet vetëm nëse të gjithë e njohim vlerën e përfshirjes së grave.

Autori është Ambasador i BE-së në Kosovë.

CyanMagentaYellowBlack

Për pjesëmarrjen e grave në marrëveshjet e paqes

Jonas Westerlund

Gjatë studimeve të mia Master në Diplomaci, në fillim të viteve 1990, unë dhe shokët e mi të klasës u trajnuam për teknikat e konferencës për shtyp. Secili duhej ta paraqiste një çështje tematike para klasës dhe ta mbronte një pozicion politik imagjinar. Me një entuziazëm të madh dhe një grimcë shpirtligësie, pjesa tjetër e shokëve të klasës bënë çmos për t'i shkatërruar argumentet e paraqitura duke bërë pyetje intriguese dhe të neveritshme. Shpejt, radha ishte e mikut tim kanadez, Pierre-Yves, i cili zgjodhi t'i mbronte bombardimet ndaj objektivave në Bosnje dhe Hercegovinë nga Forcat Ajrore Kanadeze, dhe në veçanti viktimat civile të rastësishme që kishin ndodhur si rrjedhojë. Ai po ia dilte mjaft mirë derisa unë e parashtrova pyetjen: "Pse nuk kishte asnjë pilote kanadeze që merrte pjesë në operacionet në Bosnje?" Ai e humbi fillin dhe kur më pas mori një notë të dobët nga profesori për performancën e tij, më fajësoi mua.

Në vitin 1982, Alva Myrdal nga Suedia mori Çmimin Nobel për Paqe bashkë me Alfonso Garcia Robles nga Meksika. Çmimi iu dha për punën e saj të pandërprerë në fushën e çarmatimit dhe zonave pa armë dhe pa armë bërthamore.

Znj. Myrdal është një prej shumë grave që kanë marrë çmimin prestigjioz nga fillimi i tij. Vitin e kaluar, Znj. Narges Mohammadi nga Irani u nderua për luftën e saj të guximshme për lirinë e shprehjes dhe të drejtën e pavarësisë.

Ndërkohë që disa lidere politike janë njohur për kontributin e tyre në ndërtimin e paqes, akoma mungojnë dukshëm gratë emisare për paqe në mbarë globin.

Më shumë se dy dekada pas miratimit të Rezolutës 1325 të KS të OKB-së, që përcakton agjendën e "Gratë, Paqja dhe Siguria" (WPS), progresi mbetet i ngadaltë. Gratë vazhdojnë të jenë të margjinalizuara në proceset e paqes, duke hasur në barriera të rëndësishme që pengojnë pjesëmarrjen e tyre aktive në vendimmarrje. Fatkeqësisht, kontributet e tyre të vlefshme shpesh mbeten të panjohura.

Nga viti 1992 deri në vitin 2019, gratë përbënin mesatarisht vetëm 13 për qind të negociatorëve, 6 për qind të ndërmjetësuesve dhe 6 për qind të nënshkruesve në proceset kyçe të paqes në mbarë globin.

Vitet e fundit nuk e kanë përmirësuar situatën. Shifrat nga UN Women tregojnë se nga 18 marrëveshje paqeje të arritura në vitin 2022, vetëm një u nënshkrua ose kishte dëshmitare nga një përfaqësuese e një grupi apo organizate të grave.

Është e vërtetë që në vitin 2021 gratë kontribuuan si ndërmjetësuese kryesore në dy nga pesë proceset aktive të udhëhequra ose të bashkudhëhequra nga OKB-ja, përkatësisht Diskutimet Ndërkombëtare të Gjenevës dhe Dialogun Libian. Gratë përbënin gjithashtu 43 për qind të personelit në ekipet mbështetëse të ndërmjetësimit të Kombeve të Bashkuara në vitin 2021.

Kishte gjithashtu një numër të konsiderueshëm negociatoresh gra në bisedimet e paqes në Kolumbi në 2022-2023, duke arritur një barazi të përafërt me homologët e tyre burra. Por ky është një përjashtim më shumë se rregull. Në negociatat midis palëve të interesuara në Jemen dhe Etiopi, në vitin 2022, nuk kishte fare gra të përfaqësuara në ekipet negociatore. Duke u zhvendosur në rajonin tonë, në Ballkanin Perëndimor, në vitet e fundit nuk ka lidere që marrin pjesë as në ekipet negociuese dhe as në ekipin ndërmjetësues në Dialogun e Normalizimit të lehtësuar nga BE-ja midis Prishtinës dhe Beogradit.

Për të hedhur kripë mbi plagë, kjo nuk ka të bëjë vetëm me përfaqësimin e grave në bisedimet e paqes, por deri në çfarë mase barazia gjinore po integrohet në negociata. Në 18 marrëveshjet e paqes në vitin 2022, vetëm gjashtë marrëveshje kishin dispozita që iu referoheshin grave, vajzave dhe gjinisë. Merreni si shembull tjetër dialogun e vazhdueshëm ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Në Marrëveshjen e vitit 2023, për Rrugën e Normalizimit të Marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe as në Shtojcën e saj nuk përmenden gratë dhe barazia gjinore.

Pse është kjo e rëndësishme, mund të pyesni. Para së gjithash, gratë janë viktimat kryesore në konflikte. Vetëm në Kosovë janë rreth 20 mijë raste të dhunës seksuale që janë kryer nga forcat serbe gjatë luftës së viteve 1998-1999. Siç thuhet në Raportin e vitit 2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Gratë, Paqja dhe Siguria "...mosndëshkimi për mizoritë ndaj grave dhe vajzave është ende i përhapur". Së dyti, kërkimi ("Roli i gjinisë në parandalimin e konfliktit të dhunshëm", Crespo-Sancho, C. 2017) sugjeron që barazia më e madhe gjinore korrespondon me gjasat më të ulëta të një vendi për të përdorur forcën ushtarake në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me kombet tjera. Thënë ndryshe, vendet me boshllëqe gjinore më të dukshme kanë më shumë gjasa të përfshihen në konflikte të brendshme dhe mes shtetesh. Siç ka vënë në dukje Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë ("Pjesëmarrja e Grave në Proceset e Paqes", në cfr.org), pjesëmarrja e grave rrit probabilitetin e një marrëveshje paqeje që zgjat së paku dy vjet për 20 për qind dhe një marrëveshje paqeje që zgjat pesëmbëdhjetë vjet për 35 për qind. Si përfundim, marrëveshjet e paqes me një qasje të integruar të barazisë gjinore janë më të qëndrueshme se marrëveshjet pa të. Këto janë dy nga shumë arsyet pse barazia gjinore duhet të ketë një rol të spikatur në bisedimet e paqes.

Nëse kjo qasje është e pakundërshtueshme, pse nuk po zbatohet në praktikë? Shumica e ekipeve negociatore në bisedimet e paqes përbëhen nga persona që dikur ishin luftëtarë, jo viktima të luftës. Përveç kësaj, pabarazia gjinore vazhdon në shumë shoqëri ku gratë thjesht nuk marrin pjesë në proceset vendimmarrëse.

Si Shef i Shtabit në Ndërmjetësimin e Përbashkët të Unionit Afrikan-OKB-së për Bisedimet e Paqes në Darfur, më 2007-2008, unë kontribuova për t'i bashkuar gratë udhëheqëse të shoqërisë civile me drejtuesit e lëvizjeve kryengritëse të Darfurit. Rezultatet në rastin më të mirë ishin të përziera. Kishte pak interes të çmuar nga udhëheqësit kryengritës për t'i dëgjuar liderët e shoqërisë civile, një pengesë të cilën nuk arritëm ta kapërcejmë kurrë.

Në vitin 2021, kur isha Këshilltar i Lartë i Përfaqësuesit Special të Kryesuesit të OSBE-së për Kaukazin e Jugut dhe bashkëkryesues i Diskutimeve Ndërkombëtare të Gjenevës, për mendimin tim, barazia gjinore u përfshi në diskutime me një përgjigje të zbehtë nga palët e përfshira.

Atëherë, cili është çelësi i suksesit në integrimin e barazisë gjinore dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në bisedimet e paqes?

Është e domosdoshme që ekipet e ndërmjetësimit të emërojnë vazhdimisht gra si bashkëndërmjetësuese, të integrojnë ekspertë gjinorë në ekipe dhe të insistojnë në përfaqësimin adekuat gjinor në të gjitha ekipet negociuese. Parimet e barazisë gjinore duhet të përfshihen në të gjithë kapitujt e marrëveshjeve të paqes, duke përfshirë dispozitat që lidhen me ndërprerjen e armiqësive, ndarjen e pushtetit dhe shpërndarjen e burimeve. Kjo do të siguronte një angazhim gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm për barazinë gjinore. Grupet e grave duhet gjithashtu të konsultohen në mënyrë aktive gjatë gjithë bisedimeve të paqes për të siguruar perspektivë gjithëpërfshirëse. Kjo do të thotë se duhet të ketë një rritje të mbështetjes për grupet e grave kur bëhet fjalë për financimin, ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e grave në politikë. Së fundi, duhet të ketë trajnime të specializuara për negociatorët dhe ndërmjetësit mbi qasjet e ndjeshme gjinore dhe rëndësinë e integrimit të perspektivave gjinore në marrëveshjet e paqes. Kjo përfshin adresimin e nevojave dhe përvojave specifike të grave në situata konflikti.

Më lejoni të përfundoj duke nënvizuar rëndësinë e lidershipit të grave në negociata me potencimin e rolit të Znj. Edita Tahiri. Si ish-Zëvendëskryeministre e Kosovës, ajo shërbeu si Kryenegociatore për Republikën e Kosovës gjatë një periudhe shtatëvjeçare (2011-2017), në dialogun e lehtësuar nga BE-ja. Mandati i saj shënoi një periudhë përparimi thelbësor në dialog, duke e theksuar ndikimin transformues që gratë mund të kenë në formësimin e marrëveshjeve të suksesshme dhe të qëndrueshme të paqes. Sot, zonja Tahiri drejton Lobin Rajonal të Grave për Evropën Juglindore (RWLSEE), një organizatë rajonale e grave për ndërtimin e paqes, e njohur si model i bashkëpunimit rajonal dhe ndërtimit të paqes lokale duke zbatuar agjendën e "Gratë, Paqja dhe Siguria" (WPS).

Autori është Ambasador i Suedisë në Kosovë.

Aktivizmi feminist dhe rrjetëzimi kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave



Marcella Pirrone

Duke reflektuar mbi më shumë se 30 vjet aktivizëm feminist kundër dhunës me bazë gjinore, rrugëtimi im është formësuar nga parimet e aktivizmit feminist politik dhe angazhimit kolektiv. Gjatë gjithë kësaj periudhe nuk kam ecur kurrë vetëm. Rruga ime ka qenë gjithmonë përkrah kolegeve feministe brenda grupeve të grave, një forcë kolektive që e ka ushqyer mendimin dhe aktivizmin tim politik në përputhje me politikën e grave dhe feminizmin. Angazhimi im politik nuk ka qenë kurrë në institucionet publike, zgjodha qartësisht të mbetem e rrënjosur fort në shoqërinë civile, nga baza, duke qëndruar krah për krah grave dhe vajzave që janë viktima të formave të ndryshme të dhunës nga burrat.

Ky ishte dhe mbetet një aktivizëm kolektiv feminist, aktiv, i përkushtuar dhe me kompetencë të lartë që synon të trajtojë çështjen e dhunës ndaj grave (DHNG) që prek çdo grua, duke ruajtur një perspektivë më të gjerë për shoqërinë në tërësi. Ai përfshin një analizë feministe të strukturave patriarkale, diskriminimit ndaj grave dhe mosbalancimit të pushtetit, si shkaqet kryesore të dhunës ndaj grave. Thellohet në mënyrat e shumta në të cilat liritë e zgjedhjes dhe vetëvendosjes së grave shtypen dhe mohohen të drejtat, talentet, mundësitë dhe ëndrrat e tyre njerëzore.

Mendimet feministe dhe diskutimet kolektive na kanë fuqizuar t'i artikulojmë dhe përmendim aspektet delikate që na kanë bërë ne, gratë, të ndihemi "të pakëndshme" në botë dhe që na pengojnë të gjejmë vendin tonë. Ky udhëtim transformues e ka revolucionarizuar ekzistencën time dhe nuk kam qenë kurrë vetëm. Jam mirënjohëse ndaj çdo feministeje që kam takuar dhe pasurisë së ligjërimit feminist në mbarë botën, që ka ushqyer praktikën politike nga e cila kanë përfituar gratë në të kaluarën dhe vazhdojnë të përfitojnë edhe sot.

Grupet e grave, joformale por aktive për vite me radhë në të menduar apo në projekte specifike, u dhanë grave të reja si unë besimin në mundësinë e ndryshimit shoqëror dhe çlirimit nga mekanizmat shtypës patriarkalë. Ky përkushtim përfshinte inteligjencë, ekspertizë, angazhim vullnetar dhe punë, të gjitha të ndërmarra kolektivisht me shumë gra të tjera feministe që ndajnë të njëjtin pasion politik dhe energji revolucionare.

Praktikisht, këto gra, gjithnjë e më të shumta në nivel global, zgjodhën të përballen me një nga pengesat më të mëdha për realizimin e të drejtave, dëshirave dhe talenteve të grave: dhunën e burrave ndaj grave. Ato krijuan hapësira ku çdo grua mund të gjente një tjetër që do ta dëgjonte, vlerësonte dhe mbështeste, duke e vendosur atë në qendër, duke ofruar mundësi të ndryshme për t'i shpëtuar dhunës sipas kushteve të saj. Këto vende u rritën, u shumuan, mbështetën njëri-tjetrin dhe mësuan nga njëri-tjetri, jo vetëm brenda vendeve, por edhe në të gjithë Europën dhe botën.

Në fazat fillestare, gjatë viteve të 1970-ta, nuk kishte shumë prej tyre. Megjithatë, përpjekjet e tyre politike për ta sfiduar fenomenin e dhunës dhe vlerat tradicionale patriarkale familjare fituan tërheqje, duke u përhapur si rrëke të panumërta dhe duke përmbytur gradualisht botën. Pavarësisht lidhjes së kufizuar në krahasim me sot, feministet kërkuan njëra-tjetrën, e njohën njëra-tjetrën, u lidhën dhe forcuan praktikën e tyre politike feministe bazuar në njohjen dhe fuqizimin reciprok. Kjo u nxit nga një nevojë bindëse globale për liri dhe drejtësi sociale që bashkoi dëshirat e grave në mbarë botën.

Ndihem me fat që i kam kërkuar dhe gjetur këto aktiviste feministe, duke u rritur dhe duke u angazhuar me to gjatë viteve. Nga lokale në globale, kuptimi politik feminist ishte në çdo vend dhe formë, duke shënuar hapësira të rëndësishme jo vetëm për gratë individualisht, por për shoqërinë në tërësi. Këto vende simbolike kontribuojnë në formimin e një politike dhe kulture që parashikon një botë të lirë nga dhuna e meshkujve ndaj grave. Elementi unifikues që fuqizon këtë vizion është forca e grave, e bashkuar nga mendimi dhe praktika feministe që nuk lë askënd pas. Siç thanë feministet argjentinase në vitin 2015, duke u bërë jehonë fjalëve të poetes meksikane Susana Chàvez: "Ni una menos" (Asnjë më pak).

Rrjetëzimi ka qenë dhe do të jetë gjithmonë një forcë e suksesshme dhe e paepur. Gjashtë feministet themeluese të Rrjetit WAVE - Gratë kundër dhunës në Europë, e njohën këtë të vërtetë në vitin 1994. Besimi i tyre i palëkundur në fuqinë e rrjetëzimit çoi në krijimin e një "vendtakimi" në Vjenë, Austri, për aktivistet feministe kundër dhunës mashkullore dhe patriarkalitetit. Gjatë 30 viteve të fundit, ky rrjet është rritur duke përfshirë mbi 170 organizata anëtare nga 46 vende të ndryshme, duke përfaqësuar rreth 1600 organizata për gratë në situata të dhunës, duke mishëruar politikën e grave dhe duke shërbyer si agjentë të ndryshimit në shoqëri dhe në kulturën patriarkale. Ato në vijën e parë kontribuojnë në fuqizimin dhe avancimin thelbësor të të drejtave të grave.

Autorja është anëtare e WAVE dhe ish-presidente e WAVE.

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Kundër antigjinores

Luljeta Demolli

Tematizimi aktual i trupit të grave dhe i të drejtave riprodhuese paraqet dëshmi që gjinia është një ndër fundamentet e politikëbërjes sonë. Në Kosovë patriarkaliteti është pushtet. Politik, ekonomik dhe simbolik. Prandaj, për lëvizjen feministe në Kosovë, kjo mënyrë e shpalosjes së projekteve dhe diskutimeve është e rëndësishme së paku për dy arsye. Sinjalizon rrezikun permanent që vjen nga e djathta konservatore për kauzën feministe dhe shënon momentum të rëndësishëm për konsolidimin, forcimin dhe zgjerimin e rezistencës feministe.

Lëvizjet antigjinore janë rritur viteve të fundit në mbarë botën, si një ndër pasojat e shumta të populizmit. I kanë dominuar debatet publike, të elektrizuara edhe nga rrjetet sociale, duke u mbështetur nga e djathta, organizatat konservatore dhe ato fetare.

Përkundër konsideratave të periudhës postfeministe, mobilizimi në rritje i diskurseve antigjinore është duke e përplasur dhunshëm faktin që patriarkaliteti klasik vazhdon të jetë pjesë e pandashme e politikës. E shohim një rritje botërore të lëvizjeve kundër të drejtave themelore të njeriut dhe kundër gjinive të ndryshme, të shoqëruara me kriza të shumta.

Një lëvizje antigjinore tash ka prezencë të dukshme edhe në Kosovë. Ndonëse është vënë në sipërfaqe shumë më zëshëm së fundmi, ajo që një kohë ka zënë fill, por deri tani ishte më e dobët sesa lobimet progjinore, veçanërisht për kalimin e ligjeve të rëndësishme. Shpeshherë narrativat antigjinore kanë qenë mjete përmes së cilave kanë ardhur në shprehje agjendat nacionaliste e konservatore që nga paslufta. Grupe të caktuara politike i kanë instrumentalizuar normat patriarkale për rritje elektorale, gjë që është duke u theksuar edhe tani kur zgjedhjet e reja duken në horizont. Me afrimin e tyre, sulmet ndaj personave LGBTQI+, grave dhe komuniteteve joshumicë kalojnë në skenën kryesore.

Këto reagime agresive nga grupet konservatore/fetare nuk janë çdoherë në përputhje mes vete, por dinamizohen kur është në pyetje negocimi i pushteteve. Ato pajtohen dhe e vendosin reagimin në tri pika: prishjen e rendit heteronormativ, rrezikimin e familjes tradicionale dhe emancipimin e autonominë trupore të grave. Këto janë të dukshme kur vendosen përballë dinamikave të dekadës së fundit, kundrejt të cilave po organizohen lobimet e tashme. Gratë e sotme kosovare janë më vendimmarrëse për lindjen e fëmijëve dhe për kohën kur do t'i kenë.

Diskurset antigjinore janë duke marrë hov pikërisht në kontekstin e një sërë ligjesh që e sfidojnë status quo-në e dhunshme për gratë: për shëndetin riprodhues, Kodin Civil, Ligjin e Punës, Nenin 28 të Ligjin për Zgjedhjet, eliminimin e diskriminimit në tekstet shkollore, kriminalizimin e femicidit, etj. Këto grupe e kanë në dorë pushtetin vendimmarrës për ta orientuar debatin brenda Kuvendit të Kosovës, duke paraqitur devijime dhe pasaktësi. Duke i bllokuar ligjet që e promovojnë barazinë gjinore, si vlerë themeltare të Kushtetutës, rrjedhimisht sulmohet demokracia jonë.

Pasi këto grupe konservatore nuk gjejnë përkrahje direkte në popull që si të vetme ta kalojnë pragun zgjedhor prej 5 për qind, atëherë bëjnë taktika duke hyrë në gjirin e partive të mëdha, zgjidhen duke e shfrytëzuar infrastrukturën e rrjetëzuar, grupohen, fuqizohen pastaj i bllokojnë iniciativat dhe ligjet që vijnë edhe nga qeveritë e tyre.

Në vitet e ardhshme do të ketë shumë interpretime sociopolitike për ngjarjet që po ndodhin sot - shumica parlamentare e ka bllokuar Kodin Civil dhe ligjet që janë në frymën e barazisë. Paradoksalisht, kjo gjendje ka ardhur nga Lëvizja VETËVENDOSJE!, parti socialdemokrate me investimet më të mëdha ideologjike në spektrin politik. Lufta kundër personave LGBTQI+ dhe lufta kundër të drejtave riprodhuese tashmë janë kristalizuar si vlera që e dominojnë shumicën në këtë legjislaturë. Ndonëse jemi shtet sekular, ky grup/trup antigjinor përbrenda grupit parlamentar të VV-së ka për qëllim ta ul ndjeshmërinë shoqërore ndaj grupeve të margjinalizuara dhe të cenueshme.

Nga diskutimet e deritanishme, mesazhi politik vjen i qartë: gratë nuk mund të vendosin për veten e tyre, personat LGBTQI+ nuk mund të martohen, e as gratë e punësuara nuk mund të kenë të drejtat e tyre krejtësisht të garantuara. Qëllimi kryesor i këtyre ideologëve antigjini, pseudopatriotëve, transfobëve, mizogjenëve dhe homofobëve, është që legjislacionin progresiv të fituar në dekadat e fundit, si me angazhimet e grupeve LGBTQI+, ashtu edhe nga lëvizja feministe, ta ndryshojnë negativisht, duke shkaktuar regres kulturor.

Duke e sulmuar legjislacionin progresiv, e kundërshtojnë lirinë riprodhuese të grave dhe të drejtat e prindërve të vetëm dhe i mohojnë të drejtat ligjore dhe sociale të njerëzve LGBTQI+. Moskalimi i ligjit për Frytnim të Asistuar, fatkeqësisht, ngjan me lëvizjet arkaike ekstremiste antiabort.

Të gjitha këto ligjërime e ideologji patriarkale janë të njohura për ne. I njohim strategjitë të cilat janë duke e instrumentualizuar gjininë dhe konfliktin ekzistues që e kanë me votën në rritje të grave. Kësisoj jemi të vetëdijshme edhe për potencialin tonë rezistues e organizativ. Ne avokojmë në të gjitha

nivelet për të krijuar një shoqëri ku të drejtat e grave janë konform Kushtetutës së Kosovës, ndërsa liria dhe drejtësia për gratë, vajzat dhe personat LGBTQI+ janë idetë me të cilat qeveriset shoqëria. Por, nuk mund të arrijmë të vetme të ndërhyjmë në politikat që janë për të mirën e këtij vendi. Edhe nëse lëvizjet për të drejtat e njeriut, të grave dhe të personave LGBTQI+, janë shumë të revoltuara dhe reaguese ndaj këtyre kundërshtimeve institucionale dhe aleancave antigjinore, prapëseprapë do të jetë e rëndë që këto çështje të mbesin lart si prioritete. Prandaj, është absolutisht e domosdoshme që politikat e solidaritetit dhe të të drejtave të zgjerohen përtej grupeve feministe dhe bashkojnë akterë të ndryshëm shoqërorë dhe politikë.

Ne nuk kemi alternativë.

Autorja është Drejtore Ekzekutive e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore.

Shfrytëzimi i krizës për progres

Tania Ivanova

Në kohë krizash, qofshin ato sociale, ekonomike apo politike, struktura e shoqërisë vihet në provë, duke ndriçuar si pikat e forta ashtu edhe të metat e saj, si dhe duke ekspozuar pabarazitë sistematike dhe padrejtësitë e rrënjosura thellë që vazhdojnë të jenë brenda shoqërive tona. Dhe, ndërsa kriza mund të jetë destabilizuese dhe kaotike, ajo gjithashtu paraqet një mundësi unike për reflektim dhe transformim. Kjo është më se e dukshme në fushën e të drejtave të grave, ku momentet e përçarjes kanë shërbyer shpesh si katalizatorë për aktivizmin politik dhe angazhimin e përbashkët për barazinë gjinore dhe drejtësinë sociale.

Përgjatë historisë gratë janë sfiduar me barriera sistematike afatgjata për pjesëmarrjen e tyre të plotë në sferat publike dhe politike. Nga mohimi i të drejtës për të votuar e deri te ballafaqimi me barriera në qasje në arsim dhe punësim, apo diskriminim në rolet drejtuese, rrugëtimi drejt barazisë gjinore ka qenë i gjatë dhe sfidues. Megjithatë, historia dëshmon gjithashtu ndikimin e thellë të krizave në avancimin e të drejtave të grave. Nga lëvizjet e të drejtës së votës në fillim të shekullit të 20-të, deri te protestat feministe të viteve 1960 dhe 1970, momentet e trazirave sociale, ekonomike dhe politike i kanë gjallëruar vazhdimisht lëvizjet për ndryshim të udhëhequra nga gratë. Këto periudha i kanë detyruar shoqëritë të përballen me paragjykimet dhe pabarazitë e tyre, duke inkurajuar individët dhe komunitetet të kërkojnë drejtësi dhe barazi për gratë.

Megjithëse është bërë përparim, falë përpjekjeve të palodhura të aktivisteve dhe avokatëve që kanë luftuar për ndryshim kundër perspektivave kundërshtuese, gratë vazhdojnë të përballen me sfida të shumta në kërkimin e tyre për përfaqësim dhe njohje të barabartë. Dhuna me bazë gjinore, pagat e pabarabarta, qasja e kufizuar në arsim dhe kujdes shëndetësor dhe nën-përfaqësimi në proceset vendimmarrëse, vazhdojnë si padrejtësi flagrante që minojnë parimet e barazisë dhe demokracisë pjesëmarrëse. Sot, ndërsa lundrojmë në kompleksitetin e shekullit të 21-të, ne e gjejmë veten përballë një grupi të ri sfidash, nga pandemia globale te ndryshimet klimatike, pasiguria ekonomike, paqja e brishtë dhe polarizimi politik. Ndaj këtyre sfidave, rëndësia e avokimit për të drejtat e grave në jetën publike dhe politike, si dhe nevoja për aktivizim dhe përkushtim të përbashkët, bëhen edhe më të theksuara.

Ne, thjesht, mund ta shohim ndikimin joproporcional të pandemisë COVID-19 tek gratë për të kuptuar se si krizat mund t'i përkeqësojnë pabarazitë gjinore. Nga humbja e vendeve të punës dhe paqëndrueshmëria ekonomike tek rritja e përgjegjësive të kujdesit dhe rritja e rreziqeve të dhunës dhe abuzimit në familje, gratë bartën peshën kryesore të pasojave të pandemisë. Ndërsa ekonomitë u mbyllën dhe sistemet e kujdesit shëndetësor sforcoheshin nën peshën e pandemisë, gratë u gjendën të prekura në mënyrë disproporcionale. Pandemia zbuloi pabarazitë strukturore që vazhdojnë brenda shoqërive tona, duke nënvizuar nevojën urgjente të veprimit për avancimin e të drejtave të grave. Dhe, pavarësisht nga të gjitha sfidat me të cilat u përballën gratë, ato janë shfaqur gjithashtu si lidere dhe agjente të ndryshimit, duke nxitur biseda rreth të drejtave të njeriut, barazisë dhe drejtësisë, në mënyra të paprecedente.

Aktivizmi politik luan rol vendimtar në nxitjen e ndryshimeve dhe ka qenë i dobishëm në avancimin e përfaqësimit të grave në jetën publike dhe politike. Në vendet ku gratë kanë qenë historikisht të nën-përfaqësuara në politikë, përfshirë Ballkanin Perëndimor, iniciativat bazë kanë luajtur një rol kryesor në thyerjen e barrierave dhe fuqizimin e zërit të grave. Në të gjithë globin dhe brenda rajonit tonë, gratë janë organizuar dhe mobilizuar për të sfiduar sistemet patriarkale dhe për të kërkuar një vend në tryezë, duke afirmuar praninë dhe ndikimin e tyre në arenën politike dhe duke i sfiduar strukturat tradicionale të pushtetit. Nga lëvizjet bazë deri te protestat në shkallë të gjerë dhe politikanet pioniere, gratë kanë qenë në ballë, duke nxitur politika që promovojnë barazinë gjinore dhe qeverisjen gjithëpërfshirëse. Në arenën politike kjo ka çuar në një rritje të numrit të grave që konkurrojnë për poste, të frymëzuara nga mundësia e ndryshimit nga brenda. Këto gra sjellin me vete perspektiva dhe përvoja të ndryshme, duke riformuar diskursin politik dhe agjendat e politikave në mënyra që u japin përparësi nevojave dhe të drejtave të grave, si dhe komuniteteve të margjinalizuara. Megjithatë, përkundër përmirësimit të përfaqësimit në nivel parlamentar, kur bëhet fjalë për pushtetin ekzekutiv gratë ende mbeten prapa.

Prandaj, në kohët e polikrizës, si këto që po jetojmë, aktivizmi politik është edhe më domethënës dhe mund të shërbejë si një dritë shprese dhe qëndrueshmërie përballë fatkeqësive. Për më tepër, ai mund të jetë një mjet i fuqishëm për rritjen e ndërgjegjësimit dhe nxitjen e solidaritetit. Mirëpo, avancimi i të drejtave të grave në jetën publike dhe politike kërkon më shumë sesa thjesht aktivizëm - ai kërkon një angazhim kolektiv për drejtësinë sociale dhe barazinë gjinore. Kërkon që qeveritë të miratojnë dhe zbatojnë politika që mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e grave, si dhe institucionet për të nxitur mjedise gjithëpërfshirëse që fuqizojnë gratë për të marrë pjesë plotësisht në jetën publike. Për më tepër, ai kërkon që individët të shqyrtojnë paragjykimet dhe privilegjet e tyre, të sfidojnë stereotipat e dëmshëm dhe të mbështesin në mënyrë aktive përpjekjet për t'i rrëzuar sistemet e shtypjes. Ai kërkon solidaritet ndërmjet gjinive, etnisë, klasës dhe kombësisë, duke pranuar se lufta për të drejtat e grave është e lidhur thelbësisht me betejat më të gjera për drejtësi dhe barazi.

Ky angazhim kolektiv bëhet edhe më kritik në kohë krize, kur aksionet janë më të lartat dhe ka ardhur koha për të shfrytëzuar sërish fuqinë e vërtetë të veprimit kolektiv, për t'u bërë thirrje individëve dhe komuniteteve që të bashkohen për të mbështetur njëri-tjetrin dhe për të nxitur ndryshimin. Aktivizmi politik dhe një angazhim i përbashkët për barazinë gjinore janë mjete të domosdoshme për ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe më të qëndrueshme. Sidomos sepse forcat e rezistencës dhe reagimit janë gjithmonë të pranishme, duke kërkuar të minojnë përfitimet e grave dhe të rikthejnë kohën pas barazisë gjinore. Dhe historia ka treguar, herë pas here, se përparimi është i mundur, edhe ndaj gjasave në dukje të pamposhtshme.

Prandaj, ndërsa shikojmë nga e ardhmja, avancimi i të drejtave të grave në jetën publike dhe politike duhet të mbetet si fokus në përpjekjet tona kolektive për të ndërtuar një botë më të drejtë dhe më të barabartë. Kjo kërkon jo vetëm aktivizëm politik dhe angazhim të përbashkët, por edhe një ndryshim thelbësor në qëndrimet dhe bindjet tona për rolet dhe përgjegjësitë gjinore. Ne duhet të sfidojmë nocionin se gratë janë disi "më pak të afta", ose "që meritojnë më pak" për poste drejtuese, dhe në vend të kësaj të njohim vlerën dhe dobinë e qenësishme të çdo individi, pavarësisht nga gjinia. Ne duhet t'i çmontojmë sistemet e shtypjes dhe diskriminimit që i kanë mbajtur gratë të margjinalizuara për një kohë të gjatë dhe të krijojmë struktura e institucione të reja që pasqyrojnë diversitetin dhe kompleksitetin e botës sonë. Mbi të gjitha, ne duhet të pranojmë se avancimi i të drejtave të grave dhe pjesëmarrja e grave në jetën publike dhe politike nuk është vetëm një çështje e grave - është një çështje themelore e të drejtave të njeriut që na prek të gjithëve! Dhe duhet kuptuar jo vetëm si një çështje e domosdoshme morale, por edhe si një domosdoshmëri strategjike. Kur gratë fuqizohen dhe përfshihen në proceset vendimmarrëse, shoqëritë janë më të qëndrueshme, më të begata dhe më të drejta. Pra, na takon të gjithëve që të bëjmë thirrje për veprim dhe të punojmë së bashku pa u lodhur drejt një të ardhmeje ku çdo grua dhe vajzë, si dhe burrë e djalë, mund ta realizojnë potencialin e tyre të plotë dhe të kontribuojnë në lulëzimin e shoqërisë sonë.

Autorja është Presidente e Reaktor – Hulumtim në Veprim, Shkup.

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Një rrëfim tjetër për gratë në politikë

Sibel Halimi

Tregimi për "gratë në politikë" sot duhet të rikonceptohet nga gratë për gratë. Në të kundërtën, vështirë që vajzat e reja do të kenë vullnetin të kontribuojnë për vendin nëpërmjet angazhimit të tyre në politikë.

Boshti kryesor i temave mbi të cilat është ndërtuar narrativa e përfshirjes së "grave në politikë" thuajse nuk ka ndryshuar që nga paslufta. Operimi me tema të njëjta për vështirësitë e grave në politikë, siç janë kuotat dhe mundësitë e barabarta, nuk ka sjell rezultate për ndërtimin e një mendësie të re politike dhe shoqërore. Kjo për faktin se gratë në politikë kanë stagnuar në harmonizimin e dinamizimit të agjendës së tyre politike me ndryshimet shoqërore që po ndodhin në vend dhe përfaqësimit të interesave të grave e vajzave.

Korniza konceptuale e politikës, e përbërë nga çështjet që lidhen kryesisht me rikthimin e temave nacionaliste, e ka bllokuar inicimin e çështjeve që shpijnë shoqërinë drejt emancipimit. Rrjedhimisht, edhe gratë nuk kanë arritur t'i tejkalojnë barrierat e krijuara tanimë, duke ua pamundësuar që ato të bëhen zëri i ndryshimit. Fatkeqësisht, rikthimi në diskursin publik i mizogjenisë është ndihmuar edhe nga heshtja e grave në politikë dhe në debatin shoqëror. Ndryshimet që po ndodhin në shoqërinë kosovare - pavarësia dhe vendimmarrja e grave, sado simbolike, por me fuqi mediale, është duke i mobilizuar ideologjitë konservatore që janë në të kundërtën e fuqizimit të grave në veçanti, si dhe emancipimit shoqëror në përgjithësi. Në një kontekst të tillë, politika në mungesë të vetëdijes e vizionit të qartë të orientimit vleror properëndimor ka rënë në grackë. Madje edhe institucionet shtetërore, të cilat janë krijuar nga vlerat demokratike, janë duke u shfrytëzuar për qëllime propagandistike në dëm të vlerave demokratike. Ndaj, si kurrë më parë, shtrohet nevoja që gratë e politikës ta braktisin traditën patriarkale, duke e zëvendësuar me qëllime më të rëndësishme, siç është promovimi e garantimi i lirisë individuale, të cilat duhet të mbrohen dhe të respektohen nga qeverisja dhe strukturat shoqërore.

Kushtetutshmëria, streha e vetme për gratë

Trupi i grave është më shumë se një entitet fizik, është një shtëpi për identitetin dhe përvojën e saj njerëzore. Në shoqëritë patriarkale, trupi i grave është i nënshtruar ndaj parimeve dhe normave të cilat përputhen me ideologjinë patriarkale. Ndaj, si i tillë në politikë, trupi i grave është shfrytëzuar për t'i përmbushur pritjet dhe kërkesat e shoqërisë. Pikërisht në një kontekst të tillë, çështjet që determinojnë vendimmarrjen e grave mbi trupat e tyre prekin direkt kallon e shoqërisë patriarkale. Prandaj, nuk është i rastësishëm shqetësimi i krijuar për Projektligjin për Shëndetin Riprodhues dhe Fertilizim të Asistuar Mjekësor. Gjuha e urrejtjes në diskursin publik lidhur me projektligjin ka shpërfaqur rezistencën për emancipimin dhe diversitetin e shoqërisë. Liria dhe e drejta individuale, të garantuara më Kushtetutën e Republikës së Kosovës, janë vlerat e vetme që duhet të përfaqësojë secili/secila deputet e deputete. Botëkuptimet personale të referuara identiteteve të tjera do t`i sjellin dëm të madh vetë gruas dhe përpjekjes historike të elitave për të ndërtuar një shoqëri të lirë dhe demokratike.

Jehona e zërave kundërshtues për moskalimin e projektligjit, e sidomos gjuha e urrejtjes e shpërfaqur në debatin shoqëror, është përtej mandatit që përfaqëson edhe Kryetarja e Komisionit për të drejta e njeriut, Dude Balje. Ndaj, lirimi i një posti të tillë është domosdoshmëri emergjente, jo për arsye të bindjeve konservatore, por për shkak të mospërfilljes së laicitetit të shtetit. Heshtja dhe indiferenca e të gjitha grave që janë të përfshira në jetën publike është pranim i cenueshmërisë që po i bëhet të gjitha grave dhe vajzave në Kosovë.

"Gratë në politikë" vs. "Burrat në politikë"

Për ta kuptuar pozitën e grave në politikë dhe në jetën publike mjafton të shtrohet pyetja: Çfarë jemi duke menduar tani? Gjuha e urrejtjes, fyerja dhe mizogjenia, sot janë pothuajse karakteristikat esenciale që e përbëjnë diskursin publik. Në këtë gjendje shoqërore në të cilën jemi, gratë në politikë nuk kanë arritur të sjellin një model tjetër inkurajues për vajzat që pretendojnë të merren me jetën publike në përgjithësi. Ndaj, si i tillë, subjektiviteti i tyre është thuajse i shkrirë brenda formacioneve të paracaktuara, i trashëguar nga sistemi vleror e i etabluar tanimë. Politikën kosovare sot e karakterizon, në çështjet që lidhen me gratë dhe vajzat, kryesisht izolimi brenda gjinisë. Politika duhet t'i rikonceptojë gratë në politikë, pikërisht duke e dekonstruktuar e zhvendosur atë nga identiteti kolektiv në atë individual. Asnjëherë deri më tani nuk është dëgjuar sintagma: "Përfshirja e burrave në politikë". Përhumbja e nocionit "burrë" është predispozuar ta tejkalojë identitetin gjinor, rrjedhimisht duke e glorifikuar deri tek një sundimtar të heshtur, fuqia e të cilit është përbrendësuar aq thellë në mendësinë kolektive.

Përfshirja e grave në politikë, si një koncept që vë në spikamë "gruan", determinoi edhe fatin e saj në politikë. Tanimë identiteti personal i krijuar më shumë mund, barazon dhe shkrin atë brenda kategorisë "gratë në politikë". Pavarësisht përpjekjes qëllimmirë në fuqizimin e grave në politikë, megjithatë përdorimi i sintagmës "gratë në politikë" dëmtoi rëndë shëndetin politik të tyre brenda partive politike. Për fat të keq, gratë që kanë zgjedhur angazhimin në politikë janë të kurthura në kritikim të çdo hapi që bëjnë. Nëse janë pasive dhe nuk e ngritin zërin, cilësohen si të dobëta, të varura dhe të nënshtruara ndaj burrave. Nëse revoltohen dhe kërkojnë veprim institucional për çështje që preokupojnë vet ato dhe shoqërinë, emërtohen si "të egra", "të frustruara", e deri edhe "histerike".

Një shoqëri që ka prirjen për të vënë nën llupë çdo veprim të grave, e në anën tjetër duke injoruar "elefantin në dhomë" - aferat korruptive, e çka jo tjetër, të burrave - vështirë të arrijë të përfitojë nga potenciali i fjetur i gjysmës së përbërjes së saj. Sepse në fund të fundit, vlerat njerëzore, profesionale e intelektuale, duhen peshuar aq sa vlejnë realisht, pa optikën e deformuar të diferencimit gjinor.

Autorja është Drejtore e Kulturës në Komunën e Prishtinës.



Koha për gratë dhe vajzat

Anisa Ruseti

Në Shqipërinë e vitit 2024, 10 nga 17 ministri në Kabinetin Qeveritar drejtohen nga gra dhe vajza; Kryetarja e Kuvendit është grua, 48 nga 140 deputetë në Kuvend janë gra dhe vajza; 4 nga 5 nënkryetarët e Bashkisë Tiranë janë gra, ndërsa Këshilli Bashkiak i Tiranës drejtohet nga një grua.

E nis me këtë panoramë statistikore për të dëshmuar që në krye të këtij shkrimi se koha për gratë ka ardhur në Tiranë. Por, teksa jam e palëkundur në bindjen time se gruaja nuk është një qenie e dobët, apo e pamjaftueshme, kam po ashtu bindjen se gratë ende nuk e vlerësojnë angazhimin publik e shoqëror me të njëjtën rëndësi që i japin familjes.

Studimet e fundit në Shqipëri tregojnë, paradoksalisht, dy anë të ndryshme të së njëjtës medalje. Nga njëra anë, një studim i fundit i FES tregon se 89% e të anketuarave mendojnë se duhet të ketë më shumë gra të përfshira në politikë, se vendi duhet të ketë një kryeministre grua, dhe se vendi duhet të ketë një presidente grua. Por, nga ana tjetër, po vetë të intervistuarat tregojnë shumë pak vullnet për t'u përfshirë në politikë, me arsyetimin (ose justifikimin) se gratë paragjykohen më shumë se burrat, dhe se stereotipat gjinorë në lidhje me detyrimet për familjen dhe shoqërinë vazhdojnë të jenë ende të forta dhe praktikisht shërbejnë si deterrent. Pra, teksa të rejat dhe gratë besojnë se pjesëmarrja e tyre duhet të jetë më e lartë dhe se kjo pjesëmarrje ndikon pozitivisht në avancimin e shoqërisë, një opinion i tillë nuk përkthehet në angazhim vetjak, e rrjedhimisht kjo krijon efektin e një rrethi vicioz i cili nuk lejon një ndryshim të situatës.

Pavarësisht paradoksit të lartpërmendur, ekziston një potencial i jashtëzakonshëm i grave dhe vajzave për t'u pozicionuar në politikë e angazhim publik, ani pse përqindjet na vendosin përpara një reflektimi të detyruar lidhur me faktin që gratë dhe vajzat janë ende nën ndikimin tepër të fortë të stereotipave mbizotërues në shoqërinë tonë, teksa ndryshimi do të duhet të ndodhë në nivel personal e institucional. Si mund të nisë ky ndryshim, veçanërisht nën optikën e pushtetit vendor?

Meqenëse pas familjes, komuniteti dhe bashkia zënë një hapësirë të konsiderueshme ku gratë mund t'i shprehin lirisht qëndrimet e tyre, apo t'i sipërfaqësojnë pozicionimet e tyre politike, nisur nga eksperienca dhe rrugëtimi im disavjeçar në pozicione drejtuese në Bashkinë Tiranë, kam sigurinë se politikat dhe paketat sociale të ndërtuara me në qendër gratë dhe vajzat kanë ndikuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe në krijimin e një mjedisi më miqësor për të nxitur pjesëmarrjen në procese vendimmarrëse. Në jetën time politike kam pasur fatin dhe privilegjin të bashkëpunoj me shumë gra dhe vajza; disa tradicionalisht të përkushtuara ndaj familjes, ashtu si edhe të tjera të dedikuara për të lënë një gjurmë në aktivizmin shoqëror, profesional e politik. Tradita jonë e mbrojtjes me shumë dashuri të familjes vijon të ketë një vlerë shumë e madhe shoqërore, e cila duhet lartësuar përherë në memorien kolektive për ta vlerësuar gruan në rolin e saj. Sidoqoftë, ne nuk duhet të lejojmë që gruaja të simplifikohet vetëm me punën dhe kohën ende të pavlerësuar në familje, pasi shoqërisë i duhet mprehtësia dhe inteligjenca sociale dhe profesionale e gruas. Roli i saj është i pazëvendësueshëm brenda mureve të një shtëpie të ngrohtë e të konsoliduar, ashtu sikundër energjia e saj është e pamatshme brenda një shoqërie që ndryshon dhe kërkon të ndryshojë drejt së mirës, drejt harmonisë sociale dhe progresit koheziv.

Sipas të dhënave nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, në Shqipëri, gratë dhe vajzat në shkencë pasqyrojnë një kontribut më të madh sesa burrat, angazhohen më shumë se ta, teksa gradat e titujt akademik përfitohen më shumë nga gratë dhe vajzat sesa nga burrat dhe djemtë. Ky është një moment për t'i përgëzuar dhe inkurajuar edhe më tej gratë dhe vajzat në shkencë, sakrificën e tyre për të shënjuar suksesin, por edhe për t'i dhënë një produkt të dobishëm shoqërisë, botës akademike dhe zhvillimit socio-ekonomik. Njëkohësisht thirrja duhet të vijë për gratë që të mbështesin e lartësojnë të tjera gra e vajza përreth tyre. Fuqizimi i njëra-tjetrës nuk është një mision për t'i dominuar burrat, por kundërpërgjigje natyrale e intuitive e faktit se gratë dhe burrat janë qytetarë të dorës së parë dhe se rrugëtimi tyre drejt suksesit (në familje a profesion), duhet të ketë përgjegjësi dhe përfitime të barabarta.

Në mbyllje dëshiroj t'i falënderoj gratë dhe vajzat e Tiranës për profesionalizmin dhe investimin e tyre në shoqëri; gratë dhe vajzat sipërmarrëse për kontributin që japin në ekonominë e qytetit; gratë dhe vajzat e shoqërisë civile për riskun që ndërmarrin, kurajën dhe këmbënguljen për të mos lënë pas dore asnjë kauzë a çështje sociale, mjedisore, ekonomike, politike të qytetit. Tirana jonë është kurorëzuar si Kryeqyteti i Rinisë, Qyteti Evropian i Sportit, apo Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut, por jam e bindur që nëse do të kishte një të tillë, do të merrte dhe çmimin si Kryeqyteti i Grave dhe Vajzave, si kampione e mjedisit miqësor dhe mbështetës për fuqizimin dhe promovimin e grave dhe vajzave në çdo fushë publike. Le të vijojmë me mbështetjen ndaj njëra-tjetrës, me shpresën se vajzat tona do të rriten me dashurinë për familjen dhe me forcën për profesionet dhe pasionet e tyre!

Bashkia Tiranë.

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Barazia gjinore e grave: Për barazinë, lirinë e "grabitur" dhe rezistencën

Biljana Kašić

"'Nuk është një koncept mobilizues për të rinjtë dhe as 'sexy'", më tha së fundmi një nga studentet e mia që e konsideron veten përfaqësuese të brezit queer dhe e trajton çështjen e identiteteve seksuale/gjinore, veçanërisht çështjen e grave dhe luftërat që bëjnë për barazinë e tyre, si një angazhim të vjetruar ose diçka passé. Edhe pse e di që çështja e barazisë sipas gjinisë/seksit është shumë më komplekse dhe nuk mund të reduktohet lehtësisht në identitete queer apo teori queer, dhe se lufta për barazinë e grave është jashtëzakonisht e rëndësishme sot dhe tani, është e nevojshme të njihen dallimet e brezave, pozicionimi i tyre dhe vendet e motivet identifikuese, prandaj i gjithë komuniteti LGBTIQ ka pasionet e veta, agjenda e veta, por edhe polemikat e veta. Dhe a është të menduarit dhe/ose të jetosh përtej matricës heteroseksuale e vetmja kërkesë feministe që po e vendosim sot, të vetëdijshme në të njëjtën kohë sa shumë telashe ka prodhuar, siç bëri të njohur Judith Butler në vitin 1990, në librin e saj të famshëm "Gender Trouble: Feminism and the Subversion of Identity"? Por, ajo që mua, si pjesëtare e të ashtuquajturit brez i vjetër i feministeve më bën jehonë gjatë gjithë kohës, dhe që ne e kemi anashkaluar, pra atë që na ka munguar në dy dekadat e fundit, ka të bëjë pikërisht me çështjen e barazisë si një projekt emancipues i të gjitha qenieve njerëzore, veçanërisht të grave. Si të vihet sërish në fokus çështja e grave? Dhe pse barazia e grave, kur konsiderohen si të rendit të dytë, duhet të anulojë në çfarëdo mënyre çështjen e barazisë së të gjithë atyre të tjerëve që diskriminohen për shkak të karakteristikave të tyre të ndryshme seksuale/gjinore, klasore, etnike, racore apo migrante?

Jemi dëshmitarë se barazia gjinore, veçanërisht barazia gjinore e grave, sot fatkeqësisht i përket temave me pak interes jo vetëm tek të rinjtë, sado që ata/o e konsiderojnë veten feministë, por edhe si tema që pothuajse nuk e tërheqin vëmendjen e publikut. Dhe kjo nuk është për shkak se barazia gjinore e grave është arritur në një masë më të madhe, ose më të vogël, dhe për këtë arsye barazia e grave në hapësirën publike nuk duhet të avokohet, ose, për shembull, sepse më shumë gra në poste drejtuese kanë status të barabartë. Përkundrazi, pozita e gruas, si në rajonin tonë ashtu edhe në botë, me gjithë proklamimet dhe aktet ligjore që e promovojnë barazinë në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar, sado paradoksale të duket, është jashtëzakonisht shqetësuese.

Konteksti në të cilin jetojmë, pavarësisht nëse po flasim për nivel lokal apo global, në të njëjtën kohë neutralizoi dhe "paqësoi" kërkesat feministe brenda procesit të integrimit gjinor, veçanërisht nga vitet 2000 e në vazhdim. Nga ana tjetër i pengoi disa nga mundësitë e veprimit feminist për shkak të ca turbulencave dhe bashkimeve të reja të famshme - konsumerizmit dhe vëllazërisë kapitaliste-militariste brenda kapitalizmit global.

Kur e adresojmë problemin e parë, duhet theksuar se feministet në vendin tonë dhe në botë mbështetën me gjithë zemër agjendën e barazisë gjinore të shprehur në konceptin e integrimit gjinor, i cili u iniciua në Konferencën Botërore për Gratë në Najrobi, në 1985, dhe e cila më pas u përdor si një strategji ndërkombëtare për zbatimin e politikës së barazisë gjinore, e miratuar në Konferencën e Katërt Botërore të Kombeve të Bashkuara për Gratë, në Pekin, në 1995, si dhe në Këshillin e Evropës në 1998. Promovimi i politikës me ndërgjegjësim gjinor në të gjitha nivelet (nga politika në arsim, nga bota e privatësisë në tregun e punës), e mbështetur nga mekanizma dhe mjete institucionale, nënkuptonte një hap të madh ligjor përpara për feministet, por edhe detyrimin e çdo shteti që të angazhohet në mënyrë aktive në arritjen e barazisë së grave dhe gjinive/sekseve të tjera. Por, shpejt u bë e qartë se jo vetëm që rendi normativ nuk mund t'i përgjigjej problemit të modeleve të diskriminimit të rrënjosura në shoqëri dhe të jotransparencës së bazuar në seks/gjini, por se për qeveritë e shumë vendeve, përfshirë Kroacinë, çështja e barazisë gjinore ishte vetëm një "kamuflazh", ose një imazh simbolik i përshtatshëm që i shërben demokracisë së sapovendosur.

Prandaj, për mendimin tim, dy dekadat e fundit kanë qenë të vështira për feministet dhe organizatat feministe në çdo aspekt: ato duhej të angazhoheshin në një dialog rraskapitës dhe shpesh joproduktiv me akterët e autoriteteve politike në lidhje me zbatimin e politikës së integrimit gjinor (gender mainstreaming), sidomos për sa i përket luftës kundër dhunës ndaj grave, të drejtave riprodhuese dhe arsimimit me ndjeshmëri gjinore. Nga ana tjetër, shpërndarja e urdhrave që u vendosën para tyre në një mënyrë të re hapi pyetjen: kush është subjekti feminist, cili është legjitimiteti i tij dhe ku janë gratë? Gjithashtu duhet theksuar se zgjidhjet inovative, radikale dhe etike feministe janë të kooptuara dhe shpesh të pakuptimta brenda kalkulimeve të ndryshme politike kur bëhet fjalë për barazinë reale të grave, gjë që ka sjell zemërimin dhe zhgënjimin e disa feministeve dhe largimin e tyre nga strukturat aktuale politike në vendet e tyre. Ndërsa teoricienja gjermane Birgit Sauer beson se në të ashtuquajturat vende në tranzicion të bllokut postsocialist, strategjia e konsolidimit të demokracisë u realizua përmes "normalizimit të maskulinizimit", si në teori ashtu edhe në praktikë, ose, siç e përshkroi ajo në mënyrë të konsiderueshme diskursive: si transformimi nga mainstreaming në drejtimin te malestreaming (Sauer 2001:27), feministja sllovene Vlasta Jalušič konsideron me të drejtë se një nga implikimet e politikës me vetëdije gjinore (gender mainstreaming) është prodhimi i "degendering" (Jalušič 2009:60), duke iu referuar aspekteve të ndryshme të pabarazisë gjinore, por edhe depolitizimit të "çështjes së grave". Do të doja të shtoja gjithashtu një vërejtje feministe, se politikat e gender mainstreaming nuk mund të reduktohen në menaxhim tekniko-normativ dhe as suksesi i tyre nuk mund të analizohet vetëm nga numri i organeve për barazi gjinore.

Problemi i dytë i përmendur ka të bëjë me pozitën e palakmueshme të gruas në tregun kapitalist të punës, e cila mbështetet nga ekonomia e punës shtëpiake, pa pagesë, kryesisht të kryer nga gratë (Burcar 2020:16), dhe bazohet në shfrytëzimin intensiv dhe pasigurinë e grave, shërbimin e tyre ndaj kapitalit të lëvizshëm dhe mohimit të qasjes në shumë burime.

Profesionet prestigjioze dhe të privilegjuara, ato që sjellin pushtet, fitim dhe ndikim, sipas të gjithë treguesve përkatës, më së shpeshti janë jashtë shtrirjes së grave. Aranzhimet e paskrupullta kapitaliste-politike janë në skenë, pasojat e të cilave janë rritja e pabarazive ekonomike globale dhe varfëria, e cila prek kryesisht gratë nga vendet e jugut të globit. Ndërkohë që media, duke prodhuar mashtrime optike (simulakrume), promovon kategoritë e suksesit dhe konkurrencës si leva për përgjegjësinë individuale të secilit prej nesh brenda ekonomisë neoliberale. Njëkohësisht, në të njëjtën paketë mediatike pohohen stereotipat e seksualizuar gjinorë, sipas të cilëve gratë po bëhen gjithnjë e më shumë objekt i komodifikimit të krijuar rishtas (në formën e një "vajze të sponsorizuar", ose një objekti joshës në botën e tregtisë apo prostitucionit).

Shkurtimisht, me çdo analizë serioze të barazisë substanciale të grave ne duhet të jemi në gjendje ta zbulojmë lidhjen midis tregtisë së grave dhe mashtrimeve efikase të kapitalizmit global, si dhe lidhjen midis feminizimit në rritje të punës dhe pozitës së skllevërve e grave me dinamikën e ekonomisë libidinale të spektaklit, kapitalizmit politiko-financiar e militarizimit të shoqërisë. Unë besoj se shumë çështje janë përsëri aktuale sot, për të cilat qindra mijëra gra protestuan në dekadat e para të shekullit të 20-të, duke filluar nga 8 marsi 1857, kur punëtoret e tekstilit protestuan publikisht në Nju Jork, duke lënë të kuptohet për rezistencën dhe luftën e grave për të drejta të barabarta me burrat. Kërkesat për paga më të mira dhe përmirësimin e kushteve të punës i përkasin korpusit të të drejtave njerëzore të grave dhe kanë të bëjnë me gratë si subjekte të barabarta dhe të drejtën e tyre për një jetë dinjitoze e të barabartë, si dhe për zgjedhje. Sepse barazia e vërtetë e grave nuk është vetëm një çështje e barazisë si barazi normative me burrat, por hap hapësira dhe imagjinata të lirisë, kryesisht duke premtuar liri nga kushtet e shtypjes.

Në atmosferën e tendencave neokonservatore dhe retrograde gjatë dy dekadave të fundit, të shënuara nga shprehja "politika antigjinore", e cila do t'iu grabiste grave të drejtat e tyre tashmë të zgjedhura si dhe idenë e lirisë, angazhimi feminist është drejtuar në të dyja kërcënimet në të njëjtën kohë. E drejta e luftuar për të votuar, e drejta e zgjedhjes riprodhuese dhe zgjedhja seksuale, autonomia trupore, pavarësia ekonomike dhe statusi i barabartë i punës, drejtësia epistemologjike, transgresiviteti i identifikimit seksual/gjinor, e drejta për jetë pa dhunë patriarkale - janë pikat aktivizuese të betejave feministe sot. Mundësia e suksesit të tyre varet nga mbështetjet dhe lidhjet transgjeneracionale, solidariteti feminist dhe aleancat më të gjera të akterëve përparimtarë. A jemi gati për këtë sot dhe në këtë 8 Mars?

Autorja është teoriciene feministe, profesoreshë dhe aktiviste e paqes / Qendra për Studime të Grave dhe Universiteti Vern, Zagreb.

CyanMagentaYellowBlack

Urrejtja ndaj grave në politikë, online!

Rezarta Delibashzade Krasniqi

Rritja e dezinformimit gjinor ndër vite ndikon në uljen e gatishmërisë që gratë të angazhohen dhe kontribuojnë në jetën publike dhe atë politike.

Republika e Kosovës, fatmirësisht, deri më tani ka pasur dy presidente gra, mirëpo pjesëmarrja e grave në proceset politike dhe vendimmarrëse mbetet ende çështje për t'u adresuar. Përfshirja e grave në listat zgjedhore, si pjesë e përmbushjes së kuotës dhe qasje të barabartë nga ana e subjekteve politike, e tregon jogatishmërinë e tyre për t'i fuqizuar si udhëheqëse të ardhshme, kjo si rezultat i paragjykimeve shoqërore.

Bazuar në hulumtimin e FES-it për pjesëmarrjen aktive të grave në politikë, sa i përket ndërlidhjes mes shprehjeve të pikëpamjeve në vendin e punës dhe një partie politike, shumica e të anketuarave (midis 73-78%), refuzuan të përgjigjen ose thanë se nuk ishte e zbatueshme. Andaj kjo tregon se gratë janë më të hapura për t'i shprehur pikëpamjet e tyre politike në qarqet e ngushta familjare, ku frika nga paragjykimi është më pak i mundur - sesa në qarqet e jashtme me audiencë më të madhe. Ky hezitim mund të jetë për shkak të frikës së paragjykimit nga të tjerët, ose standardit të lartë që ato ia caktojnë vetes, për t'i paraqitur publikisht mendimet e tyre politike. Ndërsa hulumtimet e viteve të fundit sa i përket aktivitetit politik tek gratë tregojnë se ka rënie për sa i përket vetëbesimit se mund të ndikojnë në vendimet politike, apo të angazhohen në subjekte politike, me një përqindje shumë të ulët, pothuajse 3%.

Nga hulumtimet e fundit në Demokraci për Zhvillim (D4D), burimi i marrjes së informacionit ka pësuar ndryshim ndër vite, ku tashmë shënon rritje marrja e informacionit nga rrjetet sociale në vend të televizionit si burim primar, e sidomos temat që ndërlidhen me politikë, me mbi 41%.

Monitorimi i platformave dhe rrjeteve sociale (të realizuar nga D4D) mbi shpërndarjen e gjuhës së urrejtjes kundrejt grave që janë aktive në politikë, tregon se gratë përballen me dhunë dhe ngacmim online më shpesh nga burrat sesa nga gratë (burrat shkruajnë 89.6% të komenteve me gjuhë të urrejtjes, kurse gratë 10.4%). Rastet e dezinformimit gjinor në media mbledhin mbi 86 reagime për një lajm – shifër tri herë më e lartë se ndërveprimi tipik për të gjitha lajmet.

Rritja e ndërveprimit online zgjeron edhe vëmendjen globale ndaj çështjeve që kanë të bëjnë me gratë dhe përvojat e tyre, ngacmimet dhe dhunën, si virtualisht ashtu edhe në realitet. Përderisa në internet mund të shprehen mendimet mbi çështje sociale dhe politike, këto hapësira janë bërë platformë për dhunë online ndaj grave dhe kryesisht mizogjinisë së shprehur në tekste.

Dhuna online drejtuar grave përfshin mënyra të ndryshme agresioni dhe frikësimi që kanë qëllim përjashtimin e grave nga politika vetëm bazuar në gjininë e tyre. Narrativat e njëanshme dhe targetimi individual i grave shfrytëzohen për t'i dekurajuar ato që të përfshihen në jetën publike dhe politike. Në të njëjtën kohë, përcjell qartë këtë mesazh në publik që edhe më tej e forcon mentalitetin patriarkal në vendin tonë.

Nga politikanet më të atakuara në rrjete sociale përmes dhunës online janë deputetja Mimoza Kusari Lila dhe Presidentja Vjosa Osmani Sadriu, përcjell edhe nga Vlora Çitaku, Doarsa Kica Xhelili, si dhe gra që janë aktive jashtë jetës politike, si Flutura Kusari e Besarta Hoti. Këto ishin rastet me klikueshmërinë dhe shpërndarjen më të lartë në rrjete sociale, ku gjuha e urrejtjes ka qenë tejet e shprehur.

Ndikimi i patriarkalitetit në përdorimin e gjuhës së papërshtatshme është faktor që s'duhet anashkaluar, e kjo paraqitet edhe në rastet ku gratë që bëjnë pyetje ose i sfidojnë kolegët e tyre burra, përjetojnë sulme të theksuara në rrjete sociale.

Margjinalizimi i dyfishtë është mjaft i theksuar gjithashtu, ku gratë e shtresave të ndryshme të margjinalizuara mund të përballen me fushata të shtuara të dezinformimit që shfrytëzojnë dimensione të shumta të identitetit të tyre, si raca, përkatësia etnike, ose orientimi seksual.

Fenomeni i gjuhës së urrejtjes dhe mizogjenisë në rrjete sociale, nuk mund të ndalohet apo ndërpritet me shkop magjik, por duhet luftuar me mekanizma institucionalë dhe shoqërorë. Ndër hapat e parë janë respektimi i Kodit të Etikës nga mediumet, luftimi i vazhdueshëm i dezinformimit, si kërkesë nga vetë qytetarët, për ta identifikuar dhe mos e shpërndarë atë, raportim i përgjegjshëm nga ana e mediave për titujt dhe paraqitjet e rasteve kur flitet për gra, si dhe edukimi i gjeneratave sa më të reja për të mos rënë pre e dezinformimit dhe mizogjenisë, por të jenë kontribuues në një shoqëri pa fyerje e urrejtje.

Autorja është Drejtore Ekzekutive në D4D.

Më shumë gra në pozita udhëheqëse në institucione të drejtësisë, më shumë drejtësi për gratë

Arrita Rezniqi

Të gjithë e njohin simbolin e drejtësisë – një grua, me sy të lidhur, duke mbajtur peshoren në njërën dorë dhe shpatën në tjetrën, për të treguar paanshmërinë në njërën anë dhe fuqinë e drejtësisë, në anën tjetër. Por kjo peshore nuk ka qenë e balancuar gjithherë për sa i përket përfaqësimit të grave në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Në kuadër të këtij sistemi ka numër të madh të grave që e kanë përgatitjen dhe guximin profesional për të ushtruar pozitën e gjyqtares, prokurores dhe avokates, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Mirëpo, ky përfaqësim i grave në sistemin e drejtësisë nuk manifestohet në mënyrë të barabartë edhe në raport me pozitat udhëheqëse kryesore të sistemit të drejtësisë. Sot, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Gjykata Supreme, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Oda e Avokatëve të Kosovës, udhëhiqen nga burrat. Asnjëra nga këto pozita të rëndësishme të sistemit të drejtësisë nuk i është besuar një gruaje për ta dhënë kontributin në menaxhim dhe administrim. Mungesa e vullnetit për t'i besuar gruas pozita drejtuese, fatkeqësisht, pastaj përkthehet me mungesë të mbështetjes adekuate dhe trajtim jodinjitoz për viktimat e dhunës me bazë gjinore, duke e kthyer kështu sistemin e drejtësisë në Kosovë jorrallë në shkelësin kryesor të të drejtave dhe lirive themelore për gratë.

Në përditshmëri gratë vazhdimisht hasin në pengesa dhe vështirësi për adresimin e të drejtave të tyre. Trajtimi jo i barabartë në vendimmarrje, por edhe mosofrimi i kushteve të barabarta për të ushtruar përgjegjësi, ndikon që roli dhe zëri i gruas në Kosovë mos ta marrë vëmendjen dhe rëndësinë e duhur. Një qasje e tillë manifestohet në kufizimin e gruas për t'i realizuar të drejtat e saj në praktikë edhe për shkak se niveli i punësimit të grave në Kosovë ende mbetet sfidues. Rrjedhimisht, varshmëria e tyre nga partnerët, apo anëtarët tjerë të familjes, u krijon vështirësi socio-ekonomike, duke kufizuar kështu qasjen e tyre në drejtësi. Kjo pastaj dukshëm kufizon edhe ngritjen e zërit për t'i sfiduar praktikat diskriminuese në vend.

Korniza ligjore e Kosovës në vazhdimësi i është nënshtruar reformave në përpjekje për avancimin e legjislacionit në promovimin e barazisë gjinore, luftimin e dhunës me bazë gjinore, diskriminim dhe mbrojtjen e të drejtave të grave. Megjithatë, kjo përpjekje mbetet vetëm gjysmake pa përfshirjen e plotë dhe kuptimplote të grave, jo vetëm si pjesëmarrëse, por edhe si vendimmarrëse brenda sistemit të drejtësisë.

Statistikisht dëshmohet se përfaqësimi i grave në sistemin e drejtësisë në Kosovë lë shumë për të dëshiruar. Nga raportet e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), të publikuara në vitin 2023, rezulton se nga 419 gjyqtarë sa ka pasur sistemi gjyqësor në fund të vitit 2022, vetëm 35% e tyre janë gra, përderisa 65% janë burra. Kurse, nga 10 gjykatat kryesore në vend, vetëm 2 prej tyre udhëhiqen nga gratë, ndërsa 8 të tjera nga burrat. Në sistemin prokurorial, nga 183 prokurorë gjithsej, rreth 43% janë gra dhe 57% të tjerë janë burra. Përderisa pozitë të Kryeprokurorit në 10 Prokuroritë në vend mbajnë vetëm prokurorët burra dhe asnjë grua. Edhe në organet më të larta, në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe atë Prokurorial (KPK), situata është njësoj. Të dy këta Këshilla udhëhiqen nga burrat, kurse nga 11 anëtarët në secilin nga këshillat, përbërja e tyre konsiston në përqindje dërrmuese të burrave, në një raport 7 me 4 në KGJK dhe 8 me 3 në KPK.

Se sa është paradoksal nënpërfaqësimi i gruas në sistemin e drejtësisë në Kosovë, përfshirë pozitat kyçe në sistemin gjyqësor, prokurorial dhe atë të avokatisë, shërben edhe fakti se Kosova është një ndër vendet e pakta në Evropën Juglindore që në periudhën përgjatë dhjetë vjetëve të fundit është udhëhequr nga dy presidente gra. Kështu, duke e njohur rolin kyç të grave në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe të barabartë, të drejtat e grave nuk duhet trajtuar vetëm mbi aspektin e avancimit të kornizës ligjore, por edhe të zbatimit në praktikë dhe ndryshimit të mentalitetit se pozitat kyçe në sistemin e drejtësisë apriori janë të destinuara, apo "të rezervuara", vetëm për burrat.

Prandaj, është e rëndësishme që të sfidohen stereotipat gjinorë për ndryshimin e këtij mentaliteti dhe kësaj praktike, për të ndikuar po ashtu edhe në frymëzimin e gjeneratave të reja. Sepse sa më shumë përfshirje të grave, dhe në veçanti sa më shumë gra që mbajnë pozita udhëheqëse përbrenda sistemit të drejtësisë, aq më shumë inkurajohen brezat e rinj në aspiratat e tyre dhe kjo çon në krijimin e një fuqie punëtore më të balancuar në një periudhë të ardhme jo aq të largët. Njëkohësisht krijon një shoqëri ku mundësitë janë të barabarta për të gjithë, ku barrierat janë të padukshme dhe kështu krijohet një kulturë e barazisë shoqërore.

Kjo barazi, e cila arrihet përmes një sistemi gjithëpërfshirës të drejtësisë, automatikisht bën që sistemi të perceptohet si më i besueshëm, gjë që nxit ndjesitë se është sistem i drejtë dhe i paanshëm. Një drejtësi e kësaj forme padyshim që rrit kërkesën për adresimin e të drejtave të qytetarëve, në veçanti të grupeve të margjinalizuara, dhe bën që kërkesa për qasje në drejtësi vazhdimisht të jetë në rritje, duke e sfiduar kësisoj hendekun midis dispozitave ligjore dhe përvojave jetësore, që ndikon tutje në avancimin e kornizës ligjore dhe aspekteve shoqërore.

Ofrimi i drejtësisë së barabartë për të gjithë mbetet gur-themel i çdo shoqërie demokratike. Prandaj, në mënyrë që lehtësimi i qasjes në drejtësi për gratë t'i japë rezultatet e veta, qëndrimet diskriminuese dhe normat patriarkale brenda sistemit të drejtësisë duhen luftuar. Dhe gratë, si një grup i margjinalizuar historikisht, mund të kontribuojnë më lehtë në adresimin e çështjeve që prekin në mënyrë disproporcionale vetë ato, por edhe grupet tjera të margjinalizuara, duke krijuar kështu një sistem jo vetëm të drejtë dhe të barabartë, por edhe të ndjeshëm dhe të përshtatshëm me nevojat dhe shqetësimet e grupeve të ndryshme.

Rrjedhimisht dhe përfshirja e grave në sistemin e drejtësisë nuk është vetëm çështje e të drejtave të barabarta për të cilat luftohet në vazhdimësi, por është një element thelbësor i ndërtimit të një sistemi të drejtë, efektiv dhe gjithëpërfshirës. Duke promovuar dhe mbështetur në mënyrë aktive pjesëmarrjen e grave në të gjitha aspektet e sistemit të drejtësisë, ne mund t'i afrohemi arritjes së një shoqërie ku sistemi i drejtësisë do të mbrojë me të vërtetë të drejtat dhe dinjitetin e të gjithë qytetarëve të saj, pa dallim.

Autorja është Menaxhere e Programit në IKD dhe Koordinatore e Qendrës për Ndihmë Juridike falas të IKD-së.

CyanMagentaYellowBlack

Kosova duhet ta kriminalizojë femicidin

Medinë Dauti

Në 13 vitet e fundit burrat i vranë 54 gra në Kosovë. A është apo nuk është kjo statistikë e saktë, nuk mund të flasim me siguri. Kjo edhe për faktin se vrasjet regjistrohen në Policinë e Kosovës veç si lloj i veprës penale, pa u detajuar në gjininë e dorasit e të viktimës. Pra, shteti nuk ofron statistika të sakta as për rastet e vrasjeve të grave, e femicidi nuk njihet e as nuk diskutohet si fenomen nga institucionet.

Ama, një gjë është e sigurt – gratë vriten e dhunohen veç pse janë gra.

Femicidi është manifestimi më i rëndë i dhunës me bazë gjinore dhe shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut. Ai ka një ndikim të madh në shoqëri, e veçanërisht ndikim direkt në jetën dhe sigurinë e grave/vajzave. Femicidi i referohet vrasjeve të qëllimshme të grave dhe vajzave për shkak të seksit a gjinisë së tyre. Këto vrasje më së shpeshti kryhen nga partneri intim, anëtarët e familjes, ose individë të tjerë që i njohin viktimat.

Sistemet patriarkale tentojnë të mos e pranojnë femicidin si fenomen, duke minimizuar brutalitetin e tij përmes narrativave të fajësimit të viktimave, banalizimit të dhunës ndaj grave dhe hezitimit për t'i bërë përgjegjës kryerësit e veprave. Për më tepër, strukturat patriarkale tentojnë shpesh t'ua mbyllin gojën të mbijetuarve, t'i dekurajojnë për raportim dhe ta përjetësojnë kulturën e mosndëshkimit.

Kur të drejtat shkelen çdo ditë e më shumë, autonomia, integriteti trupor dhe liria për të vendosur për veten nuk ekzistojnë më. Kërcënimi i të drejtave të grave mbjell dhe e betonizon frikën për jetesë të dinjitetshme. Kjo shtypje, përveç që mund të kushtojë me jetë, përshkon aspekte të ndryshme jetësore, duke ndikuar thellë në forma të shumëfishta.

Femicidi nuk mund të shtjellohet si fenomen pa i diskutuar implikimet sociale e kulturore – ai është pasqyrim i qëndrimeve të përgjithshme shoqërore dhe kulturore që i zhvlerësojnë dhe objektivizojnë gratë, duke e konceptuar lirinë e gruas përmes burrit. Burrat konsiderohen njerëz, ndërsa gratë janë diçka tjetër: femra, dytësore. Kështu, për të qenë gratë njerëz, duhet gjithmonë t'iu binden burrave dhe të ndërveprojnë përmes tyre. Për të qenë një grua, ajo duhet t'i nënshtrohet burrit dhe ta nderojë atë në këmbim të një "jete më të mirë".

Konteksti historik i dhunës me bazë gjinore në Kosovë është i rrënjosur thellë në të kaluarën, e cila nuk ka qenë aspak stabile. Konfliktet etnike në rajon, lufta në Kosovë, paqëndrueshmëria politike dhe trazirat sociale, janë vetëm disa tregues të shtypjes së shumëfishtë që është përsëritur ndër gjenerata. Kosova ka përjetuar periudha të ndryshme okupimi, gjë që domosdoshmërisht ndikon dhe përforcon normat dhe qëndrimet shoqërore ndaj roleve gjinore dhe të drejtave të grave.

Përgjatë luftës në Kosovë, shtypja sistematike dhe diskriminimi në bazë të etnisë ndikoi edhe më shumë në dominimin patriarkal dhe dhunën ndaj grave. Kur lufta eskaloi në fund të viteve të 1990-ta, përkeqësoi më tej tensionet ekzistuese dhe çoi në shkelje të të drejtave të njeriut, duke përfshirë dhunën seksuale ndaj grave si një mjet lufte.

Kur lufta kishte mbaruar dhe pas periudhës së tranzicionit ndërkombëtar, Kosova shpalli pavarësinë e saj në vitin 2008. Megjithatë, trazirat në vend nuk mbaruan me shpallje të pavarësisë. Paqëndrueshmëria politike, sfidat ekonomike dhe historia e saj me konflikte, kishte ndikuar shumë që këta faktorë të kontribuojnë në mosndëshkimin e kryerësve të veprave.

Gjatë kësaj kohe në Kosovë, ndërgjegjësimi i shoqërisë mbi diskriminimin me të cilin përballeshin gratë mbeti i kufizuar, duke përkeqësuar kështu përhapjen e dhunës me bazë gjinore. Për shkak të mosfunksionimit të menjëhershëm të një sistemi të konsoliduar, shumë raste të grave të vrara pas luftës nuk janë të regjistruara dhe asnjëherë nuk pati drejtësi për to. Mungesa e ndërgjegjësimit dhe përgjegjësisë përjetësoi kulturën e heshtjes rreth dhunës me bazë gjinore, duke penguar përpjekjet për të identifikuar dhe adresuar rastet e femicidit. Gratë shpesh përballeshin me pengesa për raportimin e dhunës për shkak të frikës nga stigma, mungesës së qasjes në shërbimet mbështetëse dhe mosbesimit në sistemin e drejtësisë. Rrjedhimisht, rastet e femicidit u raportuan më pak dhe u adresuan në mënyrë joadekuate, duke rrezikuar më tej jetën e grave. Dështimi për të njohur dhe sfiduar diskriminimin sistematik kundër grave jo vetëm që ka dëmtuar të drejtat e tyre themelore, por gjithashtu ka përjetësuar normalizimin e dhunës brenda shoqërisë në Kosovë.

Revolucioni legjislativ

Rastet e femicidit në Kosovë kanë ndodhi e prapavija të ndryshme. Ato që veçse njihen nga të gjithë përfshijnë zakonisht vrasje për nder, vrasje nga dhuna në familje dhe vrasje si pasojë e trafikimit. Vrasjet e nderit, në veçanti, kanë qenë çështje e kahershme, e nxitur nga tradita patriarkale dhe "monitorimi" e perceptimi i sjelljes së grave si pasqyrim i nderit të familjes. Pavarësisht reformave ligjore dhe përpjekjeve për të adresuar dhunën me bazë gjinore, duke përfshirë miratimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje në vitin 2010, i cili parashikon masa për parandalimin, mbrojtjen dhe shërbimet mbështetëse për të mbijetuarat, Kodin Penal (2019) i cili dënon forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë përdhunimin, sulmin seksual dhe dhunën në familje - rastet e dhunës me bazë gjinore veçse rriten.

Përveç kësaj, Kosova ka ratifikuar edhe konventat ndërkombëtare, siç është Konventa e Stambollit, duke përforcuar përkushtimin e saj për të luftuar dhunën me bazë gjinore dhe Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave.

Por, përkundër këtyre masave legjislative, ekzistojnë boshllëqe dhe kufizime të konsiderueshme në sistemin aktual ligjor që pengojnë ndjekjen penale efektive të rasteve të femicidit në Kosovë. Një çështje kryesore është mungesa e legjislacionit specifik që kriminalizon në mënyrë eksplicite femicidin. Përderisa Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje trajton forma të ndryshme të dhunës ndaj grave, duke përfshirë vrasjen, ai nuk e përkufizon apo kriminalizon në mënyrë specifike femicidin si një vepër të veçantë. Kjo e bën të vështirë për organet e drejtësisë të hetojnë, ndjekin penalisht dhe ndëshkojnë si duhet kryerësit e femicidit.

Rëndësia e njohjes së përvojave të grave dhe përballja me realitetin ashtu siç është - që gratë vriten e dhunohen veç pse janë gra – do sillte një revolucion dhe drejtësi për të gjitha gratë.

Këtë ide e shpreh edhe Besarta Breznica nga Rrjeti i Grave të Kosovës, e cila sqaron se si kriminalizimi i femicidit do kishte ndikim fillimisht në njohjen e tij si koncept: "Përfshirja e femicidit në Kodin Penal padyshim që do të sillte dënime më të ashpra dhe do të vetëdijesonte kryerësit e veprës penale të femicidit. Përveç kësaj, ne jemi dëshmitarë të asaj që shumë njerëz në Kosovë nuk e njohin femicidin dhe e përjashtojnë si të tillë, kurse çdo vit kemi vajza e gra të vrara nga burrat e familjes së tyre. Kriminalizimi i tij çon edhe në njohje të femicidit në shoqëri dhe kjo ndikon në ndryshimin e normave shoqërore që lejojnë dhe normalizojnë dhunën ndaj grave".

Rëndësia e njohjes së femicidit si fenomen dhe dënueshmëria e tij nga një ligj i veçantë nuk është vetëm te fakti i vetëdijesimit, por sigurisht – më e rëndësishmja – në rritjen e sigurisë së grave dhe uljen e numrit të dhunës e vrasjes me bazë gjinore.

"Kriminalizimi i femicidit duhet ta obligojë Qeverinë që ajo të krijojë mekanizma për punësimin e viktimave të dhunës në familje dhe ndarjen e banimit social, në mënyrë që viktimat të mos kthehen në ambiente abuzive ku edhe mund të ndodhë vrasja", shton Breznica.

Ministria e Drejtësisë thotë se është duke u punuar në çrrënjosjen e dhunës me bazë gjinore. "Me synimin e përafrimit dhe zbatimit të obligimeve të dala nga Konventa e Stambollit, së shpejti do të procedohen ndryshimet e reja që ndërlidhen me kriminalizimin e femicidit në Kosovë. Derisa ka shumë nene të dobishme e përparimtare në legjislacionin tonë që duhet të implementohen strikt, duhet të punojmë edhe në përmirësimin e pasurimin e mëtejmë të ligjeve tona".

Për më tepër, ka sfida sistematike brenda sistemit ligjor që kontribuojnë në raportimin e pamjaftueshëm dhe trajtimin joadekuat të rasteve të femicidit. Këto përfshijnë burime dhe kapacitete të kufizuara brenda institucioneve përkatëse. Viktimat janë përballur me barriera të shumta në drejtësi, si frika nga hakmarrja, stigma sociale dhe mungesa e shërbimeve mbështetëse. Këtë e konfirmon përvoja e shumë grave që u përballën me padrejtësi, e veçanërisht gratë që nuk janë më në mesin tonë.

Për problematikat sistematike që ekzistojnë në Kosovë, Ministria e Drejtësisë thekson se krahas fuqizimit të legjislacionit kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, për shkak të neglizhencës institucionale, shumë gra humbën jetët e tyre.

"Në këto rrethana duhet të ketë masa për secilin person zyrtar që nuk i kryen përgjegjësitë që ka, sikurse edhe vullnet të hekurt për zbatim të detyrave dhe përgjegjësive. Secili institucion e ka për detyrë zbatimin e legjislacionit dhe adresimin e secilit rast të zbatimit të gabuar apo neglizhencës. Vetëm kësisoj mund ta rrisim vetëdijen dhe seriozitetin në trajtimin e këtyre rasteve".

Vrasjet e grave që ndodhën në Kosovë ishin vrasje të paralajmëruara. Shumica prej vrasësve ishin recidivistë të veprave të mëhershme, kryesisht për dhunë në familje.

Në vitin 2011 u vra Diana Kastrati, e cila paraprakisht kishte shkuar në Gjykatën Komunale të Prishtinës për të kërkuar urdhër-mbrojtje nga personi me të cilin po bashkëjetonte. Kjo pasi Kastrati ishte bërë subjekt i dhunës në familje nga Adnan Jashari, personi me të cilin i kishte kaluar dhjetë vitet e fundit. Megjithatë, urdhër-mbrojtja nuk ishte marrë parasysh nga institucionet e drejtësisë. Pasojat ishin fatale. Diana Kastrati u vra më 18 maj të vitit 2011, në një rrugë në afërsi të shtëpisë së saj në Prishtinë.

Edhe Zejnepe Berisha kishte raportuar me dhjetëra herë në polici dhunën që po e përjetonte nga burri i saj, por ai ishte lënë në liri. Si pasojë e këtij neglizhimi, ajo u vra nga burri i saj, Nebih Berisha, i cili e goditi me thikë mbi 20 herë, në prezencë të fëmijëve të mitur.

Në muajin gusht të vitit 2018, Valbona Ndrecaj dhe vajza e saj u qëlluan për vdekje me kallashnikov nga bashkëshorti, përkatësisht babai, Pjetër Ndrecaj.

Në fshatin Berivojcë të Kamenicës, mesditën e 25 korrikut 2020, Nuhi Mavrovqani e kishte goditur gruan e tij, Sabilen, me shufër metalike deri në vdekje. Nuhi Mavrovqani kishte qenë i dënuar edhe më herët për dhunë në familje dhe vepra të tjera penale.

Në marsin e vitit 2021, Lulëzim Sopi e kishte vrarë me armë zjarri gruan e tij, Sebahaten, e më pas e kishte goditur edhe veten. Ishin burrë e grua që kishin pasur në vazhdimësi probleme, për të cilat Sebahatja kishte raportuar në institucionet e drejtësisë.

Në janarin e vitit 2022, Lirie Qerimaj ishte gjetur e vrarë në shtëpinë e saj në Llaushë të Skënderajt. Ajo ishte goditur me armë zjarri për vdekje nga bashkëshorti i saj, Skënder Qerimaj. Viktima kishte kërkuar mbrojtje nga shteti, por asaj nuk i ishte dhënë siguri. Pesë ditë para vrasjes, Lirije Qerimaj e kishte raportuar rastin në polici.

Marigona Osmani ishte dhunuar e rrahur fizikisht deri në vdekje nga partneri i saj Dardan Krivaqa. Ai ishte person me të kaluar kriminale, të cilin organet e drejtësisë e kishin kursyer nga trajtimi i shumë lëndëve kriminale me të cilat ishte i ngarkuar, ndër to edhe me një tentim vrasje.

Këto nuk ishin raste të izoluara, por të raportuara në secilën instancë të drejtësisë. Situata aktuale në Kosovë pasqyron një realitet shqetësues, me raste që shpërfaqin një problem të vazhdueshëm të dhunës ndaj grave. Përderisa të dhënat gjithëpërfshirëse në mënyrë specifike për femicidin në Kosovë janë të kufizuara, raportet nga organizatat për të drejtat e grave dhe organizatat ndërkombëtare theksojnë prevalencën e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë rastet e femicideve.

Vlora Nushi, Drejtore Ekzekutive e UN Women – zyra në Prishtinë, thekson se me kriminalizimin e femicidit dërgohet një mesazh i qartë në shoqëri. "Dhuna me bazë gjinore është e papranueshme dhe do të ndëshkohet fuqimisht. Kjo mund të ndikojë në ndryshimin e qëndrimeve dhe të besimeve shoqërore që mund ta kenë normalizuar dhe toleruar femicidin. Kriminalizimi i femicidit e bën këtë temë të jetë në qendër të diskutimeve publike dhe politike".

Është shumë e rëndësishme të theksohet edhe roli i qendrave rehabilituese të Kosovës (burgjeve). Kodi Penal i Kosovës thotë se qëllimi i dënimeve është "të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij". Po ashtu, kërkesat që dalin nga Konventa e Stambollit parashohin forma të qarta se si duhet të veprohet me kryerësit e veprave të tilla.

Rehabilitimi i shkelësve të ligjit dhe ri-integrimi i tyre i suksesshëm në shoqëri duhet të jetë ndër objektivat bazë të sistemeve të drejtësisë penale. Konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe standardet dhe normat e Kombeve të Bashkuara në parandalimin e krimit në drejtësinë penale, e pranojnë qartë këtë pikë. Ato e theksojnë rëndësinë e ndërhyrjeve për të mbështetur ri-integrimin social të shkelësve, si një mjet për parandalimin e krimit të mëtejshëm dhe mbrojtjen e shoqërisë, e veçanërisht mbrojtjes së grave dhe të gjitha grupeve tjera të cenueshme.

Mirëpo, siç shihet nga statistikat dhe realiteti në Kosovë, ky ka mbetur veç një ideal. Konsideroj se me kriminalizimin e femicidit, përpos që duhet të merret më seriozisht dënimi ose rehabilitimi i kryerësve, njëkohësisht duhet krijuar një grup i pavarur i përbërë nga individë të ndryshëm: juristë, avokatë, aktivistë dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, për t'i monitoruar vazhdimisht rastet e dhunës me bazë gjinore përgjatë proceseve gjyqësore. Nëse korniza legjislative është utopike, atëherë është e qartë se ku qëndron problemi me rritjen e rasteve. Kryerësit e veprave trajtohen si të ishin viktima dhe sistemi i mbështet në rrugëtimin e tyre të dhunës.

Me kriminalizim të femicidit të paktën dy gjëra do qartësohen: përgjatë proceseve gjyqësore do jetë më se e kuptueshme pse dënohet në formë të veçantë dhuna me bazë gjinore, e cila mund të përfundojë me vrasje. Së dyti, do të përçohet mesazhi më i rëndësishëm se e drejta e grave për jetë nuk guxon të cenohet. Nga askush.

Autorja është aktiviste feministe.

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Ta thyesh tavanin prej xhamit

Brikena Berisha

Teoria e kapitalit njerëzor shpjegon se burrat dhe gratë e zgjedhin nivelin e tyre të arsimimit për ta maksimizuar vlerën aktuale të fitimeve dhe të dobisë së tyre gjatë gjithë jetës. Teoria nënkupton se pas një diplome të përfunduar, gratë në të njëjtën shkallë si burrat kërkojnë të marrin pjesë në aktivitetet e tregut të punës. Shumë hulumtime akademike dhe shkencore konkludojnë se arsimimi, ndër të tjera, ndikon në rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës (Borjas, 2013).

Por, teoria e kapitalit njerëzor nuk reflektohet në tregun kosovar të punës. Derisa sistemi arsimor në Kosovë kohëve të fundit është një mjedis i barabartë gjinor në të gjitha nivelet, tregu i punës nuk tregon të njëjtat karakteristika. Megjithëse gratë investojnë në arsim më shumë se burrat, një pjesë e konsiderueshme e grave me diploma të marra nga institucionet e arsimit të lartë nuk janë pjesë e tregut të punës. Nuk ka të dhëna të sakta nëse këto gra po pengohen të integrohen në tregun formal të punës, apo edhe nëse zgjedhin të mos punojnë.

Të dhënat empirike nga Agjencia e Statistikave të Kosovës lënë të nënkuptojnë se në arsimin e lartë pjesëmarrja është më e lartë te vajzat dhe gratë. Kështu, nga gjithsej 17.052 studentë të nivelit bachelor në vitin 2023, 9.983 janë vajza dhe 7.113 janë djem (ASK, 2023). Çuditërisht, situata nuk është ndryshe as për nivelin master, e veçmas për të diplomuarit, pasi në periudhën 2018-2020 në Kosovë kanë diplomuar në nivelin master 2.841 vajza, kundrejt 2.105 djemve, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

Duhet theksuar se fundi i vitit 2023 e gjen Kosovën me gjithsej 375.967 persona të punësuar, prej të cilëve 227.856 janë burra dhe vetëm 143.287 janë gra (ASK, 2024). Me një papunësi prej 11.5%, Kosova ka joaktivitet të punës në nivel 60.5%, ndërsa tek gratë është 77.2%, krahasuar me 43.2% tek burrat. Papunësia është veçanërisht e shprehur tek mosha 25-44 vjeç, që është edhe mosha e zhvillimit dhe ngritjes profesionale. Për më tepër, duhet theksuar se sektori me punësimin më të madh të grave mbetet administrata publike (25.9% gra dhe 19.9% burra), e përcjellë nga tregtia.

Sa i përket aspektit të kërkimit të një vendi pune, të dhënat nga Agjencia e Punësimit në Kosovë reflektojnë po të njëjtin trend. Viteve të fundit është rritur përqindja e punëkërkueseve gra që janë regjistruar pranë kësaj agjencie. Por, ky regjistër ende dominohet nga burrat. Megjithëse viti 2021 është viti zyrtar më pozitiv për shtimin e grave punëkërkuese, janë mbi 2.400 burra të regjistruar si punëkërkues më shumë sesa gratë, nga gjithsej 39.169 gra dhe 41.606 burra. Shqetësuese mes tyre mbetet përgatitja arsimore e punëkërkuesve. 4.987 gra punëkërkuese janë me diplomë bachelor, kundrejt 2.109 burrave, dhe 438 gra janë me nivel master kundrejt 274 burrave (APRK, 2023). Me proporcion më shumë se dyfish, do të thotë se për çdo burrë me diplomë bachelor dhe master që po kërkon punë, janë nga dy gra me të njëjtin nivel si punëkërkuese.

Bazuar në të gjitha të dhënat zyrtare nga institucionet përgjegjëse, vajzat në Kosovë shkollohen më shumë se djemtë, mirëpo janë të punësuara shumë më pak se ata. Me po të njëjtin nivel arsimor, gratë dominojnë në Agjencinë e Punësimit të Kosovës si punëkërkuese. Nuk ka ende një analizë të detajuar formale se cilat mund të jetë sfidat që po e vështirësojnë, apo po e pamundësojnë këtë punësim të grave të shkolluara. Duhet theksuar se ngecja në punësim e grave me përgatitje arsimore pa dyshim është duke u reflektuar edhe në pjesëmarrje të ulët të grave në jetën publike, pozita të larta menaxheriale dhe poste politike drejtuese. Edhe pse gratë dominojnë si të punësuara në administratën publike të vendit, Kosova sot ka vetëm 5 sekretare gra dhe 5 ministre në gjithsej 15 Ministri. Nga gjithsej 120 deputetë, vetëm 40 janë gra dhe nga 38 komuna vetëm 2 gra janë kryetare, duke theksuar se ato janë nga komuniteti serb. Për më tepër, Kosova ka shumë pak gra si drejtore shkollash e spitalesh, dekane, rektore e pozita të tjera udhëheqëse.

Vendet investojnë në arsim që të nxisin kthimin po në arsim. Kosova ka investuar viteve të fundit në arsim, nëse jo direkt në rritje të kualitetit, të paktën në gjithëpërfshirje. Me hapjen e universiteteve publike në disa qendra të vendit, niveli i pagesës për studime është ulur në një shumë modeste. Kjo ka ndikuar që studentët të zgjedhin qendrën e studimit në afërsi të banimit dhe të paguajnë më lirë, duke ulur barrierën e kushteve ekonomike në ndjekjen e studimeve. Në përgjithësi, niveli arsimor i grave në vend është rritur viteve të fundit, duke tejkaluar në pjesëmarrje edhe burrat. Por, rezultatet empirike janë të paqarta dhe sugjerojnë se norma e kthimit në arsim për gratë nuk është e lidhur drejtpërdrejt me arsimin.



Disa hulumtime sugjerojnë se struktura kulturore mund të ketë fuqi të madhe shpjeguese në lidhje me pjesëmarrjen e grave në tregun e punës në vende në zhvillim, si Kosova. Hulumtime të ndryshme të IKS-së konfirmojnë se gratë rëndohen me barrën e punëve të shtëpisë dhe përkujdesjes për familjarët, qofshin fëmijë, të moshuar të familjes, apo familjarë me nevoja të veçanta. Kjo nuk i kursen as gratë e arsimuara. Në këtë aspekt, ndikim të madh ka kualiteti dhe qasja në qendrat për të moshuar dhe qendrat ditore për fëmijë. Duhet theksuar se Kosova në vitin 2022 kishte gjithsej 44 kopshte publike të fëmijëve në tërë vendin, me shumicën e qyteteve me vetëm nga një qendër ditore. Qytete si Deçani, Dragashi, Novobërda e Klokoti, nuk kanë kopshte fare, ndërsa Prizreni edhe pse qendër mjaft e madhe, ka përuruar kopshtin e parë publik tek në vitin 2021. Mungesa e kopshteve publike i lë adresë alternative kopshtet e sektorit privat, të cilat në shumë raste kanë kosto të papërballueshme.

Aspekt tjetër i rëndësishëm në punësimin e grave është edhe shuarja e hendekut gjinor në pozita dhe paga. Derisa në shumë vende mbetet problematike ngecja në profesion për gratë kur ato duhet të marrin periudha të lira për lindjen e fëmijëve, në Kosovë gratë përballen edhe me problemin e degradimit personal në periudhën e lehonisë. Ato ende mbeten nën mëshirën e punëdhënësit të sektorit privat, që në shumë raste nuk punëson fare gra që potencialisht do të krijojnë familje, apo edhe ua ndërpret kontratën e punës. Sipas të dhënave nga raporti i Monitorimit të zbatimit të Ligjit të Punës në Kosovë, nga 400 gra të intervistuara në sektorin privat, 11% deklarojnë se nuk kanë marrë fare pushim të lehonisë (IKS, 2024).

Tregu i punës në sektorin publik ka përcaktim më të fortë hierarkik të pozitës bazuar në nivelin arsimor. Jo domosdoshmërisht e njëjta hierarki përcillet edhe në sektorin privat, pasi që pozicionet më të larta nuk janë të lidhura direkt me arsimimin dhe përgatitjen profesionale. Prandaj shumë gra në Kosovë hezitojnë të punësohen në sektorin privat. Në hulumtimin e IKS-së: "Të jesh grua në tregun e punës", 30% nga 500 gra të punësuara kanë raportuar sjellje ndryshe nga punëdhënësi, si dhe ngacmim seksual. Kjo konfirmon se gratë në Kosovë nuk aplikojnë për pozita në kompani dhe organizata që nuk i njohin, duke bërë që ngacmimet e pritshme seksuale të jenë një nga pengesat/sfidat kryesore për punësimin e grave dhe sfidat në vendin e punës.

Në shumë vende të Evropës pjesëmarrja në punësim ka dallim të lehtë në mes grave dhe burrave. Lituania është vendi i vetëm në të cilin pjesëmarrja e gruas në tregun e punës e tejkalon lehtësisht atë të burrave. Por, dallime shumë të vogla, në më pak se 5%, kanë vendet si Finlanda, Letonia, Danimarka, Irlanda, Islanda e Norvegjia. Papunësia nuk kalon më shumë se 10% në asnjë vend, përveç Spanjës dhe Greqisë, papunësi e cila është e shpërndarë në mënyrë të balancuar mes burrave dhe grave.

Sistemi arsimor në Kosovë ka pësuar disa reforma viteve të fundit. Shkollimi fillor dhe i mesëm është i detyrueshëm dhe përfundon pas 12 vitesh, pas të cilit studentët zgjedhin të punojnë ose t'i vazhdojnë studimet në një institucion të arsimit të lartë. Por, punësimi i grave në Kosovë është ndër më të ulëtit në botë dhe është më i ulët se vendet tjera të Ballkanit Perëndimor (Banka Botërore, 2020). Në përgjithësi mungon një analizë e lidhjes mes arsimimit dhe tregut të punës. Kjo veçmas duhet të fokusohet në këtë ndërlidhshmëri për gratë, pasi që të dhënat kuantitative ngrehin shqetësim se arsimimi nuk del të jetë çelësi i garancisë për një vend pune për gratë në vend.

Një kuptim më i thellë se si institucionet e arsimit të lartë ndikojnë në pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, i kombinuar me vlerësimin e preferencave të politikave, mundëson zbatimin më të suksesshëm të politikave dhe rrjedhimisht një treg më efikas të punës. Modelet më të reja të integrimit të një tregu të punës gjithëpërfshirës dhe integrimit të grave në tregun e punës përfshijnë arsimin, normat e pagave, rëndësinë mbi riprodhimin dhe teknologjinë dhe aftësinë e kufizuar.

Aspekti legjislativ dhe mbështetja e shtetit për gratë do ta forconte rëndësinë e arsimit në vend. Sipas studiuesit Pekkarinen, gratë me çfarëdo niveli të shkollimit janë të punësuara më pak se burrat me po të njëjtat nivele të shkollimit (Pekaarinen, 2012). Por, mbetet përgjegjësi mbi Kosovën që asnjë grua me përgatitje bachelor apo master mos të mbesë jashtë tregut të punës pa dëshirën e saj.

Autorja është Hulumtuese/Menaxhere e Programit në Iniciativën Kosovare për Stabilitet (IKS).

Betejat e heshtura të grave lesbike dhe biseksuale në Kosovë

Në Kosovë, gratë lesbike dhe biseksuale shpesh përballen me një diskriminim kompleks thellë të rrënjosur në aspektin gjinor, orientim seksual dhe faktorë socio-ekonomikë. Normat mbizotëruese shoqërore, strukturat patriarkale dhe qëndrimet kulturore në Kosovë paraqesin shqetësime madhore për individët që nuk përputhen me konstruktin e përkufizuar shoqëror të rolit gjinor tradicional dhe normave seksuale. Si pasojë, gratë lesbike dhe biseksuale hasin pengesa të konsiderueshme në qasjen në të drejtat themelore, siç janë kujdesi shëndetësor, arsimi, punësimi dhe mbrojtja ligjore.

Diskriminimet dhe margjinalizimet që i përjetojnë gratë lesbike dhe biseksuale në Kosovë manifestohen në aspekte të ndryshme të jetës së tyre, duke përfshirë familjen, shoqërinë, kolegët e punës, etj. Normat patriarkale dhe ato fetare bëjnë që nga gratë të ketë pritje për sjelljet e tyre sipas "normave" të rrepta gjinore dhe seksuale, duke çuar në stigmatizimin e atyre grave veprimet e të cilave nuk janë konform këtyre normave. Prandaj, duke mos iu përshtatur "normave gjinore", këto gra shpesh përballen me izolim apo largim nga familjet e tyre, largim nga vendi i punës, izolim nga shoqëria, që në fund mund të rezultojë me dhunë fizike, verbale dhe psikike, me pasoja të rënda ndaj shëndetit mendor.

Refuzimi dhe mospranimi nga familja është një dukuri shumë e zakonshme për gratë lesbike dhe biseksuale në Kosovë. Kjo pastaj mund të ndikojë në abuzim fizik dhe emocional, si dhe në martesë të detyruar me një partner burrë. Përveç kësaj, diskriminimi në vendin e punës, i bazuar në orientimin seksual, krijon pengesa të mëdha në mundësi të punësimit dhe ngritjes në karrierë, duke shkaktuar paqëndrueshmëri ekonomike dhe duke forcuar margjinalizimin në shoqëri.

Edhe pse Kushtetuta e Kosovës dhe legjislacioni në fuqi ofrojnë mbrojtje të avancuar për gratë lesbike dhe biseksuale, zbatimi i ligjeve ende është i vakët dhe aspak adekuat. Kësisoj mundësohet që këto gra të mbeten pa mbrojtje të duhur ligjore kundër akteve të dhunës, ose diskriminimit. Mungesa e mbrojtjes i minon iniciativat e këtyre grave për të kërkuar drejtësi për padrejtësitë me të cilat ato ballafaqohen, duke e përjetësuar margjinalizimin e tyre në shoqëri. Sfidat e zakonshme që i përjetojnë këto gra për qasje në drejtësi janë shkaku i paragjykimeve sistemike, mospasjes së vetëdijes specifike të ekspertëve ligjorë dhe frikës së ndëshkimit, pikërisht për arsye të neglizhencës dhe pandjeshmërisë së profesionistëve ligjorë. Ka pasur raste në Kosovë kur raportimi i diskriminimit, ose dhunës së bazuar në orientimin seksual, i ka margjinalizuar edhe më shumë këto gra, duke dekurajuar shumë gra të tjera nga kërkimi i drejtësisë dhe duke e rrënjosur një kulturë të pandëshkueshmërisë për dhunuesit.

Përtej mbrojtjes së pamjaftueshme ligjore nga institucionet e rendit dhe ligjit, gratë lesbike dhe biseksuale në Kosovë nuk kanë shërbime kualitative mbështetëse për mirëqenien e tyre. Shërbimet kritike, siç janë: kujdesi shëndetësor, strehimi, këshillimet dhe grupet përkrahëse, janë të pakta dhe kryesisht ofrohen nga organizatat joqeveritare që punojnë për të drejtat e njeriut, të përqendruara kryesisht në Prishtinë. Prandaj, shumica e grave që nuk jetojnë apo nuk veprojnë në Prishtinë, mbesin pa sisteme mbështetëse elementare që do t'iu ndihmonin për t'i kapërcyer sfidat e tyre, që nuk janë aspak të lehta. Gjendja në shërbimet mbështetëse vetëm sa e thellon edhe më shumë izolimin dhe margjinalizimin e tyre, duke ua bërë edhe më të vështirë që t'i mbrojnë e luftojnë për të drejtat e tyre dhe të kërkojnë përkrahje kur të jetë e nevojshme.

Nga fokus grupet e organizuara me gratë lesbike dhe biseksuale në Kosovë vërehet qartë që këto gra shpesh kanë pengesa për të marrë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese. Shumica e ofruesve të shërbimeve shëndetësore nuk kanë trajnim të nevojshëm për t'i adresuar nevojat specifike shëndetësore të këtyre grave, duke krijuar pabarazi në kujdes. Rrjedhimisht, në shumicën e rasteve këto gra nuk do të vazhdojnë t'i kërkojnë shërbimet e nevojshme mjekësore, duke rrezikuar shëndetin e tyre fizik dhe mendor. Mungesa e shërbimeve të specializuara të kujdesit shëndetësor për gratë lesbike dhe biseksuale shumëherë ka çuar në diagnoza të vonuara, trajtim joadekuat, rreziqe të rritura shëndetësore, nivele të larta të depresionit, ankthit e traumës, duke i margjinalizuar më tej ato brenda sistemit të kujdesit shëndetësor.

Një problem tjetër që ndikon shumë në kualitetin e jetës së grave lesbike dhe biseksuale që përjetojnë diskriminim apo dhunë, është se në shumicën e rasteve nuk kanë qasje në strehimore dhe hapësira të sigurta ku mund të gjejnë mbështetje. Në Kosovë, mundësia për t'i strehuar gratë lesbike e biseksuale në strehimore të përshtatshme është e kufizuar, për të mos thënë është inekzistente. Strehimoret aktuale të dedikuara për gratë nuk i kanë parasysh specifikat për këto gra, që mund të çojë në trajtim jo të duhur nga stafi i strehimoreve, ose edhe nga vetë gratë e strehuara aty.

Në përgjithësi, mungesa e shërbimeve mbështetëse për gratë lesbike dhe biseksuale në Kosovë paraqesin pengesa të mëdha për mirëqenien, sigurinë dhe të drejtat e tyre. Adresimi i problemeve kërkon një qasje gjithëpërfshirëse në ofrimin e shërbimeve mbështetëse. Duke investuar në kujdesin shëndetësor, shëndetin mendor, mbështetjen sociale, ndihmën juridike dhe shërbimet e strehimit, shoqëria kosovare mund të avancojë për të krijuar një mjedis më gjithëpërfshirës dhe mbështetës, ku këto gra do të kenë jetë kualitative, të gëzojnë të drejtat e tyre dhe të jetojnë të lira nga diskriminimi dhe dhuna.

CSGD

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Punësimi i denjë i grave si parakusht për barazi gjinore

Riola Morina

Angazhimi formal dhe i paguar i grave në tregun e punës nuk ka qenë gjithmonë siç e njohim sot. Dekadave të fundit ka shënuar rritje. Por, çka do të thotë kjo përpos rritjes së forcës punëtore? Do të thotë që rregullat e paravendosura historikisht, ku gratë izolohen në sferën private e burrat e marrin atë publike, do të ndryshojnë, duke e ndryshuar kështu rendin ekonomik dhe shoqëror.

Punësimi formal, edhe pse jo gjithmonë, për gratë merr formën e një burimi jo vetëm financiar, por pavarësimi dhe emancipimi. Për gratë, puna formale shërben edhe si një mjet për t'u ndarë nga tradita patriarkale, kështu duke iu ofruar hapësirën për t'i ndjekur interesat e tyre jashtë sferës familjare. Është tejet e rëndësishme të theksohet se përfshirja e grave në tregun e punës jodomosdoshmërisht shpie në efekte të dëshiruara sa i përket barazisë gjinore. Shpesh, vetë vendet e punës janë hapësirë ku barazia gjinore nuk mbahet si vlerë.

Përkundër përparimit të madh që është bërë në këtë fushë, në mbarë botën ende ekziston një balancë e dobët sa i përket përfaqësimit gjinor në tregun e punës, sidomos kur bëhet fjalë për pozita më të larta e udhëheqëse.

Sipas të dhënave të Anketës së Fuqisë Punëtore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2022, shkalla e punësimit të grave në Kosovë ishte vetëm 18 për qind, ndërsa për burrat ishte 49 për qind. Këto të dhëna tregojnë qartazi se dallimi gjinor në forcën punëtore vazhdon të jetë ende tejet i madh dhe shqetësues. Në vitet e mëparshme, konkretisht në 2021 dhe 2020, përqindjet e punësimit të grave ishin edhe më të ulëta, me vetëm 16 për qind dhe 14 për qind respektivisht. E sa i përket nivelit qendror, një raport statistikor nga Instituti GAP zbulon se në vitin 2019 vetëm 10 për qind e posteve drejtuese menaxhoheshin nga gratë. Ndërsa edhe në pozitat drejtuese në administratat komunale përfaqësimi i grave ishte mjaft i ulët, vetëm 20 për qind.

Ndër shkaqet kryesore të këtij mosbalancimi përfshihet diskriminimi gjinor në vendin e punës, si për shembull: pyetjet mbi planifikimin familjar, mungesa e kontratave apo mbizotërimi i atyre afatshkurtra, hendeku gjinor në paga dhe puna e papaguar që drejtpërdrejt ndërlidhen me stereotipat e krijuar e të mirëmbajtur nga sistemet patriarkale.

Në Kapitullin III të Ligjit për Barazinë Gjinore, në Nenin 15, diskriminimi gjinor në marrëdhëniet e punës është i ndaluar në mënyrë të qartë dhe të plotë. Pikat specifike të këtij neni përmbajnë ndalimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, apo të tërthortë, në marrëdhëniet e punës në bazë të disa faktorëve, si gjinia, statusi martesor ose familjar, shtatzënia, lindja, prindërimi dhe çdo formë e kujdesit në sektorin publik ose privat.

Pyetjet rreth planifikimit familjar që iu bëhen grave në intervistat e punës drejtpërdrejt cenojnë respektimin e të drejtave të punëtoreve dhe barazinë gjinore në tregun e punës. Këto pyetje, shpesh të motivuara nga nevoja e punëdhënësve për t'i planifikuar burimet njerëzore dhe për t'i minimizuar mungesat e mundshme për arsye familjare, cilësohen drejtësisht si një lloj tjetër i diskriminimit gjinor.

Në shumicën e rasteve, pyetjet rreth planifikimit familjar janë reflektim i stereotipave gjinorë dhe paragjykimeve, që presupozojnë se gratë do të kenë detyra familjare që do të ndikojnë në angazhimin e tyre në punë, duke krijuar kështu një perceptim të padrejtë se gratë nuk janë të afta ose të përgatitura për t'i përmbushur obligimet profesionale në mënyrë të njëjtë me burrat.

Për ta zgjidhur këtë problem në thelb duhet që të rishikohen politikat që kanë të bëjnë me pushimin prindëror. Rezarta Delibashzade Krasniqi, Drejtore Ekzekutive në Democracy for Development (D4D), tregon se "nga anketat të realizuar nga D4D është identifikuar se si nënat, ashtu edhe baballarët, janë shumë më të hapur për aranzhime më fleksibile të lejes prindërore". Pra, ndryshimi i politikave të llojit të tillë do ishte hap i nevojshëm, por edhe i preferuar për prindërit.

Ernera Dushica, ekonomiste feministe, mendon që "pyetjet në lidhje me planifikimin familjar, siç janë pyetjet për shtatzëninë, planifikimin e fëmijëve, apo statusin martesor, janë shkelje e të drejtave të njeriut dhe privatësisë së aplikantëve".

Kontratat afatshkurtra janë marrëveshje pune midis punëdhënëseve/eve dhe punëmarrëseve/eve për periudha relativisht të shkurtra kohore. Për punëmarrësit/et, kontratat afatshkurtra shpesh paraqesin një mungesë të sigurisë, duke mos u dhënë atyre një siguri afatgjatë për punën dhe të ardhurat e tyre. Kjo mungesë e sigurisë së punës veçanërisht i godet gratë, të cilat mund të kenë nevojë për stabilitet dhe siguri në karrierën e tyre, posaçërisht kur i marrim parasysh përgjegjësitë e kujdesit që u atribuohen.

Zakonisht, kontratat afatshkurtra nuk ofrojnë disa avantazhe të punës që janë më shumë prezente për punonjësit e përhershëm, si pushimet e paguara, sigurimet shëndetësore, kontributet pensionale, apo mundësitë për zhvillim dhe avancim karriere.

"Kontratat më afatshkurtra mund të kenë ndikim në mundësitë e grave për të zhvilluar karriera të qëndrueshme dhe të ndërtojnë rrugë profesionale më afatgjata. Në disa raste, mund të ketë ndikim në përvojën e punësimit të grave në krahasim me burrat. Nëse grave iu ofrohen më shpesh kontrata afatshkurtra në vend të atyre të përhershme, ato mund të kenë më pak mundësi për të fituar përvojë të mjaftueshme dhe për t'u kualifikuar për pozita më të larta, ose më të përgjegjshme, në organizatën e tyre", argumenton Dushica.

Nga të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, nga personat me kontratë pune në Kosovë gjatë vitit 2012, vetëm 44 për qind kishin kontrata të përhershme, ndërsa 56 për qind kontrata të përkohshme. Tek gratë, përqindja e tyre me kontratë afatshkurtër ishte mbi 54 për qind. Pra, më shumë se gjysma e grave të punësuara me kontratë u ballafaquan me rrezikun që sjellin kontratat afatshkurtra.

"Politikat publike duhet të hartohen në mënyrë që gratë dhe burrat të kenë hapësirë të njëjtë për punë të dinjitetshme dhe pagë të njëjtë për punën e njëjtë", thotë Delibashzade - Krasniqi. Megjithatë kjo nuk ndodh gjithmonë.

Paga e ndryshme për punë të njëjtë, që bazohet në gjininë e punonjësve, është një fenomen shqetësues dhe mjaft i përhapur në tregun e punës, duke përbërë vetëm një prej llojeve të diskriminimit gjinor. Në shumicën e rasteve, janë gratë ato që paguhen më pak për punë të njëjtë krahasuar me burrat, edhe pse ata i kryejnë të njëjtat detyra dhe kanë të njëjtin nivel të aftësive dhe të përvojës. Ky dallim, ndryshe i quajtur edhe "hendeku gjinor i pagave", përpos formës së rëndomtë të pagës mujore merr edhe forma tjera, siç janë bonuset dhe përfitimet e ndryshme.

Sipas Ernera Dushicës, kjo ndodh sepse shpesh ka segmentim të tregut të punës, ku një pjesë e madhe e punës së grave mund të jetë në fusha me pagesa më të ulëta në krahasim me profesionet e burrave. Këtë ide ajo e mbështet në një analizë të titujve për vendet e lira të punës nga Instituti GAP. "Studimi ka analizuar pagën e publikuar nga punëdhënësi/ja në rastet kur shpalljet kanë përdorur stereotipa gjinorë. Gjetjet tregojnë se paga mesatare për vendet e punës të cilat janë të kodifikuara më stereotipa gjinorë për burra është 391.49 euro, kurse për vendet e punës të cilat janë të kodifikuara me stereotipa gjinorë për gra është 336.26 euro".

Komisioni Europian konsideron se hendeku gjinor i pagave i referohet diferencës midis nivelit mesatar të pagave të punonjësve burra dhe gra. Në bazë të gjetjeve të hulumtimit: "Hendeku Gjinor i Pagave në Kosovë", të kryer nga Agjencia për Barazi Gjinore, paga mesatare neto e grave në Kosovë gjatë vitit 2019 ka qenë 312 euro, ndërsa e burrave 346 euro në muaj, pra një diferencë prej 34 eurosh. Është gjetur se në të gjitha grupet e arsimimit, burrat fitojnë paga më të larta se gratë. Ndryshimi më i madh është vërejtur tek gratë dhe burrat me arsim të lartë pasuniversitar (dallim prej 113 eurosh).

Puna e papaguar përfshin punët e kryera pa marrë pagesë, si punët e shtëpisë e të kujdesit. Kjo lloj pune rëndon në mënyrë disproporcionale mbi gratë, duke shkaktuar sfida për përfshirjen e tyre në punë të paguara. Edhe kur punësohen, gratë përballen me sfidat që shkaktohen nga "ndërrimi i dytë", ku për shkak të obligimeve familjare që u vendosen mund të perceptohen si të papërkushtuara profesionalisht, ose të përfundojnë në rraskapitje.

Marigonë Drevinja, Drejtore Programi në Institutin "Musine Kokalari", për politikat e lejes së mëmësisë konsideron se "përderisa politikat e pushimit të lehonisë ofrojnë mbrojtje ligjore për gratë e punësuara, ato mund t'i thellojnë pabarazitë gjinore kur monitorimi dhe zbatimi dështon, siç ndodh në Kosovë".

Në përputhje me legjislacionin e punës në Kosovë, gratë kanë të drejtë për pushim të lindjes deri në 12 muaj, ndërsa financiarisht kompensohen për 9 prej këtyre muajve. Ndërkaq, burrave u jepen vetëm tri ditë pushim.

Sipas profesoreshës Ardiana Gashi, ligji aktual e vendos barrën kryesore financiare për financimin e pushimit të lindjes (70% e pagës për 6 muaj) tek bizneset. "Si pasojë, punëdhënësit preferojnë punësimin e burrave".

Edhe pse në Kosovë kjo çështje nuk rregullohet në mënyrën më optimale, ekzistojnë shembuj tjerë se si ky legjislacion do të duhej të qëndronte. Një rast konkret është Direktiva e Bilancit Punë-Jetë. Ky mjet legjislativ vendos standarde minimale për kohën e punës, pushimet, si dhe të drejtat e prindërve dhe kujdestarëve nëpër shtetet anëtare. Qëllimi i saj është të sigurojë që punonjësit të kenë një marrëdhënie të qëndrueshme mes jetës personale dhe punës.

"Një model të tillë, Forumi Ekonomik i Grave e përqafon deri në funksionimin apo prurjen e ligjit për sigurime sociale, i cili pastaj do të kujdesej për lejen e lehonisë të mbuluar komplet nga shteti, pushimet mjekësore, lëndimet në vendin e punës, etj.", thotë Saxhide Mustafa, koordinatore e Forumit dhe zëvendësdrejtore në Institutin Riinvest.

Ndër përpjekjet e rëndësishme për eliminimin e pabarazive gjinore në Kosovë është edhe Forumi Ekonomik i Grave. Ky Forum shërben si platformë e organizatave që punojnë së bashku për avokim, hulumtim dhe promovim të fuqizimit ekonomik të grave. Sipas Mustafës, "Forumi është themeluar me nismën e Institutit Riinvest për t'i bërë bashkë organizatat që përfshihen në mënyrë aktive në përmirësimin e pozitës së gruas në Kosovë, fuqizimin ekonomik të saj, pjesëmarrjen e barabartë në tregun e punës dhe zhvillimin e ndërmarrësisë".

Sa i përket kontekstit të Kosovës, Rezarta Delibashzade – Krasniqi tregon se një nga propozimet që shoqëria civile është duke e shtyrë përpara është që pjesa e parë e lejes së lehonisë të bartet tek Qeveria në mënyrë që të hiqet barra nga bizneset. "Ky format mund të ndihmojë në nxitjen e barazisë gjinore në kornizën e roleve të punës, pagës dhe të pjesëmarrjes në vendin e punës". Në anën tjetër, Marigonë Drevinja nënvizon se një opsion shtesë për t'i adresuar këto sfida dhe për të mbështetur më mirë familjet është angazhimi në dialogun social, duke përfshirë palët kryesore të interesuara në tregun e punës. "Ky dialog mund të çojë në zhvillimin e reformave në politikat e pushimeve familjare që marrin parasysh nevojat e punëdhënësve dhe të punonjësve, veçanërisht për bizneset e vogla".

Edhe në rastet kur ligji ndryshohet me qëllim të avancimit të barazisë gjinore, pengesat e fshehura që mund të ndikojnë tek burrave për të mos marrë pushimin e atësisë vazhdojnë të qëndrojnë. Kjo pasi burrat mund të ndiejnë presion shoqëror apo profesional që të mos dalin jashtë përkufizimit të imponuar që i vendos ata në rolin e fitimprurësve.

Një prej strategjive që mund të funksionojë në eliminimin, apo zbutjen, e këtij problemi është që pushimi i atësisë të jetë i patransferueshëm, pra babai të mos ketë mundësi ta transferojë lejen e atësisë te nëna. Delibashzade – Krasniqi nga D4D thotë se kjo strategji do kishte ndikim pozitiv edhe në Kosovë. "Nga studimet dhe diskutimet që D4D ka mbajtur ndër vite, kemi kuptuar që është e rëndësisë vendimtare që baballarët të kenë një pjesë të lejes që nuk është e transferueshme, duke shtuar faktin se në bazë të hulumtimeve, baballarët shprehen se ndihen më rehat ta marrin këtë 'pushim' pas muajit të gjashtë të lindjes së fëmijës".

Ngjashëm mendon edhe Drevinja, që thekson se "pushimi i patransferueshëm me pagesë, i ndarë si për nënat ashtu edhe për baballarët, jo vetëm që promovon një shpërndarje më të barabartë të detyrave të kujdesit për fëmijët, por gjithashtu mundëson leje më të shkurtra në punë për gratë. Duke i përfshirë baballarët më drejtpërdrejt në procesin e kujdesit ndaj fëmijëve, këto politika sfidojnë rolet dhe stereotipat tradicionalë gjinorë, duke hapur rrugën për një mjedis pune më gjithëpërfshirës për gratë".

Një hap tejet i rëndësishëm në sigurimin që këto politika të gjejnë zbatim është vetëdijesimi mbi rëndësinë e tyre. Kjo arrihet me ndihmën e shumë programeve e mjeteve, ndër të cilat është edhe edukimi i gjeneratave të reja. Në Kosovë kjo ka filluar të zbatohet përmes shtimit të lëndës "Ekonomiksi Gjinor", në Fakultetin Ekonomik të Universitetit "Hasan Prishtina".

"Qëllimi i përfshirjes së lëndës Ekonomiksi Gjinor në programin e studimeve është që studentët, të cilët në ta ardhmen do të jenë vendimmarrës e punëdhënës, të kuptojnë për pabarazitë që ekzistojnë midis burrave dhe grave në fusha të tilla si pagat, mundësitë e punësimit dhe avancimit në karrierë", deklaron profesoresha Gashi. "Duke identifikuar dhe trajtuar këto pabarazi, studentët në të ardhmen do të mund të kontribuojnë për një shoqëri më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse".

Megjithatë, këto iniciativa nuk duhet t'i përkasin vetëm shoqërisë civile. Normat sociale, të përforcuara edhe nga legjislacioni i cili s'e lufton pabarazinë gjinore në mënyrë aktive, nuk kontribuojnë në avancimin shoqëror. Përkundrazi, vetëm sa i thellojnë pabarazitë ekzistuese. Fusha e punësimit, edhe pse delikate e shumëdimensionale, është një fushë ku ka potencial tejet të madh që të promovohet barazia gjinore, potencial ky që shpeshherë përkthehet në ndërgjegjësim të gjerë të popullatës rreth kësaj barazie si parakusht për zhvillim mbarëshoqëror.

Autorja është aktiviste.

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Kush i meriton të drejtat e njeriut në Kosovë?

Sarah Maliqi

Ndërsa po mendoja ku ta fokusoja këtë artikull lidhur me pozitën dhe situatën e grupeve të margjinalizuara në Kosovë, m'u kujtua një fjali e Nelson Mandelës: "T'u mohosh njerëzve të drejtat e tyre njerëzore është të sfidosh vetë njerëzimin e tyre".

Fjalia m'u kujtua pasi në Facebook e lexova një status të Duda Baljes, Kryetare e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Paqjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione, më 7 shkurt 2024, si përgjigje kundër një veprimi të aktivisteve/ëve të të drejtave të njeriut dhe të drejtave LGBTIQ+, të cilët/at i denoncuan deklaratat e saja diskriminuese dhe homofobike ndaj personave LGBTIQ+, gjatë dy viteve të fundit, duke ia kërkuar dorëheqjen prej detyrës së kryetares së komisionit parlamentar. Reagimi i saj më shqetësoi, sidomos pjesa ku thotë se "ajo ka ende shumë punë për të bërë rrugës për të luftuar për të drejtat e njeriut për njerëzit e mirë, atyre që e meritojnë".

Normat, qëndrimet dhe vlerat mbizotëruese shoqërore, kulturore dhe fetare, ndikojnë në punën e mbrojtësve/eve të të drejtave të njeriut në Kosovë, veçanërisht atyre që janë të zëshëm/me dhe të angazhuar/a në fushat e barazisë gjinore, të drejtave LGBTIQ+ dhe të drejtave të pakicave.

Fatkeqësisht për shoqërinë tonë, Duda Balje, si Kryetare e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, nuk është e vetme në pyetjen se cilët njerëz "meritojnë" t'i gëzojnë të drejtat e njeriut. Viteve të fundit, jemi përfshirë nga një sërë fjalimesh dhe komentesh diskriminuese, raciste, homofobike dhe transfobike prej deputetëve të Kuvendit, zyrtarëve dhe anëtarëve të partive politike që fshihen pas imunitetit, anëtarësisë, bizneseve dhe partive, të cilët e mbështesin kulturën e pandëshkueshmërisë për shkak të mungesës së përgjegjshmërisë dhe dënimit publik nga ana e institucioneve relevante.

Kjo u shfaq hapur gjatë debatit për miratimin e Projekt-Kodit Civil në Kuvendin e Kosovës, më 16 mars 2022. Draft-Kodi Civil, i finalizuar në korrik 2021, është një nga aktet ligjore më thelbësore të zhvilluara në përputhje me Acquis të BE-së. Gjuha e urrejtjes, gjuha diskriminuese dhe keqinformimi ndaj personave LGBTIQ+, sipas pozitës dhe opozitës, u ndezën me një nen në Kodin Civil që thotë se bashkësitë e seksit të njëjtë do të rregullohen nga një ligj i veçantë. Ky diskutim i turpshëm (skuqem nga turpi dhe mosdijenia e deputetëve sa herë e lexoj transkriptin e debatit), që nuk u dënua asnjëherë publikisht dhe hapur nga Qeveria, opozita dhe as komuniteti ndërkombëtar, ka kontribuar seriozisht në rritjen e qëndrimeve negative ndaj komunitetit LGBTIQ+ në Kosovë. Gjithashtu e ka inkurajuar Kryetaren e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut që, në emër të lirisë së shprehjes, të paracaktojë dhe definojë se kush i meriton dhe ka të drejtë t'i gëzojë të drejtat e njeriut në Kosovë.

Si pasojë e mosndëshkimit kemi rritje të qëllimshme të gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBTIQ+, nga deputetët dhe anëtarët e partive politike, ashtu edhe nga një pjesë më konservatore e shoqërisë. Kjo në mënyrë të pashmangshme nxit më shumë ndjenja negative, gjuhë të urrejtjes dhe krime kundër individëve LGBTIQ+. Në nëntor të vitit të kaluar, pas një debati televiziv me një aktivist LGBTIQ+, një person tentoi ta godiste me makinë në vendkalim, me ç'rast i shkaktoi shqetësim të madh dhe frikë për jetën. Një shembull tjetër është gjykimi i cili tani është në vijim, ndaj personit që akuzohet se ka përgatitur sulm terrorist përmes materialeve vdekjeprurëse, në kombinim me nitrat kalciumi, ndaj pjesëtarëve të Marshit të Krenarisë në Prishtinë. Ka shumë më shumë raste të tjera të cilat nuk janë hetuar dhe janë lënë anash, prandaj, si rezultat, askush deri më tash nuk është ndëshkuar për gjuhë/krime të urrejtjes ndaj personave LGBTIQ+.

Kur bëhet fjalë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, Qeveria ka qenë shumë e zëshme në angazhimin e saj për përmirësimin e të drejtave të tyre dhe gjatë dy viteve të fundit ka ndërmarrë nisma të ndryshme. Megjithatë, për të përmirësuar ndjeshëm pjesëmarrjen dhe angazhimin e barabartë të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në jetën publike dhe politike, si dhe për të rivendosur besimin në institucionet publike, institucionet shtetërore duhet të marrin masa shumë serioze për ta çrrënjosur racizmin e institucionalizuar, të tregojnë vullnet më të fortë politik dhe vërtet të ndajnë në praktikë burime financiare e njerëzore për zbatimin e Strategjisë me politikat pasuese. Derisa kjo të ndodhë, për ironi të fatit, ende do t'i nis dokumentet e mia mujore me rastet e racizmit në sferën publike (vrasja e Kujtim Veselit si pasojë e neglizhencës së policisë dhe prokurorisë; vdekja e 4 vjeçares si pasojë e neglizhencës mjekësore; segregimi i klasave në shkolla, problemet me qasje ujë të pijshëm dhe kanalizim, përjashtimi nga furrat, etj., etj.), moszbatimin e ligjeve dhe përshkrimin e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve, si komunitetet më të diskriminuara në Kosovë.

Personat LGBTIQ+, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, gratë, gazetarët dhe mbrojtësët/it e të drejtave të njeriut që punojnë në këto çështje, janë nën kërcënim dhe presion, ndërsa reagimi nga institucionet vazhdon të jetë i vonuar, i paefektshëm dhe i papërshtatshëm. Për më tepër, sulmet, kërcënimet, sulmet fizike dhe psikologjike, apo frikësimet e raportuara tek institucionet shtetërore, shpesh neglizhohen, shpërfillen ose nuk hetohen siç duhet, duke vendosur kështu një praktikë pandëshkueshmërie për autorët e krimeve. Sot, femicidi mbizotëron për shkak të numrit të madh të rasteve të keqmenaxhimit të policisë dhe pasivitetit në hetimin e rasteve të raportuara të dhunës me bazë gjinore.

Ka një prirje në rritje të hapësirës së tkurrur për mbrojtësët/it e të drejtave të njeriut dhe organizatat që punojnë me të drejtat LGBTIQ+, barazinë gjinore, të drejtat e pakicave dhe lirinë e shprehjes. Në shumicën e rasteve përballen me rezistencë institucionale për t'i mbrojtur të drejtat e njeriut dhe të drejtat civile të komuniteteve e individëve më të margjinalizuar e më të diskriminuar. Kemi shumë shembuj, disa i përmenda më lart, por shembulli më i fundit i sulmit të Qeverisë dhe zyrtarëve të saj ndaj shoqërisë civile është deklarata e Zëvendëskryeministrit Besnik Bislimi, i cili e sulmoi prerë shoqërinë civile që punon me minoritete (të drejtat e serbëve), si organizata që "hapur dhe aktivisht angazhohen kundër integrimit të serbëve në institucionet kosovare".

Institucionet duhet të punojnë seriozisht në dënimin, hetimin dhe ndëshkimin e çdo përdorimi të gjuhës diskriminuese dhe poshtëruese, keqinformimit dhe gjuhës së urrejtjes kundër grupeve dhe individëve të caktuar, nga zyrtarët publikë në nivel lokal dhe qendror, deputetët dhe anëtarët e partive politike.

Kufizimet ndaj mbrojtësve/eve të të drejtave të njeriut dhe mjedisit me të cilin ata/ato punojnë, zakonisht tregojnë rritje të rrezikut për të drejtat e njeriut në përgjithësi. Në situatat kur mbrojtësët/it e të drejtave të njeriut heshtin, ndodh që të intensifikohet përkeqësimi i ndikimeve mbi të drejtat e njeriut.

Gjatë viteve të kaluara përmirësimet më të rëndësishme në lidhje me pozitën e të drejtave LGBTIQ+, barazinë gjinore dhe të drejtat e pakicave, u janë atribuuar kryesisht punës së mbrojtësve/eve të të drejtave të njeriut dhe organizatave të të drejtave të njeriut. Qeveria duhet të vendosë një bashkëpunim më të madh me mbrojtësit/et e të drejtave të njeriut dhe organizatat e shoqërisë civile për të kuptuar dhe trajtuar çështjet shoqërore, në vend që t'i konsiderojë ato si entitete kundërshtare dhe të pafavorshme. Pranimi mbrojtësve/eve të të drejtave të njeriut dhe shoqërisë civile si partnerë të vlerësuar në qeverisje nxit bashkëpunimin dhe zgjeron përfshirjen, duke e bërë të mundur një kuptim më të plotë të perspektivave dhe nevojave të ndryshme brenda shoqërisë.

Mbrojtësët/it e të drejtave të njeriut luajnë rol kritik në promovimin e drejtësisë sociale, barazisë dhe llogaridhënies. Është shumë me rëndësi për ne, si mbrojtës/e të të drejtave të njeriut, që të punojmë së bashku, të krijojmë partneritete dhe të ndërtojmë aleanca nëpër lëvizje të ndryshme, duke përfshirë ato që mbrojnë të drejtat e grave, të drejtat e LGBTIQ+, të drejtat e pakicave, lirinë e shprehjes dhe mbrojtjen e mjedisit. Solidariteti është kyç në avokim për barazi dhe trajtim të njëjtë për të gjithë, e veçanërisht për grupet e margjinalizuara ose të diskriminuara.

Autorja është mbrojtëse e të drejtave të njeriut.

Kundër kapjes dhe qeverisjes neoliberale të feminizmit



Liridona Sijarina

Agjencia e OKB-së, UNWomen, e ka shpallur si slogan të sivjetmë të 8 Marsit thirrjen "Investoni në gra, përshpejtoni progresin". Kjo thirrje është hiç më pak se një perversion neoliberal i radhës që provon ta distancojë edhe më tej feminizmin(-izmat) nga potenciali i vet radikal e çlirues.

Zbulimi i grave si subjekte të fuqizueshme dhe rrjedhimisht të shfrytëzueshme nga tregu neoliberal shënjon kapjen më fatale të feminizmit nga neoliberalizmi, që globalisht asociohet me "Konsensusin e Washingtonit", i cili në Kosovë ka migruar me intervenimin ndërkombëtar. Kjo paradigmë që e përdor gjininë si kod qeverisës (Calkin, 2018), i ndërton diskursivisht dhe materialisht gratë si bartëse të një potenciali të shfrytëzueshëm, i cili po u aktivizua nga tregu, i shërben rritjes ekonomike dhe rrjedhimisht zhvillimit të vendit. Përveç që e paqëndrueshme, kjo mendësi qeverisëse e individualizon përgjegjësinë, tenton ta copëtojë klasën dhe kolektiven, i privatizon shërbimet publike të kujdesit, teksa kërkon që gratë të "aktivizohen në treg të punës", duke krijuar kështu krizë të patejkalueshme të riprodhimit shoqëror (Fraser, 2019). Pra, grave iu premtohet emancipim dhe fuqizim, në një treg dukshëm të pasigurt, të padrejtë dhe që zhvleftëson njeriun. Kjo dhe e vendos tregun në pozicion hegjemonik i cili zapton dhe qeveris çdo sferë të organizimit shoqëror, politik dhe ekonomik, qoftë në nivel diskursiv, qoftë në atë material. Ky regjim e zbulon forcën e lirë punëtore të grave dhe e përdor deri në rraskapitje, përderisa përvishet ta dobësojë konceptin e punëtores/it deri në depolitizim dhe të prodhojë trupa ndërmarrës, fleksibilë, autonomë dhe racionalë. Teksa neoliberalizmi kumton që shteti është minimalisht i angazhuar, projektet emancipuese dhe zhvillimin shoqëror ia autorizon tregut, dhe në kuadër të tij, industrializimit në rritje të shoqërisë civile.

Kjo kapje, e cila sot është shndërruar në aparaturë disiplinimi (Brown, 2015), zgjatohet në çdo sferë të organizimit, duke copëtuar dhe individualizuar edhe mobilizimin ligjërimor dhe material. Siç argumenton Dagnino (1998), të bësh politikë në kohë neoliberale është e rrezikshme, meqë zaptimi neoliberal e lë politiken pa gjuhë. Pra, në këto kushte, gjuha të vidhet, shpërdorohet e vihet në funksion të varfërimit ideologjik të organizimit rezistues.

Sot, si kurrë më parë, flitet për dikotominë punë prodhuese/punë riprodhuese, apo punë e shtëpiakizuar, siç e quan Fraser (2019), e gjithë kjo me një logjikë tregu e cila zhvleftëson dhe përvetëson potencialin radikal të projektuar nga feministet antikapitaliste. Sot, djathtas e majtas flitet për punën e kujdesit si pengesë për kyçjen e grave në tregun e punës. Pra, artikulimi dominant, produkt i projektit kolonialist të zhvillimit, e sheh tregun si qëllimin e fundmë të riorganizimit të kësaj pune, e gratë - mjete të tij.

Sot, si kurrë më parë, sipërohen dhe përvetësohen me një lehtësi depolitizuese ligjërimet feministe. Kjo pasi që në kapitalizmin e sotëm, edhe feminizmi si ideologji është mall që blihet e shitet. Rrjedhimisht, edhe feminizmat i nënshtrohen rregullave të tregut dhe parimit të konkurrencës e peshohen në bazë "të ofertës e kërkesës". Një ilustrim i kësaj mund të vërehet në atë se si thirrjen që "feminizmi të jetë për krejt" në ligjërimin e bell hooks, logjika e tregut e bën feminizmin ushqim të shpejtë që fabrikohet masivisht në stilin korporatist dhe krijon profit. E këtu ndodh një moment tjetër i disiplinimit, ai i heshtimit, i cili bëhet pikërisht duke i përdorur konceptet feministe të cilat janë dredhuar përgjatë përdorimit dhe tashmë janë në funksion të heshtimit të kritikës dhe rezistencës në emër të lirisë së zgjedhjes.

Tutje, ky regjim tregu e kornizon edhe angazhimin si çështje privilegji. Aktualisht, një rrezik tjetër vjen nga zërat që thonë se aktivizmi politik dhe mundësia për të bërë politikë janë privilegj klasor, duke ngritur pretendime të rreme mbi origjinat e revoltave shoqërore e fragmentuar edhe më tej organizimin. Pra, një lexim borgjez i aktivizmit, i cili në mënyrë kontradiktore e instrumentalizon edhe lodhjen. Prodhimi i subjekteve të lodhura, të djegura prej "brengosjes politike" dhe "angazhimit politik", është grackë e cila kur i shërben tregut nuk të do si trup të çlodhur, por anksioz, në vrap dhe nëse jo duke prodhuar për tregun, duke e konsumuar atë. Jo habitshëm, në këto kushte edhe rehabilitimi nga lodhja bëhet privilegj klasor dhe jo vetëm. Si rëndom, ato e ata që janë në skaje të ekzistencës e fronte të rezistencave të përditshme, vështirë që mund të pushojnë.

Një vizatim i tillë, ndonëse diagnostifikon sfidë mobilizuese, nuk propozon nihilizëm a cinizëm. Në të kundërtën, del si artikulim i nevojës për të afirmuar politika komunitare që i bëjnë ballë trendëzimit të ligjërimit feminist dhe shitshmërisë së kauzave radikale. Kjo kapje e cila ndodh në kushte të skajshme të atomizimit politik dhe shoqëror, është një lëvizje politike e cila duhet kundërvërë me mjete politike. Në këto kushte, shpresa dhe kultivimi i një shoqërie politike e cila kundërshton përrallat borgjeze të motërzimit të pakusht feminist, janë mjetet me të cilat mund të çajmë përpara. Pra, afirmim i një solidariteti që i kundërvihet konceptit shabllon dhe ahistorik që çon në thirrje të rreme, të paqëndrueshme e qe besa, reaksionare, duke marrë për inspirim kundërshtimet e feministeve të zeza e të rrymës dekoloniale, që e qesin në pah çoroditjen e një thirrjeje të tillë përgjithësuese e edhe heshtuese.

Ne mund ta imagjinojmë bashkë një vizion zgjerues të aktivizmit politik, i cili nuk copëton e nuk sakrifikon. Një vizion që afirmon kolektiven dhe thërret për çmontim të praktikave të mbrojtjes së nderit alla farefisnor që ka zbarkuar në aktivizmin feminist.

Ky projekt politik që është më vështirë i projektueshëm sot dhe gjithsesi i pamundur në vetmim, kërkon zgjerim dhe një njohje kontekstuale dhe historike të hierarkive shoqërore dhe ekonomike ekzistuese. Mirëpo, kjo njohje nuk mund të bëhet duke zbuluar, fetishizuar dhe instrumentalizuar "periferitë" në stilin hegjemonik të feminizmit të bardhë perëndimor. Periferia, kudo që demarkohet në imagjinatën e kujtdo, nuk duhet të aderojë në ligjërim feminist si zbulim epokal. Ajo pashmangshëm është veçse pjesë e lëvizjes dhe nuk duhet të kornizohet si zonë "e fuqizueshme". Ajo është gjeografia politike që na ka lindur dhe edukuar një pjesë të madhe prej nesh, që sot e banojmë atë apo "qendrën", andaj nuk mund t'i nënshtrohet njëjtësisht artikulimeve gjetkë.

Andaj, një projekt politik zgjerues, që nuk synon totalitetin e të mbetet me trosha, është shpresa që mund ta politizojmë. Një projekt i tillë kundërvënës e qendërzon shoqërimin si kundërhelm ndaj incentivave vetmuese, e pranon brishtësinë dhe i bën vend emocionit njerëzor si katalizator i organizimit politik. Ky akt politik, përveç që ofron hapësirë për përbashkim, është edhe një kundërshti ndaj "racionalizimit" të subjektit aktivist që skajon ligështime të aty-këtushme, si dhe të projektit neoliberal të subjektit që e gdhend veten, rrethin, kalkulon kohën e banon hapësirën mbi baza të interesit personal. Ky model nuk i mbyll sytë karshi padrejtësive ndaj vetes, subjekteve afër nesh e as ndaj gjenocidit në Palestinë mbi kalkulime vetjake.

Kolektivja, në këtë projekt, nuk rron veç në imagjinatë. Është përpjekje e përditshme e cila kultivohet, zgjerohet e revoltohet, pikërisht përmes bisedës, njohjes dhe ujitjes së shpresës revolucionare. Kolektivja nuk është shtypëse në këtë projekt. Ajo i lë hapësirë dhe e shëron individin, e përmes tij e transformon edhe vetveten dhe e projekton një të ardhme të qeverisur nga drejtësia dhe dinjiteti njerëzor.

Autorja është aktiviste feministe.

CyanMagentaYellowBlack

Athu dëgjoi kush çfarë thashë?



Lura Elezi

- Do të shkosh tek emisioni "Prespektiva "?! Vish patjetër taka. Dhe ki parasysh, kur të jesh ulur këmbë përmbi këmbë, e vendos njërin gju mbi tjetrin, shtrëngoi pulpat me njëra-tjetrën dhe ooop… pak diagonal, kupton? – Viola shpjegonte me shumë seriozitet, duke e paraqitur pozën në trupin e saj.

- Edhe shpatullat drejt. S'ka si Kuazimodo aty. Ua çfarë qejfi. Do ta bëjnë atje në TV make-up? Apo do shkosh te Make Up by Sandra? – vazhdon Lira.

- Sandra e ka 60 euro një make-up të thjeshtë…

- Po si bën dhe ti, je duke dalë në TV!

Lindës filluan t'i mjegulloheshin mendimet. S'kishte 2 muaj që ishte kthyer nga studimet e saj mbi Gratë dhe Drejtësinë Sociale, nga një shkollë me reputacion në Europën Perëndimore. Muajin e fundit kish filluar të aplikonte për punë; një sfidë e gurtë dhe në përpjesëtim të zhdrejtë me interesin që tregonin njerëzit për përvojën e saj 2 vjeçare në atë institucion.

Çka e kishte befasuar më së shumti ishin kërkesat e pareshtura nga televizionet që ajo të merrte pjesë në emisione të ndryshme. Sa herë ndodhte diçka si vrasje grash, apo abuzim të miturash – fatkeqësisht, aspak në rrallim në trevat shqiptare – telefoni i Lindës ishte shumë i gjallë.

"Po unë nuk jam eksperte ligjore, as punoj në drejtësi", u thoshte me mirësjellje ajo, por gazetarëve kjo u dukej thjesht një pasiguri apo detaj i parëndësishëm që Linda, për të cilën nuk dinin as edhe një lloj gjëje, po u jepte si justifikim.

Ky interes jonatyral që Linda të dilte në TV ishte bërë i bezdisshëm. E vetëdijshme që për të dalë në programin "Prespektiva " kishte rënë pre e presionit, po mundohej të përqendrohej se për çka do të fliste në emisionin më të ndjekur në botën shqiptare.

Linda donte të fokusohej në sa pak gra marrin pjesë në diskutime publike dhe sa e pakëndshme është situata në prag zgjedhjesh, ku çdo sferë publike përmbytet me burra në ekrane që vetëm dëgjojnë veten e tyre, ndërpresin njëri-tjetrin, qëndrojnë me gjymtyrë të shpërndara, dhe në mënyrë krejt rastësore lëshojnë ofendime ndaj grave që nuk kanë të bëjnë fare me përgatitjen e tyre politike; por me paraqitjen, lehonitë, zërat e tyre apo dhe kush janë bashkëshortët e tyre.

- Nuk shkoj tek Sandra, jo. As në TV nuk do përdor make-up, i ndreqin të gjitha njësoj. Do ndreqem vetë.

Linda e bllokoi mendërisht zhgënjimin e shoqeve dhe nxori telefonin e filloi të mbante shënime për çfarë do të fliste sot në darkë.

* * *

Ftohtësia e studios, ndërthurur me dritat verbuese dhe gratë 55 vjeç + që ishin ulur si publik, patën efekt tronditës. Ajo ishte rritur duke ndjekur "Prespektivën" dhe nuk dinte ç'të priste, por sigurisht nuk mendoi që studio do të ishte kaq joftuese. Menjëherë u pendua për takat; por nuk ia vlente stresi të kthehej deri në makinë për t'i riveshur këpucët e saj të dashura "oxfords".

- Këto gratë? Kanë ardhur për këtë temë?

- Oh jo. I paguajmë 5 euro të ulen aty. Çdo ditë.

U përpoq të merrte pozicionin e gjunjëve siç i tha Viola, por harroi shpejt – në studio mësynë 5 të ftuarit e tjerë, dhe vetëm 2 ishin personat që gazetari i kish premtuar. Tre të tjerët ishin 2 pjesëmarrës nga një reality show i stërfryrë dhe i dëmshëm për ndjekësit, si dhe 1 influencere produktesh. Këta të gjithë kishin ardhur për të folur për progresin e barazisë gjinore në vend.

"It is what it is" – Është kjo që është (situata) - iu kujtua shprehja që e thoshte shumë shpesh Lakshmi, shoqja e saj në shkollë.

Emisioni filloi. Në ekran dolën rastet më të fundit të femicidit, shoqëruar me statistika të pasakta. Dhe jo sepse redaksia nuk i kish marrë saktë, po se realiteti i paraportuar është diku katërfish më i madh. Linda u mundua të merrte fjalën, por moderatori i bëri me shenjë të priste. E ftuara X foli për 6 minuta, dhe Linda nuk kuptoi ku deshi të dilte.

Pas nuk di sa minutash pati publicitet. Gazetari vrapoi në skenë drejt saj.

- Hë, si të duket? Është pak "kështu" këtu. Po dëgjo mua: ndërpriti! Ndërpriti e hiç mos të të vijë keq. Thuaj çfarë ke për të thënë.

Pjesa e dytë rifilloi. E mori fjalën psikoterapistja, e cila po fliste gjëra të vërteta dhe të kuptueshme për publikun. Mirëpo, si intelektuale, ajo zhytej në mendimet e veta, humbiste sensin e kohës dhe fliste ngadalë. Moderatori e ndërpreu për t'i dhënë fjalën influenceres, e cila vijoi të fliste për përvojën e saj në një qytezë të vogël me gratë e dhunuara. Madje në ekran dolën ajo dhe gratë e dhunuara.

Linda e gjeti një vakum në copëzat e fjalimit të saj për të marrë fjalën më në fund.

Nuk dinte ç'po thoshte, por nënvetëdija po e qetësonte që po fliste për gjërat me të cilat kishte marrë shënime. Foli pak për sa pak gra ftohen në emisione televizive, çkado qoftë tema, dhe kaloi ngadalë të situatat prag zgjedhjeve dhe sesi i gjithë opinion publik uzurpohet nga burrat. Nuk dinte në ç'pikë të fjalimit ishte, kur "ylli i emisionit reality show" e ndërpreu për të thënë se 2 gra specifike që ai kish parë njëherë në parlament qenkëshin të paafta dhe janë aty prej "kuotës".

Linda buzëqeshi me ironi. "Po patjetër që kështu do përfundonte ky diskutim", mendoi. E pyeti këtë yllin se ç'mendim kishte pra, për një zotëri Y në parlament, që flet vetëm për klube stripper-esh?

Dhe nga ai moment filluan të flasin 3-4 persona përnjëherë. Ajo u shkëput tërësisht mendërisht dhe mori vendimin mos të fliste më për atë darkë.

U largua pa u përshëndetur me gazetarin.

Hipi në makinë, dhe hapi aplikacionin e bisedave me plot dritare të reja.

"Yll ishe bërë shpirti i tezes!"

"Ku i kishe gjetur ato këpucë o shtrigë?"

"Vetëm ti i dhe dritë asaj studioje!"

Dhe nëpër to shumë kërkesa për miqësi dhe një mesazh nga një shok i gjimnazit, i cili me vetëbesim marramendës gjykonte ato çka ajo tha, plus pamjen e saj.

E lodhur, veshi "oxfords" dhe telefonoi mamin.

- O mam. Athua dëgjoi kush çfarë thashë?

Autorja është shkrimtare, krijuese dhe aktiviste.

Aktivizmi i grave rome në kulturën e shoqërisë kosovare

Urma Menekshe

Ka shumë pak shkrime për gratë rome, sfidat e tyre, izolimin e tyre, apo edhe diskriminimin e dyfishtë që ato përjetojnë në jetën e përditshme.

Pse diskriminim të dyfishtë? Sepse, fatkeqësisht, në shoqërinë tonë nuk diskriminohesh vetëm se je grua, por edhe për shkak të përkatësisë etnike, fetare, shtresës shoqërore, pamjes fizike, ngjyrës së lëkurës dhe shumë karakteristikave të tjera që na dallojnë nga njëra-tjetra. Prandaj, edhe diskriminimi apo shkeljet e të drejtave që i bëhen një gruaje rome janë të dyfishta.

Shtresa e parë e diskriminimit ndodh ngaqë janë gra apo vajza, kurse e dyta pasi i takojnë komunitetit rom. E të mos i rendis edhe kushtet socio-ekonomike që shpeshherë karakterizohen nga veshja apo pamja e jashtme. Sytë dhe truri i njeriut janë shndërruar në një makinë, robot apo aparat, që fokusohet vetëm në pamje të jashtme. Sentimentalizmi ynë, empatia, logjika e arsyeshmëria, që në fakt njeriun e bëjnë njeri, pothuajse janë zhdukur si ndjenja shpirtërore dhe instrumente racionale.

Diskriminimi ndodh edhe në promovime të ndryshme të mosdiskriminimit. Në shumë tryeza ku promovohen të drejtat e njeriut, edhe nga vetë "intelektualët" e komunitetit tonë përmenden vetëm emra të burrave. Padyshim që ata meritojnë të përmenden për kontributin e tyre. Por, në një lloj mënyre ata edhe duhet të fajësohen e të mbahen përgjegjës që as para 50 viteve nuk i kanë mbështetur gratë dhe vajzat në pozitat udhëheqëse apo vendimmarrëse.

Megjithatë, edhe vajzat e këtij komuniteti janë shndërruar në heroina të grave të komunitetit rom. Dhe rrjedhimisht, fuqia e forca e grave dhe vajzave rome është më e madhe.

Por, kush me të vërtetë e ka promovuar më shumë komunitetin rom: gratë apo burrat?

Edhe pse organizata joqeveritare "Durmish Aslano" është themeluar nga akademikët dhe intelektualët e komunitetit rom, kulmin e promovimit të këngës së ëmbël rome e ka bërë një vajzë: Bedrijana Misini. Një vajzë e re, me zë brilant, në mes të djemve dhe burrave ishte lidere e skenës artistike. Pa të nuk do të kishte kuptim kënga rome e Prizrenit. Pa të nuk do të kishin kuptim veshjet tradicionale rome. Dhe pa të plaketa e parë me këngë qytetare rome të Prizrenit nuk do të realizohej.

Çfarë është ajo për Prizrenin tonë, homologia e saj, Esma Redžepova, e cila e ka fituar epitetin "Mbretëresha e Muzikës Rome", ishte për Shkupin, e pastaj për Maqedoninë dhe ish-Jugosllavinë, Europën e gjithë botën. Megjithatë, suksesi i ka përcjellë gratë rome jo vetëm në fushën artistike - në këndim, teatër e folklor, por edhe në fusha të tjera, si mjekësia, gazetaria, arsimi, e kështu me radhë.

Zylfie Avdo, mjeke rome, theu shumë tabu para 50 viteve. Nëse mjekësia perceptohet dhe konsiderohet si shkollimi më i lartë e më i vështirë për t'u përfunduar, atëherë jam krenare të them se doktoresha Avdo është gruaja e parë rome në fushën e mjekësisë, gjë që tregon se edhe gratë rome mund të arsimohen e të ushtrojnë çdo profesion të dëshiruar.

Znj. Sheribane Shaljani ishte mësuese, kurse e bija e saj, Gjyzele Shaljani, është zyrtare për arsimin e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Ministrinë e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Indira Elshani ka punuar me OSBE-në, me Caritasin, edhe me organizata joqeveritare për ta përmirësuar pozitën e gruas rome. Njëkohësisht, ajo edhe shkruante për babanë e saj të ndjerë, prof. Ibrahim Elshanin. Ia ka përgatitur të gjitha botimet e tij. Edhe organizatat e shoqërisë civile, të cilat i kanë ndihmuar gratë dhe vajzat rome në aspekte të ndryshme, kanë qenë dhe janë të udhëhequra nga gra të suksesshme, si Shpresa Agushi. Më tutje, edhe gazetaret gra, si Fatime Haliti, Vera Paçaki dhe Drita Salijeviq, kanë kontribuar në përfaqësimin e grave në media dhe avancimin e pozitës së gruas në komunitetin tonë. Aktoret Mikriban Mulamisini, Gynesh Veshall dhe Melisa Menekshe, edhe në skena të teatrit luftojnë për avancimin e pozitës së tyre dhe të grave të komunitetit.

Edhe unë, si mësuese e parë grua e Gjuhës, Kulturës dhe Historisë Rome, e si krijuese e minibibliotekës së parë rome, besoj që kam bërë luftën time për suksesin e grave dhe vajzave rome për ta larguar njëherë e mirë stereotipin dhe paragjykimin që ne, gratë rome, nuk jemi dhe nuk mund të jemi të suksesshme. E në mesin e atyre që i përmenda ka shumë e shumë personalitete, e veçanërisht gra të tjera, që kanë dhënë mundin për këtë qëllim. Në anën tjetër, fatkeqësisht ka me mijëra e miliona gra dhe vajza rome, potenciali i të cilave nuk arrihet kurrë, ngaqë të drejtat e tyre themelore shkelen vazhdimisht.

Shumica nga ju do të befasoheni kur ta lexoni artikullin tim, pasi deri më tani ka munguar vëmendja juaj ndaj sukseseve të grave dhe vajzave rome në Kosovë.

Kjo mungesë interesimi dhe vëmendjeje ka rezultuar në një mosmirënjohje të kontributit të tyre në shoqërinë tonë. Është e rëndësishme të theksojmë se deri më tani, narrativa e komunitetit rom është dominuar kryesisht me ngjarje negative, ndonëse unë besoj se historia jonë përmban edhe shumë shembuj pozitivë. Si kosovarë kemi luftuar për të treguar ekzistencën tonë dhe rolin që kemi në shoqërinë kosovare.

Diskriminimin e luftojmë në çdo hap të jetës sonë. E ne, gratë dhe vajzat rome, hasim një diskriminim edhe më të madh, që rrjedh nga stereotipat dhe paragjykimet që shoqëria jonë i ka për komunitetin rom. Mendohet se komuniteti rom, sidomos gratë dhe vajzat rome, kanë probleme socio-ekonomike, braktisin shkollën, hyjnë në martesa të hershme, e njihen vetëm për dukuri të tjera negative.

Megjithatë, njerëzit ende befasohen kur dëgjojnë që unë e kam përfunduar arsimimin dhe jam e punësuar, duke i thyer stereotipat dhe paragjykimet që ne nuk mund të jemi në këmbët tona.

Në vijim po ju tregoj vetëm disa nga pyetjet e komentet që dëgjojmë çdo ditë nga komunitetet tjera: "A je rome, a? Pse nuk dukesh si ata? Pse je e veshur kaq mirë? A janë romët edhe me lëkurë të bardhë? A dini të flisni edhe gjuhë të tjera përveç gjuhës rome? A keni histori, kulturë ose gjuhë? Sa të pastër jeni!", e shumë e shumë të tjera.

Gratë rome janë përpjekur të luftojnë për barazi përmes pjesëmarrjes në lëvizje sociale, organizata dhe aktivizëm qytetar.

Ato kanë punuar për të adresuar diskriminimin dhe për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë. Përpjekjet e tyre përfshijnë arsimimin e komunitetit, promovimin e të drejtave të grave dhe fëmijëve, specifikisht për t'u arsimuar dhe për qasje në shërbime shëndetësore, si dhe angazhimin në politikë për t'i përmirësuar ligjet dhe politikat në mbrojtje dhe promovim të të drejtave të tyre. Megjithatë, kjo mbetet një betejë e vazhdueshme për të siguruar barazi të plotë dhe të drejta të barabarta për gratë rome në shoqërinë tonë.

Gratë dita ditës po fitojnë më shumë beteja kundër patriarkatit. Këto fitore janë shpresë edhe e grave rome që kanë mbetur të mbështjella nën petkun e patriarkatit. Ato mezi po presin kapitullimin e patriarkatit dhe jetën e lirë, pa diskriminim në jetën politike e publike.

Gratë duhet të jenë prezente në shkolla, fakultete, në dekanate e rektorate të universiteteve, në spitale, në prokurori, në gjykata, në polici, në gazetari, në teatër, në film, në produksion, në biznes, në inxhinieri, në arkitekturë, në arkeologji, në institute të ndryshme, në krye të komunave, në klube sporti, në administratë, në biblioteka, e në çdo sferë të jetës.

Autorja është aktiviste feministe e komunitetit rom.

CyanMagentaYellowBlack

Riprodhimi politik i patriarkalitetit

Saranda Ramaj

Ndryshe prej mësimeve në shkolla, ku mitra konsiderohet organi riprodhues i trupit të grave, në Kosovë diskutimi për të udhëhiqet nga burrat në Kuvend dhe të pakta janë gratë aty që flasin për këtë çështje.

Mitra e gruas dhe vendimet e grave për të shpërfaqin mendësinë patriarkale që zë vend në institucionet me të larta të vendit.

Për mitrën, ndryshe prej organeve të tjera të trupit të njeriut, shteti nuk subvencionon trajtim në rast të ndonjë sëmundjeje. Gratë shumicën e herëve nuk janë të lira të vendosin vetë, e në Kuvendin e Kosovës nuk i përmendet as emri, duke e konsideruar si çështje morali.

Mënyra se si trajtohet shëndeti riprodhues i grave është dëshmuar veçanërisht në përpjekjet rreth njëvjeçare për ta kaluar një ligj për Frytnimin e Asistuar, që do të rregullonte në detaje çështjet të cilat ndërlidhen me gratë e burrat që nuk mund të bëhen prindër në rrugë natyrore.

Një nen u bë problematik që kalimi i këtij ligji të bëhej i pamundur. Në draft-ligj, një grua e pamartuar mund të bëhet nënë edhe nëse nuk është e martuar, por ka partner.

Një mundësi e tillë parashihej edhe në të kaluarën sipas Udhëzimit Administrativ që aplikohej për spitalet private. Ky nen u bë problematik vetëm kur filloi tentativa që Udhëzimi Administrativ të bëhej ligj e nga ligji të përfitonin gratë dhe çiftet që shpresojnë të bëhen prindër përmes Frytnimit të Asistuar, por në spitalin publik.

Diskutimi për Ligjin për Frytnim të Asistuar që në fillim është bërë duke u devijuar çështja kryesore. Ministria e Shëndetësisë e ka rregulluar këtë proces në vitin 2013, me Udhëzim Administrativ. Deri tani procesi i Frytnimit të Asistuar është licencuar vetëm për institucionet private spitalore.

Në kohën kur u nxor Udhëzimi Administrativ, Qendra Klinike Universitare e Kosovës nuk kishte kushte për ta filluar këtë shërbim në Gjinekologjinë e sistemit publik. Më vonë, Udhëzimi Administrativ doli që ishte i pamjaftueshëm për ta rregulluar këtë fushë për shkak të pamundësisë që të shqiptoheshin sanksione në rast të moszbatimit të rregullave.

Në vitin 2018 u bastisën shumica e spitaleve private, prandaj Ministria e Shëndetësisë vendosi që ta pezullonte këtë shërbim. Megjithatë, mungesa e legjislacionit adekuat bëri që shërbimet në formën e njëjtë të fillonin sërish. Një gjë të tillë e konfirmojnë në Ministrinë e Shëndetësisë.

"Kjo fushë ka qenë e domosdoshme të rregullohet me ligj për shkak se në bazë të Ligjit për Kundërvajtje (viti 2016), sanksionet kundërvajtëse nuk mund të shqiptohen me Udhëzim Administrativ".

Mungesa e sanksioneve dhe masave ndëshkuese qysh para tetë viteve e kanë bërë këtë fushë plotësisht të pamenaxhuar nga Inspektorati Shëndetësor.

"Duke marrë parasysh që në bazë të Kushtetutës, të drejtat themelore të njeriut kufizohen vetëm me ligj, ka lindur nevoja për ndryshim të politikës së rregulluar deri tani me Udhëzimin Administrativ nr. 06/2013 për Frytnim të Asistuar Mjekësor", thotë Ministria.

Pjesa më e madhe e përmbajtjes së draft-ligjit është e paraparë në Udhëzimin Administrativ, përfshirë edhe neni që u jep mundësi grave pa partner të behën nëna.

Por, kur diskutimi publik u bë brutal dhe iu dha nuancë tradicionale e fetare, ish-ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani, u distancua nga Udhëzimi Administrativ që e ka nënshkruar vetë si ministër, ku lejohej që gratë e pamartuara e pa partner të mund të kishin fëmijë.

"Mund të jetë një grua që është në martesë, në çift, e cila ka pasur një sëmundje e që nuk mund të shërohet dhe për çka partneri i saj është ndarë prej saj, e ka lenë të sëmurë. I ka thënë: 'S'mund të jetoj më me ty, se nuk mund të bësh fëmijë'. Ajo grua tash është rëndë e lënduar dhe ka të drejtë që me kërkesë t'i drejtohet komisionit në Ministrinë e Shëndetësisë, me dokumentacion, t'iu thotë: 'Shikoni, unë kam qenë e martuar, unë kam dashur të kem fëmijë, por për një arsye jam divorcuar. Ndërkohë, tash, jam shëruar. Kjo e drejtë është e specifikuar".

Por, një interpretim i tillë çfarë e bën Agani as nuk gjendet në Udhëzimin Administrativ e as Ministria e Shëndetësisë nuk e zbaton në këtë formë. Vetë institucionet e shëndetësisë, që e kanë detyrë respektimin e kësaj norme ligjore, e zbatojnë ndryshe.

"Dispozita e projektligjit sa i përket shfrytëzimit të procedurës së FAM nga gruaja e pamartuar është bartur nga UA 06/2013, ku e njëjta është marrë edhe si përvojë nga shtetet tjera", theksohet në përgjigjen e Ministrisë së Shëndetësisë.

Çështja e ligjit për shëndetin riprodhues është kthyer në një çështje që i dëmton ekskluzivisht gratë. Presioni për krijimin e fëmijëve dhe familjeve bie veçanërisht tek ato.

Visar Ymeri, njohës i politikave sociale dhe drejtor i Institutit "Musine Kokalari", konsideron që debati i tillë po zhvillohet sepse gruaja është në qendër.

"Si rëndom, kjo formë e të menduarit vë në spikamë rolin tradicional që ata mendojnë se duhet ta ketë gruaja në shoqëri. Pra, ky lloj mendimi nuk e sheh e as s'e pranon gruan si subjekt a agjent vendimmarrës në procesin e riprodhimit. Vendimmarrjen herë ia bartin burrit e herë shtetit, por assesi gruas, e cila është bartësja më e rëndësishme e më e prekur e procesit të riprodhimit".

Një gjë e tillë shihet nga dokumenti i deputetëve të Kuvendit të Kosovës që kanë marrë pjesë në amendamentin e këtij draft-ligji, pas kalimit në lexim të parë.

Deputeti i koalicionit VV-Guxo, Burim Meta, në këtë dokument thotë që i frikësohet padive potenciale të fëmijëve që do të vijnë në jetë nga gratë pa partner.

"Hipotetikisht po them që një grua e moshës madhore të bëhet nënë pa prezencën e babait në kontekstin e respektimit të të drejtave 'se çfarë do mund të bëjë me trupin e saj'. Po e paralizojmë të drejtën e fëmijës për të pasur një atësi dhe ai fëmijë pas moshës 16 ose 18 vjeçare vjen dhe na akuzon se pse ja kemi mundësuar që ky fëmijë të jetojë pa baba".

Deputetja Albena Reshitaj e ka ironizuar "të drejtën e gruas për të vendosur për trupin e saj", duke e krahasuar me "të drejtën e gruas për abort" pas javës së dhjetë të shtatzënisë, ani pse kufizimi i kohës së abortit lidhet ekskluzivisht me shëndetin e gruas.

"Nëse thirremi në atë se 'gruaja bën çka të dojë me trupin e saj', atëherë pse nuk lejohet aborti pas krijimit të organogjenezës (d.m.th., pas muajit të tretë të shtatzënisë)?".

Një grup i deputetëve të VV-së, të përkrahur edhe nga deputetë të tjerë, së fundmi kanë dalë kundër çfarëdo forme të përdorimit të Frytnimit të Asistuar nëse qelizat riprodhuese nuk janë të çifteve që vendosin të behën prindër.

"Ne vazhdojmë t'i mbrojmë qëndrimet tona duke mbështetur vetëm Fertilizimin Homolog dhe assesi atë Heterolog. Jemi kundër Surrogacisë, sepse kjo mund të ketë ndikime te gratë e varfra për ta ofruar këtë shërbim. Banka ka kuptim vetëm për çiftet homologe dhe duhet ta ruajmë institucionin e familjes sonë", citohet të ketë thënë deputeti Visar Korenica në dokumentin me komentet e deputetëve për ta dërguar në lexim të dytë projektligjin.

Ashtu siç "gruaja" është bërë pengesë për kalimin e këtij ligji, njëjtë vëmendja bie mbi gruan për ndërtimin e familjes.

Ardita Z. është 36 vjeçare. Në korrikun e vitit të kaluar ka bërë 11 vjet martesë. Dëshira e saj dhe e burrit është që të kenë një fëmijë, por pavarësisht përpjekjeve ende nuk kanë arritur ta kenë një shtatzëni të suksesshme.

Ajo punon në një institucion publik të Kosovës. Paga e saj mujore sillet rreth 540 euro në muaj. Pak më pak të ardhura mujore ka bashkëshorti i saj.

"Vitin e kaluar kemi qenë në kontrolle tek një mjek në një spital privat këtu në Prishtinë. Ai na ka sugjeruar që, nëse edhe për disa muaj nuk mbetëm shtatzënë, të filloj ta shqyrtoj idenë që shtatzëninë ta provojmë përmes IVF-it".

Por, për këtë familje vendimi nuk është kaq i thjeshtë. Një nga barrierat kryesore është çështja financiare.

"Në njërën anë financat, e në anën tjetër frika që çdo vit që kalon e bën më të vështirë një shtatzëni. Këto janë problemet me të cilat përballem çdo ditë jo vetëm unë, por edhe burri".

Megjithatë, presioni për fëmijë në rrethin e gjerë bie mbi shpatullat e saj.

"Familja ime e ngushtë dhe ajo e burrit nuk janë që më kanë paragjykuar. Mirëpo, jam përballur shumë shpesh me paragjykime posa kam dalë nga shtëpia. Vetë fakti që shumica e pyetjeve, ose komenteve, që me drejtohen janë të llojit: 'Shumë mirë që burri po të mirëkupton që nuk po mund të mbetesh shtatzënë', e tregon që njerëzit gjykojnë që faji është imi, ndonëse mjeku nuk ma ka konstatuar asnjë problem".

Gratë dhe çiftet në situatë të ngjashme me atë të Arditës presin që ky shërbim të ofrohet në QKUK.

"Sigurisht që çdokush dëshiron që fëmijës t'ia transmetojë gjenet e veta, por prindërimi bëhet në shumë forma. Nëse do të na mbetej forma e vetme përmes materialit riprodhues të dikujt tjetër, unë dhe bashkëshorti do të pranonim".

Refuzimi ndaj fertilizmit heterelog, që nënkupton se çifti ose gruaja nuk ka pasur asnjë mundësi shëndetësore të përdor materialin e vet riprodhues, andaj duhet ta marrë nga një person që vullnetarisht bën donacion materialin dhe mbetet anonim, po kundërshtohet nga një pjesë e deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

"Dhuruesit e qelizave gjinore për fekondim heterolog ia dhurojnë ato Institucionit Shëndetësor i cili është i licencuar për realizimin e procedurës së Fertilizimit të Asistuar Mjekësor", thuhet në Udhëzimin Administrativ që aktualisht është duke u shfrytëzuar në spitalet private.

E njëjta normë pa asnjë ndryshim synon që të përfshihet në ligj, por tash po kundërshtohet në Kuvendin e Kosovës.

Kaltrina Rexhepi Dragusha, gazetare hulumtuese dhe aktiviste që merret kryesisht me trajtimin e temave që në thelb kanë të bëjnë me pabarazitë gjinore, mendon se çështja e lindjes së fëmijëve është rol që padrejtësisht ndërlidhet vetëm me gratë.

"Jo vetëm për gratë e pamartuara që duan të kenë fëmijë, gjykimi është edhe për gratë që nuk mund të kenë fëmijë në rrugë natyrale, si dhe për gratë që lindin foshnjat vajza, pasi ato konsiderohen fajtore pse nuk kanë lindur djem, ani pse shkenca e tregon që gjinia nuk përcaktohet nga gruaja. Pra, gratë në Kosovë kanë presion për secilin vendim në lidhje me shëndetin e tyre riprodhues"..

Dëshmia më e mirë që kjo fushë do të duhej të rregullohej me ligj të posaçëm, e jo me Udhëzim Administrativ, është abuzimi me këtë procedurë nga ana e spitaleve private, dyshimet për të cilat u ngritën në vitin 2018 nga Inspektorati Shëndetësor dhe Prokuroria e Shtetit.

Kështu kishte deklaruar në vitin 2019 gjinekologu Curr Gjocaj, që asokohe ishte anëtar i grupit punues. "Nuk jemi duke bërë ligj për nesër e pasnesër. Jemi duke bërë infrastrukturë ligjore që së paku në dy ose tri dekadat tjera hiç mos me pasë nevojë të përmirësohet".

Gratë dhe çiftet në Kosovë nuk kanë mundësi ta marrin këtë shërbim në sistemin publik shëndetësor. Deputetët që e kundërshtojnë ligjin, por që duan që kjo temë të rregullohet me Udhëzim Administrativ, besojnë që ky akt nënligjor është i mjaftueshëm për ta rregulluar këtë fushë komplekse, e madje edhe për të filluar edhe në sistemin publik.

Në Ministrinë e Shëndetësisë thonë ndryshe. Ky institucion, përmend disa ndryshime që i ka ligji i cili po dështon të votohet, e që nuk i ka Udhëzimi Administrativ, por që janë kyçe për rregullimin e kësaj fushe.

"Në bazë të nenit 37 të UA nr. 06/2013, procedurat për FAM mund të realizohen vetëm në institucionet e licencuara nga Ministria e Shëndetësisë, ku kushtet, hapësira, personeli dhe pajisjet për realizimin e FAM janë përcaktuar me UA (në këtë rast janë të Udhëzimit Administrativ për Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta spitalore, ku i njëjti vlen vetëm për sektorin privat)".

Nga analiza e draft-ligjit dhe krahasimi me Udhëzimin Administrativ janë edhe tetë dallime që te draft-ligji janë të përfshira, e tek Udhëzimi Administrativ jo.

"Themelimi i Institucionit Shëndetësor Publik referent për FAM, Kompetencat e Komisionit për FAM; Themelimi i bankës për ruajtjen e qelizave gjinore: Procedurat për ruajtjen dhe asgjësimin e qelizave gjinore dhe embrioneve: Krijimi i databazës për ruajtjen e të dhënave për FAM: Procedurat e aplikimit për Fertilizimin e Asistuar Mjekësor; Transporti i qelizave gjinore; Përcaktimi i Sanksioneve kundërvajtëse".

Diskutimi për shëndetin riprodhues të grave nuk është udhëhequr nga gratë të cilat do të duhej të vendosnin për veten. Në vend të vendimeve individuale të secilës grua për trupin e vet, diskutimi herë pas here ka marrë karakter fetar. E, sipas Visar Ymerit, një përbërje e tillë çfarë ka sot Kuvendi i Kosovës nuk ka qenë asnjëherë me parë.

"Konceptet themelore politike që janë përdorur vazhdimisht në Kosovë kanë qenë demokracia, liberalizmi, kombëtarizmi, patriotizmi, por jo parimet e doktrina fetare. Në këto diskutimet e fundit është doktrina fetare ajo që më së shpeshti merr hapësirën më të madhe".

Një qasje e tillë e dëshmon edhe takimi i deputetes Duda Balje, që është kryesuese e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, me klerikë fetarë. Tema kryesore ishte ligji për shëndetin riprodhues të grave.



CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

Me boks kundër paragjykimeve

Boksi është sport që dominohet nga burrat. Mirëpo, ndryshimet në Kosovë kanë filluar me dy gra - njëra kampione e boksit amator dhe tjetra gjyqtare e boksit profesional.

Vjosa Çerkini

25-vjeçarja Adea Berisha jeton në Pejë. Puna e saj është e veçantë: ajo është e vetmja gjyqtare profesioniste e boksit në Kosovë, por edhe më gjerë. Profesioni thuajse iu përcaktua kur ishte në djep, pasi edhe babai i saj, Florim Berisha, ishte boksier aktiv dhe tashmë është edhe gjyqtar në boksin profesionist.

"Kam dashur të boksoj që e vogël, sepse kam bërë boks gjithmonë me babanë dhe kjo më ka magjepsur", thotë Adea.

Por, babai dhe nëna e saj ishin çdo gjë tjetër veçse entuziastë për këtë ide, prandaj u përpoqën ta shtynin atë në sporte të tjera. Kur asgjë nuk ndihmoi, u shtuan komentet, duke thënë se fytyra dhe bukuria e saj mund të shkatërroheshin nga goditjet në boks.

"Prindërit e mi nuk bënë mirë që donin të më largonin nga boksi, sepse edhe ashtu nuk kisha mundësi të boksoja. Nuk kishte vajza të tjera si partnere në ring".

Rastësisht, kur ishte 19 vjeç, ajo zbuloi mundësinë e një karriere si gjyqtare në boks dhe menjëherë dëshiroi që ta provonte, meqenëse dashuria për boksin ishte shumë e madhe. Paragjykimet e para ndaj saj u shfaqën për shkak të fizikut. Ishte 168 cm e gjatë, peshonte afro 50 kilogramë dhe ishte shumë e re në moshë. Komentet e llojit: "Si mundet një vajzë e vogël si ti t'i ndajë dy boksierë të peshave të rënda?", e të ngjashme, ishin të shumta. Por, Adea nuk merrej me to. Vullneti i saj për ta dëshmuar veten ishte shumë i fortë dhe kështu e mori vendimin të cilin prindërit e saj në fund e mbështetën.

Asaj menjëherë iu desh ta dëshmonte veten kundër burrave në klasën e gjyqtarëve të boksit. Përballej me paragjykime, sepse më parë nuk kishte pasur raste të tilla. "Kjo nuk është për vajzat", i thoshin kolegët e saj të ardhshëm.

Në moshën 19-vjeçare e realizoi ëndrrën. U bë gjyqtare boksi.

Në sezonin 2018/2019 e filloi karrierën si ndihmës-gjyqtare. Pas përfundimit të suksesshëm të provimeve për licencim, ajo tashmë është gjyqtarja e vetme grua në boksin profesionist. Që atëherë i ka drejtuar 33 ndeshje, vetëm dy prej të cilave me boksiere gra. Shpreson që në të ardhmen të drejtojë gara ndërkombëtare, veçanërisht në Kampionatin Botëror të Boksit për Gra.

Sipas hulumtimit të realizuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore në vitin 2022, "Gratë dhe vajzat në fushën e sportit", në 80.5% të rasteve të anketuarat e kishin identifikuar mungesën e financimit si sfidë kryesore, ndjekur nga gjendja financiare personale (59.7%) dhe diskriminimi në bazë gjinore (32.5%). Adea i konfirmon këto statistika si tri problemet kryesore me të cilat, njëjtë si ajo, përballen gratë në sport.

"Nuk mund ta siguroj jetesën nga ky profesion, nuk paguhet mirë. Kjo është dhe arsyeja pse unë paralelisht punoj si zyrtare ligjore".

Ajo ka të ardhme si gjyqtare boksi, sepse kolegët e saj në Kosovë të gjithë janë mbi 50 vjeç dhe, natyrisht, të gjithë burra. Hapësira për t'u zhvilluar profesionalisht për të është e pafundme.

Edhe 24-vjeçarja Donjeta Sadiku u detyrua t'i kalonte të njëjtat paragjykime se boksi është dikaster i burrave. Megjithatë, ajo është kampione e Ballkanit në boks për vitin 2023.

"Që në fillim kam pasur shumë vështirësi si grua. Gjithmonë më është dashur të dëshmoj se jam boksiere e mirë", shprehet Donjeta.

Rruga e saj për t'u bërë kampione u shënua nga pengesa të mëdha, në dukje edhe të pakapërcyeshme. Kishte paragjykime që janë klasike ndaj atyre grave që duan ta afirmojnë veten në një fushë mashkullore.

Kur politika është më e fortë se boksi

Kur zhvilloheshin garat në shtetet që nuk e njihnin Kosovën si shtet sovran, asaj i refuzohej hyrja apo konkurrimi si përfaqësuese e shtetit tonë. Kjo ka ndodhur tri herë deri më tani. Nuk i është lejuar të garojë në Indi dhe e ka anuluar pjesëmarrjen në Kampionatin Europian të këtij viti në Serbi. "Jam vërtet e fortë, nuk jam e shqetësuar për sportin, por kur kaloj muaj duke u përgatitur për një ndeshje boksi dhe një ditë më parë zbuloj se nuk më lejohet të hyj në vend, është vërtet zhgënjyese".

Këto padrejtësi padyshim që e kanë motivuar atë duke e nxitur në fuqi për fitimin e medaljeve. Ndër të tjera, ajo u bë Nënkampione Botërore për Juniorë 2015, Nënkampione e Europës 2017, Kampione e Europës 2018, Medalje Bronzi e Botës dhe Europës 2020 dhe Kampione Ballkanike 2023. Lista mund të ishte më e gjatë nëse ajo do të lejohej të konkurronte kudo. Shteti sovran i Kosovës ende nuk njihet nga plot shtete. Serbia vazhdon ta pengojë anëtarësimin e Kosovës në institucionet ndërkombëtare kudo që është e mundur. Lehtësimi i situatës politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk duket i mundshëm në afat të shkurtër, përkundrazi, mosmarrëveshjet për gjëra të supozuara të vogla si targat përshkallëzohen menjëherë në kërcënime për vendosjen e ushtrisë.

Donjeta është e vetmja grua kosovare që ka arritur karrierë të shkëlqyer në boks. E nisi në kategorinë e boksit amator, por, njëjtë si Adea, nuk mundi që e vetme t'i mbulonte të gjitha shpenzimet nga boksi.

Ajo konsiderohet si një nga tri boksieret gra me goditjet më të fuqishme në botë. Është e bindur se do të shkojë shumë lart në nivelin amator, apo edhe atë profesional. Patjetër dëshiron të marrë pjesë në Olimpiadën e ardhshme dhe, në varësi të suksesit, mundësisht të kalojë në fushën profesionale. "Nuk mund ta parashikosh kurrë në Olimpiadë, por mendoj se të paktën mund të fitoj një medalje bronzi".

Me gjithë sukseset dhe titujt e shumtë kampionalë, nuk ka mbështetje financiare nga Federata e Boksit të Kosovës. Ajo as që kërkon para personalisht, por mendon se duhet të paktën të marrë pajisje adekuate për procesin e saj të stërvitjes si një olimpiste e ardhshme.

Dy gra të forta si Donjeta Sadiku dhe Adea Berisha po e afirmojnë veten për mrekulli në Kosovën patriarkale.

Autorja është gazetare.

CyanMagentaYellowBlack

CyanMagentaYellowBlack

BASHKËFINANCUAR NGA:

Bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian

Sweden Sverige

KVINNA KVINNA

CyanMagentaYellowBlack